- 8 Meri, Beti e Riçardi po pushojnë.
- 9 Drita e Nora janë moshatare.
- 10 Genci e Zana shkojnë në shkollë.

- (5) Put the nouns in brackets in their possessive form:

- 1 Ky është lapsi (një shoqe) .....
- 2 Kjo është motra (një shoku) .....
- 3 Ai është kopshti (Mark) .....
- 4 Ajo është shkolla (Zanë) .....
- 5 Shtëpia (mësuesi) ..... është e vogël.
- 6 Burri (Fatmir) ..... është piktor.
- 7 Vellai (një shok) ..... është mjek.
- 8 Dritarja (dhoma) ..... është e madhe.
- 9 Kopshti (Fatmir) ..... është i bukur.
- 10 Valixha (Nora) ..... është e rëndë.

- (6) Translate into English:

Sot Nora është në Prizren. Ajo është te shoqja e saj, Drita. Në shtëpi janë vetëm Nora, Drita dhe nëna e saj. Babai i Dritës nuk është në shtëpi. Motra e Dritës është te një shoqe. Nëna e Dritës është në kuzhinë. Ajo po e bën drekën gati. Nora është në dhomë me Dritën. Ato po pushojnë.

- (7) Translate into Albanian:

It is ten o'clock now. At (në) eleven I am going to Oxford by bus. I have a few friends there. They are all students. They are very hospitable. Oxford is a beautiful town and it is not big. Oxford is not far from London. In (për) one hour by bus you are there. There is a very big theatre in Oxford. I go there every summer with Mark and Betty. Mark is a student of English literature, whereas Betty is a student of Russian.

# Unit Five

## ■ I/ SITUATIONS

të dehur	drunk ( <i>masc. pl.</i> )
bisedojnë	(they) talk
kafene	cafe
më fal	excuse me
më falni	excuse me ( <i>pl. or polite form</i> )
a e di	do you know

Dy të dehur bisedojnë në një kafene:

A: Më fal, a e di sa është ora?

B: Po.

A: Falemnderit.

dëshiroj	(I) wish; want
të shkoj	to go
kinema	cinema
sonte	tonight
më vjen keq	I am sorry
kohë	time
ndonjëherë tjetër	some other time

A: Dëshiroj të shkoj në kinema sonte. A vjen edhe ti?

B: Më vjen keq, por nuk kam kohë. Shkojmë ndonjëherë tjetër.

pse	why
i mërzitur	bored ( <i>masc. sing.</i> )
rrimë	(we) stay
asgjë	nothing
të të këndoja	shall I sing you. . . ?
këngë	song
mos, të lutem	please don't ( <i>sing.</i> )
të shëtisim	shall we go for a walk
bën ftotë	it is cold
darkë	supper
të hamë darkë?	shall we have supper?
herët	early

atëherë	then
të bisedojmë	let's talk
për	for, about

A: Pse je i mërzitur?

B: Ja, rrimë këtu e s'bëjmë asgjë.

A: Të të këndoja një këngë?

B: O, jo. Mos, të lutem.

A: Të shëtisim pak?

B: Jo, bën shumë ftohtë.

A: Të hamë darkë?

B: Jo, është hérët.

A: Ç'të bëjmë atëherë?

B: Të bisedojmë.

A: Për çka?

do të bëjmë	we shall do
nesër	tomorrow
bjeshkë	mountain
do të ecim	we shall walk
pasnesër	the day after tomorrow
a do të vijsh	will you come
do të vij	I shall come
do të udhëtojmë	we shall travel
bashkë	together

A: Çka do të bëjmë nesër, Dritë?

B: Do të shkojmë në bjeshkë.

A: Si do të shkojmë?

B: Me veturë. Pastaj do të ecim.

A: A do të vijsh pasnesër në Prishtinë?

B: Po, do të vij.

A: Shumë mirë. Do të udhëtojmë bashkë.

doni	you ( <i>pl.</i> ) want
të pini	to drink
kafe	coffee
sheqer	sugar
zakonisht	usually
pa	without

A: Çka doni të pini?

B: Një kafe me pak sheqer, ju lutem. Zakonisht pi kafe pa sheqer.

## II GRAMMATICAL PATTERNS

### *The Present Tense of di, eci and dua*

The verbs **bisedoj** (*talk*), **dëshiroj** (*wish, want*), and **peshkoj** (*fish*) conjugate in the same way as the verb **punoj**. Here are some verbs which have different patterns for the present tense.

#### *di (know)*

(Unë)	di	(Ne)	dimë
(Ti)	di	(Ju)	dini
(Ai/Ajo)	di	(Ata/Ato)	dinë

The verbs **pi** (*drink*) and **rri** (*stay*) conjugate like *di*.

#### *eci (walk)*

(Unë)	eci	(Ne)	ecim
(Ti)	ecën	(Ju)	ecni
(Ai/Ajo)	ecën	(Ata/Ato)	ecin

#### *dua (want)*

(Unë)	dua	(Ne)	duam
(Ti)	do	(Ju)	doni
(Ai/Ajo)	do	(Ata/Ato)	duan

### *The Progressive Form of the Verb*

All the verbs used until now have been in the Present Tense of the Indicative. One way of forming the progressive of this tense, as we saw, was by inserting the particle **po** in front of the verb. The progressive corresponds to the English form ending in *-ing*.

Po punoj. I am working.

### *The Subjunctive*

The Subjunctive mainly corresponds to the English infinitive in function and is used following verbs of intention, e.g.

Dëshiroj të punoj I wish to work in the garden.  
në kopsh.

The Subjunctive is formed by putting the particle **të** in front of the verb, and the verb itself mainly retains the same forms as for the Present Tense of the Indicative. It has different forms only

for the second and third person singular. These two forms are given below in bold script for **punoj**. (Note that from now on personal pronouns will be omitted when conjugating verbs.)

të punoj	të punojmë
të punosh	të punoni
të punojë	të punojnë

### *Subjunctive of jam and kam:*

të jem	të jemi	të kem	të kemi
të jesh	të jeni	të kesh	të keni
të jetë	të jenë	të ketë	të kenë

### *The Future Tense*

The Future Tense in Albanian is formed by putting the particle **do** in front of the Subjunctive:

do të punoj	do të punojmë
do të punosh	do të punoni
do të punojë	do të punojnë

### *Telling the Time*

Sa është ora?	- What time is it?
2:00	- Ora është dy.
2:05	- dy e pesë (minuta)
2:10	- dy e dhjetë (minuta)
2:15	- dy e një çerek
2:25	- dy e njëzet e pesë (minuta)
2:30	- dy e gjysmë (e tridhjetë minuta)
2:40	- tre pa njëzet (minuta)
2:45	- tre pa një çerek
2:55	- tre pa pesë (minuta)
3:00	- tre
9 a.m.	- nëntë në mëngjes
9 p.m.	- nëntë në mbrëmje

çerek	quarter
gjysmë	half

<b>mesditë</b>	midday
<b>mesnatë</b>	midnight

### Definite and Indefinite Forms of Nouns

Below is a list of singular and plural definite and indefinite forms.

<i>Singular</i>	<i>Plural</i>		
<i>Indefinite</i>	<i>Definite</i>	<i>Indefinite</i>	<i>Definite</i>
banesë	banesa	banesa	banesat
motër	motra	motra	motrat
amvisë	amvisja	amvise	amviset
mësuese	mësuesja	mësuese	mësueset
mjeke	mjekja	mjeke	mjeket
letërsi	letërsia	letërsi	letërsitë
shtëpi	shtëpia	shtëpi	shtëpitë
autobus	autobusi	autobusë	autobusët
mjek	mjeku	mjekë	mjekët
burrë	burri	burra	burrat
hotel	hoteli	hotele	hotelet
kat ( <i>floor, storey</i> )	kati	kate	katet
qytet	qyteti	qytete	qytetet
spital	spitali	spitale	spitalet
mësues	mësuesi	mësues	mësuesit
nxënës	nxënësi	nxënës	nxënësit
baba	babai	baballarë	baballarët
djalë	djali	djem	djemtë
vëlla	vëllai	vëllezër	vëllezërit
teatër	teatri	teatro	teatrot
fëmijë	fëmija	fëmijë	fëmijët

If you look at the first two columns, you may notice that masculine nouns take either **-i** or **-u** as the definite article. Masculine nouns ending in [k], [g] or [h] sounds, or in a stressed vowel, take the definite article **-u**, e.g. shok – shoku, mí – míu (*mouse*). Exceptions are male humans like vëllá – vëllái, pashá – pashái, babá – babái,

and also nouns like sý – sýri (*eye*), which add **-r** before adding **i**.

Notice that some sounds drop when the definite article is added. Such are the unstressed **e** as in shoqe – shoqja and **ë** as in motër – motra, teatër – teatri, djalë – djali, vajzë – vajza.

The plural ending comes in a variety of forms. Not all of them are covered by this list of nouns, but you may still notice that the typical masculine endings are **-ë** and **-a**, and the typical feminine endings are **-e** and **-a**. Many nouns, both masculine and feminine, have the same form in the singular and plural, and some form the plural in an irregular way.

A number of masculine inanimate nouns take the plural ending **-e** and become feminine in the plural. Such are hotel, qytet, etc. In the vocabulary at the end of the book nouns that undergo this change are marked '*fem. in pl.*'

The definite article in the plural for all nouns is **-të** or **-it**.

It is important to determine number, gender, definiteness and indefiniteness for nouns because these in one way or another govern the form of the adjectives used with them, e.g.

<i>Masculine</i>	<i>Feminine</i>
student i mirë	studente e mirë
studenti i mirë	studentja e mirë
studentë të mirë	studentë të mira
studentët e mirë	studentet e mira

### Proper Names

You may have noticed by now that proper names in Albanian have an indefinite and a definite form, e.g.

Agim	Agimi	Agron	Agroni
Zanë	Zana	Fatmire	Fatmirja
Mark	Marku	Dimitër	Dimitri
Arbër	Arbri	Norë	Nora
Londër	Londra	Oksford	Oksfordi
Prishtinë	Prishtina	Prizren	Prizreni

Notice the usage **Unë quhem Petrit** but **Unë jam Petriti**

### ■ III/ DIALOGUE

#### Ç'DO TË BËJMË SOT?

Është ora tetë në mëngjes. Studentët anglezë janë në restorantin e hotelit. Ata po hanë mëngjes dhe po bisedojnë për planet e sotme.

*Marku:* Ku do të shkosh sot ti, Meri?

*Meri:* Te një shoqe.

*Marku:* Cila është ajo?

*Meri:* Quhet Merita. Është studente e gjuhës angleze. Ajo shpesh shkon në fshat. Gjyshi e gjyshja e saj jetojnë në fshat. Do të shkojmë në fshat sot.

*Beti:* Edhe unë kam dëshirë të shkoj në fshat.

*Meri:* Eja me ne. Babai i Meritës na çon me veturë. Ka vend edhe për ty.

*Nora:* Po ti, Denis, ç'do të bësh?

*Denisi:* Do të shkoj me Antonin në Deçan. Është një manastir i vjetër atje.

*Marku:* Mos shko sot në Deçan, Denis. Atje do të shkojmë një ditë tjetër të gjithë bashkë. Unë e Petriti do të shkojmë në peshkim. Ejani edhe ju me ne.

*Denisi:* Ide e mirë! Po me Norën ç'do të bëjmë?

*Nora:* Jam pak e lodhur. Ndoshta rri në hotel e pushoj.

*Marku:* Mos rri vetëm, Norë. Eja edhe ti me ne.

*Nora:* Mirë, atëherë. Po vij edhe unë me ju. Derisa ju peshkoni, unë do të pushoj.

*Riçardi:* Ç'të bëj unë? Unë s'kam asnjë plan.

*Nora:* Ti zgjedh. Ose shko me Merin e Betin, ose eja me ne.

*Riçardi:* Po shkoj me Merin e Betin.

*Marku:* Petriti do të vijë në orën nëntë. Në nëntë e gjysmë do të nisemi. Më mirë të nisemi herët sesa vonë.

#### Vocabulary

mëngjes

breakfast; morning

planet

the plans

planet e sotme

shpesh

fshat

gjyshi

gjyshja

dëshirë

na çon

vend

ka vend

për ty

manastir

i vjetër

mos shko

ditë

tjetër

peshkim

ejani!

ide e mirë

ndoshta

mos

derisa

asnje

zgjedh!

ose

ose . . . ose

do të nisemi

më mirë

sesa

vonë

Notice:

sot

i sotëm

e sotme

të sotëm

të sotme

plani i sotëm

gazeta e sotme

today's plans/plans for today

often

village

the grandfather

the grandmother

wish; desire

takes us

room; place

there is room

for you

monastery

old

don't go

day

other

fishing

(you *pl.*) come!

good idea

maybe, perhaps

don't

while

none; not a . . .

choose!

or

either . . . or

we will set out

better

than

late

today

today's (*masc. sing.*)

today's (*fem. sing.*)

today's (*masc. pl.*)

today's (*fem. pl.*)

today's plan

today's paper

**IV/ EXERCISES**

(1) Answer the following questions on the dialogue:

- 1 Sa është ora?
- 2 Ku janë studentët anglezë?
- 3 Çka po bëjnë ata?
- 4 Për çka po bisedojnë?
- 5 Kush do të shkojë në fshat?
- 6 A ka Beti dëshirë të shkojë në fshat?
- 7 A ka vend për Betin në veturë?
- 8 Kush tjetër shkon me Merin e Betin?
- 9 A do të shkojnë Denisi me Antonin në Deçan sot?
- 10 Kush do të shkojë në peshkim?
- 11 Ku do të shkojnë Denisi, Antoni e Nora?
- 12 Çka do të bëjë Nora derisa të tjerët peshkojnë?
- 13 Në orën sa (*at what time*) do të vijë Petriti?
- 14 Në orën sa do të nisen?

(2) Fill in the blanks:

- (a) *A:* ..... , a shkon ky autobus për Prizren?  
*B:* Po.  
*A:* .....
- (b) *A:* Çka doni ..... ?  
*B:* Një kafe me pak sheqer, .....
- (c) Studentët anglezë po hanë ..... në restorant. Ata po bisedojnë për ..... e sotme. Meri ..... te një shoqe. Ajo ..... Merita. Gjyshi dhe ..... e saj jetojnë në fshat. Edhe Beti dëshiron ..... në fshat.
- (d) Nora dëshiron ..... në hotel e ..... por edhe ajo shkon në peshkim me Markun e Petritin. Ajo thotë (*says*): 'Derisa ju ..... unë .....

(3) Put the following sentences in the Future Tense:

*Example:* Sot po punoj në kopsht.

Nesër/punoj

Nesër do të punoj në kopsht.

- 1 Unë zakonisht ha drekë në shtëpi.  
 Nesër/restoran
- 2 Ai shpesh shkon në teatër.  
 Nesër/kinema
- 3 Ata shpesh shkojnë në kafene.  
 Nesër/teatër
- 4 Sot vjen Meri nga fshati.  
 Nesër/Nora e Drita nga Prizreni
- 5 Tash po flasim shqip.  
 Pastaj/anglisht.

## Unit Six

### ■ I/ SITUATIONS

më jep	give me
biletë	ticket
në orën sa	what time
e doni biletën	you want the ticket
ka	there is/are; has
urdhëroni	here you are
sa bën	how much is it
treqind	three hundred
dinar	dinar
ditën e mirë	good day ( <i>leaving</i> )
rruga e mbarë	have a nice journey

*A:* Më jep një biletë për Pejë, të lutem.  
*B:* Për në orën sa e doni biletën?

A: Për në orën tetë.  
 B: Më vjen keq, por nuk ka vend në autobusin e orës tetë.  
 A: Kur ka autobus tjetër për Pejë?  
 B: Në orën nëntë.  
 A: Atëherë më jep një biletë për orën nëntë.  
 B: Urdhëroni.  
 A: Falemnderit. Sa bën?  
 B: Treqind dinarë.  
 A: Ditën e mirë!  
 B: Ditën e mirë. Rruja e mbarë!

a të pëlqen	do you like
më pëlqen	I like
muzika angleze	English music
Bardhës	to Bardha
a i pëlqen	does she like

A: A të pëlqen muzika angleze?  
 B: Po, më pëlqen shumë.  
 A: Po Bardhës, a i pëlqen muzika angleze?  
 B: Po, edhe Bardhës i pëlqen shumë muzika angleze.

Shtëpia e Mallrave	Department Store
blesh	(you) buy
do t'i blej	I shall buy (her/him)
dhuratë	present
ditëlindje	birthday

A: Ku po shkon?  
 B: Në Shtëpinë e Mallrave.  
 A: Çka do të blesh?  
 B: Do t'i blej Norës një dhuratë për ditëlindje.

ç'i do	what do you want (them) for
kartolina	postcards
do t'u shkruaj	I'll write to (them)
shokëve	to (the) friends ( <i>dat.</i> )
e ka ditëlindjen	has his/her birthday
këto ditë	these days

A: Ç'i do ato kartolina?  
 B: Do t'u shkruaj shokëve në Angli. Njëra është për Gencin. Ai e ka ditëlindjen këto ditë.

### III GRAMMATICAL PATTERNS

#### Case Endings for Nouns

Nouns in Albanian have five different cases. Each of these cases depends on the particular role the noun plays in the sentence. For example, the Nominative is used for the subject of the sentence, the Accusative for the direct object, the Dative for the indirect object, the Genitive like English Genitive (to express possession), and the Ablative is mainly used with prepositions, the most typical being *prej* (*from*).

Try to see these roles from the following examples:

Mësuesi	ia	jep	librin	studentit
Subject	Critic		Direct	Indirect
			object	object
<i>Nominative</i>			<i>Accusative</i>	<i>Dative</i>
The teacher		gives	the book	to the student.

(The role of the clitic will be explained later in the chapter.)

Mësuesi i Zanës ia jep librin e Teutës vëllait të Dritës.

*Genitive*                   *Genitive*                   *Genitive*

The teacher of Zana gives the book of Teuta to the brother of Drita.

Studenti e merr librin prej mësuesit.

*Ablative*

The student takes the book from the teacher.

Although there are five different cases, there are not five different forms for the nouns. Often one form is shared by two or three cases, as you can see from the tables below.

#### I – Masculine singular nouns

	Indefinite	Definite
<i>Nom.</i>		studenti
<i>Acc.</i>	(një) student	studentin
<i>Gen.</i>	(i/e)	
<i>Dat.</i>		një studenti
<i>Abl.</i>	prej	studentit

## II – Masculine singular nouns

	<i>Indefinite</i>	<i>Definite</i>
<i>Nom.</i>	(një) shok	shoku
<i>Acc.</i>		shokun
<i>Gen.</i>	(i/e) një shoku	shokut
<i>Dat.</i>		
<i>Abl.</i>	prej	

## III – Feminine singular nouns

	<i>Indefinite</i>	<i>Definite</i>
<i>Nom.</i>	(një) studente	studentja
<i>Acc.</i>		studenten
<i>Gen.</i>	(i/e) një studenteje	studentes
<i>Dat.</i>		
<i>Abl.</i>	prej	

## IV – Neuter singular nouns

	<i>Indefinite</i>	<i>Definite</i>
<i>Nom.</i>	(një) të ftohtë	të ftohtët
<i>Acc.</i>		
<i>Gen.</i>	(i/e) një të ftohti	të ftohtit
<i>Dat.</i>		
<i>Abl.</i>	prej	

## V – Plural nouns

	<i>Indefinite</i>	<i>Definite</i>
<i>Nom.</i>	(ca some) studentë	studentët
<i>Acc.</i>		
<i>Gen.</i>	(i/e) ca studentëve	studentëve
<i>Dat.</i>		
<i>Abl.</i>	prej or studentësh	

In the plural, the use of the Ablative form ending in -sh is optional. There is no neuter plural, and all nouns decline in the same way irrespective of gender.

Study the use of cases in the following sentences:

Një djali i një fshati merr një lule prej një kopshti dhe ia jep një vajze të një qyteti.

A boy of a village takes a flower from a garden and gives it to a girl of a town.

Djali i fshatit e merr lulen prej kopshtit dhe ia jep vajzës së qytetit.

The boy of the village takes the flower from the garden and gives it to the girl of the town.

Ca djem të ca fshatrave marrin ca lule prej ca kopshtesh dhe ua japin ca vajzave të ca qyteteve.

Some boys of some villages take some flowers from some gardens and give them to some girls of some towns.

Djemtë e fshatrave i marrin lulet prej kopshteve dhe ua japin vajzave të qyteteve.

The boys of the villages take the flowers from the gardens and give them to the girls of the towns.

*The Genitive Particle*

Notice that in the preceding examples the Genitive particle can be **i**, **e**, **të** or **së** depending on the gender, number, definiteness and case of the noun it follows. There is no need to panic, because as you will see from the following examples and tables, the forms of the particle follow a rather straightforward pattern.

NOM. followed by GEN.

masc.	sing.	<i>indef.</i> një student <i>def.</i> studenti	i } një kolegji i } kolegjit	të } një kolegji të } kolegjit të } ca kolegjeve të } kolegjeve
	pl.	<i>indef.</i> ca studentë <i>def.</i> studentët	të } ca kolegjeve e } kolegjeve	
	sing.	<i>indef.</i> një studente <i>def.</i> studentja	e } një shkolle e } shkollës	
	pl.	<i>indef.</i> ca studente <i>def.</i> studentet	të } ca shkollave e } shkollave	

ACC. followed by GEN.

masc.	sing.	<i>indef.</i> një student <i>def.</i> studentin	të } një kolegji e } kolegjit	but unë e bleva një libër I bought a book unë e bleva një libër I bought a book (i.e. a specific or particular book)
	pl.	<i>indef.</i> ca studentë <i>def.</i> studentët	të } ca kolegjeve e } kolegjeve	
	sing.	<i>indef.</i> një studente <i>def.</i> studenten	të } një shkolle e } shkollës	
	pl.	<i>indef.</i> ca studente <i>def.</i> studentet	të } ca shkollave e } shkollave	

GEN./DAT./ABL. followed by GEN.

(Remember: **i/e** goes before Gen., **prej** before Abl.)

masc.	sing.	<i>indef.</i> një studenti <i>def.</i> studentit	të } një kolegji të } kolegjit
	pl.	<i>indef.</i> ca studentëve or <i>def.</i> studentësh	të } ca kolegjeve
	sing.	<i>indef.</i> një studenteje <i>def.</i> studentes	të } një shkolle së } shkollës
	pl.	<i>indef.</i> ca studenteve or <i>def.</i> studentesh	të } ca shkollave
fem.	sing.	<i>indef.</i> një studente <i>def.</i> studentja	të } një shkollave
	pl.	<i>indef.</i> ca studente <i>def.</i> studentet	të } shkollave

*The Declension of Personal Pronouns and Clitics*

Clitics are forms of personal pronouns which are placed before the verb in Albanian. They are used when the object of the verb is a definite noun, or an indefinite noun which is in some way made more specific, e.g.

unë bleva libër I bought a book

but unë e bleva një libër I bought a book (i.e. a specific or particular book)

When there is an indirect object which is in the dative case, a dative clitic must be placed before the verb, e.g.

unë i shkrova nënës I wrote to my mother

The following table shows the declension of personal pronouns and the clitics which correspond to them.

### Singular

	Pron.	Cl.	Pron.	Cl.	Pron.	Cl.	Pron.	Cl.
<i>Nom.</i>	unë	-	ti	-	ai	-	ajo	-
<i>Acc.</i>	mua	më	ty	të	atë	e	atë	e
<i>Gen.</i>	-	-	-	-	-	-	-	-
<i>Dat.</i>	mua	më	ty	të	atij	i	asaj	i
<i>Abl.</i>	meje	-	teje	-	(a)tij	-	(a)saj	-

### Plural

<i>Nom.</i>	ne	-	ju	-	ata	-	ato	-
<i>Acc.</i>	ne	na	ju	ju	ata	i	ato	i
<i>Gen.</i>	-	-	-	-	-	-	-	-
<i>Dat.</i>	neve	na	juve	ju	atyre	u	atyre	u
<i>Abl.</i>	nesh	-	jush	-	(a)tyre	-	(a)tyre	-

When there are both direct and indirect objects in the sentence which require the use of clitics, the two clitics are placed together. The dative clitic comes first and combines with the accusative clitic to produce one single word, with the forms as shown in the table below (**na i/e** is the only exception, remaining as two words).

<i>Dat. clitic</i>	<i>Acc. clitic</i>		<i>Example</i>
më	+ e	= ma	Ma jep librin
të	+ e	= ta	Ta jep librin
i	+ e	= ia	Ia jep librin
na	+ e	= na e	Na e jep librin
ju	+ e	= jua	Jua jep librin
u	+ e	= ua	Ua jep librin
më	+ i	= m'i	M'i jep librat
të	+ i	= t'i	T'i jep librat
i	+ i	= ia	Ia jep librat
na	+ i	= na i	Na i jep librat
ju	+ i	= jua	Jua jep librat
u	+ i	= ua	Ua jep librat

An example:

**Petriti ia jep librin Markut.** Petrit gives the book to Mark.

### *Demonstratives*

The full declension of the demonstratives is as follows:

### Singular

## Plural

**Possessive Adjectives**

Some of the possessive adjectives have already been met in Unit Two. Here is the complete list of the nominative case forms.

a) When the possessed object is a definite masculine singular noun, the possessive adjectives are:

Ky	është	libri	im	my
			yt	your
			i tij	his
			i saj	her
			ynë	our
			juaj	your
			i tyre	their

This is my/your etc. book.

b) When the possessed object is a definite feminine singular noun, the possessive adjectives are:

Kjo	është	shkolla	ime	my
			jote	your
			e tij	his
			e saj	her
			jonë	our
			juaj	your
			e tyre	their

This is my/your etc. school.

c) When the possessed object is a definite masculine plural noun, the possessive adjectives are:

Këta	janë	lapsat	e mi	my
			e tu	your
			e tij	his
			e saj	her
			tanë	our
			tuaj	your
			e tyre	their

These are my/your etc. pencils.

d) When the possessed object is a definite feminine plural noun, the possessive adjectives are:

Këto	janë	fletoret	e mia	my
			e tua	your
			e tij	his
			e saj	her
			tona	our
			tuaja	your
			e tyre	their

These are my/your etc. notebooks.

**'To Like'**

Notice the following construction with the verb pëlqej – (I) like:

(Mua)	më	pëlqen	muzika	I like music
(Ty)	të	pëlqen	muzika	You like music
(Atij)	i	etc.		etc.
(Asaj)	i			
(Neve)	na			
(Juve)	ju			
(Atyre)	u			

This literally means 'Music is pleasing to me/you/him etc.'

**■ III/ READING PASSAGE****HOBİ I SKËNDERIT**

Fqinji i Petritit, Skënderi, ka një hobi të vjetër. Ai çdo të diel shkon në peshkim. Zakonisht shkon vetëm në peshkim. Ndonjëherë e merr edhe Petritin me vete. Skënderi nuk ka fat në peshkim. Shpesh në grep i bie ndonjë çizme e vjetër. Petriti është peshkatar i mirë. Ai zë shumë peshq.

Skënderi vetëm e kalon kohën e lirë në peshkim. Ai nuk ka shumë dëshirë të zërë shumë peshq. Pasi që i zë ai shpesh i lëshon peshqit përsëri në ujë. Shokët ndonjëherë e tallin për këtë, por ai nuk lodhet për talljet e tyre.

Të dielën e ardhshme Skënderi do të shkojë në peshkim me Petritin dhe disa nga shokët e tij anglezë. Ata do të nisen herët

në mëngjes dhe nuk do të kthehen deri në mbrëmje. Nuk do të marrin ushqim me vete. Drekë do të hanë në një motel buzë likenit. Shpresojnë se moti do të jetë i mirë. Skënderi pret me padurim t'i takojë shokët e Petritit nga Anglia.

*Vocabulary*

<b>hobi</b>	hobby
<b>fqinji</b>	the neighbour
<b>e diel</b>	Sunday
<b>peshkim</b>	fishing
<b>ndonjëherë</b>	sometimes
<b>e</b>	(Acc. <i>clitic</i> ) him/her/it
<b>me vete</b>	with him; along
<b>fat</b>	luck
<b>grep</b>	hook
<b>i</b>	(Dat. <i>clitic</i> ) to him/her/it.
<b>i bie</b>	falls to him
<b>ndonjë</b>	some
<b>çizme</b>	boot
<b>peshkatar</b>	fisherman
<b>zë</b>	catches
<b>peshq</b>	<i>pl. of peshk</i> – fish
<b>kaloj</b>	spend
<b>kohë e lirë</b>	spare time
<b>zërë</b>	catch
<b>pasi që</b>	since, after
<b>i lëshon</b>	drops them
<b>përsëri</b>	again
<b>ujë</b>	water
<b>e tallin</b>	they mock him
<b>nuk lodhet</b>	isn't bothered ( <i>lit. doesn't get tired</i> )
<b>tallje</b>	mockery
<b>e ardhshme</b>	next ( <i>lit. future</i> )
<b>kthehen</b>	return ( <i>3rd pers. pl.</i> )
<b>deri</b>	till
<b>mbrëmje</b>	evening

<b>do të marrin</b>	will take
<b>ushqim</b>	food
<b>motel</b>	motel
<b>buzë likenit</b>	by the lake
<b>shpresojnë</b>	they hope
<b>se</b>	that
<b>moti</b>	the weather
<b>pret</b>	waits
<b>me padurim</b>	with impatience
<b>t'i takojë</b>	to meet (them)

*The Year*

<b>viti</b>	<b>the year</b>	<b>pranvera</b>	<b>spring</b>
<b>stinët</b>	<b>the seasons</b>	<b>vera</b>	summer
		<b>vjeshta</b>	autumn
		<b>dimri</b>	winter
<b>muajt</b>	<b>the months</b>	<b>janar</b>	January
		<b>shkurt</b>	February
		<b>mars</b>	March
		<b>prill</b>	April
		<b>maj</b>	May
		<b>qershor</b>	June
		<b>korrik</b>	July
		<b>gusht</b>	August
		<b>shtator</b>	September
		<b>tetor</b>	October
		<b>nëntor</b>	November
		<b>dhjetor</b>	December
<b>ditët e javës</b>	<b>the days of the week</b>	<b>e hënë</b>	Monday
		<b>e martë</b>	Tuesday
		<b>e mërkurë</b>	Wednesday
		<b>e enjte</b>	Thursday
		<b>e premte</b>	Friday
		<b>e shtunë</b>	Saturday
		<b>e diel</b>	Sunday

**IV/ EXERCISES**

(1) Answer the following questions on the reading passage:

- 1 Si quhet fqinji i Petritit?
- 2 Cili është hob i tij i vjetër?
- 3 Ç'ditë shkon ai në peshkim?
- 4 A shkon vetëm apo (*or*) me shokë?
- 5 Kë e merr me vete ndonjëherë?
- 6 A ka Skënderi fat në peshkim?
- 7 A është Petriti peshkatar i mirë?
- 8 Ç'i bie ndonjëherë në grep Skënderit?
- 9 A ka dëshirë Skënderi të zërë peshq?
- 10 Ç'bën ai shpesh me peshqit kur i zë?
- 11 A e tallin shokët shpesh?
- 12 A lodhet ai për talljet e tyre?
- 13 Me kë do të shkojë Skënderi në peshkim të dielën e ardhshme?
- 14 A do të marrin ushqim me vete?
- 15 Ku do të hanë drekë?
- 16 Si do të jetë moti?
- 17 A pret Skënderi me padurim t'i takojë shokët e Petritit?

(2) Fill in the blanks with the appropriate form of the pronoun:

- 1 Norë, eja me ..... (unë).
- 2 Ti, Riçard shko me ..... (ai).
- 3 Mësuesi do të na japë disa libra ..... (ne), e jo ..... (ju).
- 4 Ky nuk është libri im, është libri ..... (ajo).
- 5 Kjo nuk është shkolla juaj, është shkolla ..... (ata).
- 6 ..... (ti) të kam shok të mirë, por edhe ..... (ai) e kam shok të mirë.
- 7 Ti do të marrësh disa libra prej ..... (unë).
- 8 Unë do të marr disa fletore prej ..... (ti).
- 9 Ata mund (*can*) të marrin disa lapsa prej ..... (ne).
- 10 Dëshiroj të marr një kartolinë prej ..... (ju).

(3) Put the appropriate pronoun instead of the names given in bold script:

- 1 Shtëpia e **Dritës** është e bukur.
- 2 Do t'u jap **Dritës** e **Norës** dy bileta për teatër.
- 3 Kjo është shkolla ime **dhe** e **Gencit**.
- 4 Këta janë shokët e **mi** **dhe** të **Agronit**.
- 5 Këto janë fletoret e mia **dhe** të **Zanës**.
- 6 Ky është fakulteti **im** **dhe** i **Agimit**.
- 7 Ky është vëllai i **Teutës**.
- 8 Kjo është motra e **Skënderit**.

(4) Construct sentences using the verb *pëlqej*, using the example below as a model:

*Example:* Unë / muzika klasike  
Mua më pëlqen muzika klasike.

- 1 Ti / neg. peshkimi
- 2 Ne / filmat e vjetër
- 3 Ai / të shkojë në fshat
- 4 Ato / të punojnë në kopsht
- 5 Ju / të viziton shokët
- 6 Ato / teatri
- 7 Ajo / të lexojë libra
- 8 Unë / neg. të shikoj televizionin

(5) Translate into Albanian:

Agim has a sister. His sister is married and lives in a village not far from the town. Agim often visits his sister. In summer he goes to the village every Sunday. He usually stays there all day. His sister has three children, two boys and a girl. When the weather is nice, Agim and the children go fishing. When they are lucky they catch one fish.

# Unit Seven

## ■ I/ SITUATIONS

sa bëjnë	how much are they
vetë	the eggs
të thyerat	the broken ones ( <i>fem.</i> )
m'i thyej	break them for me

A: Sa bëjnë vetë?

B: Tridhjetë dinarë.

A: Po këto të thyerat?

B: Pesëmbëdhjetë.

A: M'i thyej njëzet, të lutem.

duhet të shkoj	I should go
mund	can; could
mund të shkosh	you can go
taksi,-a	taxi
para (+ <i>Abl.</i> )	in front of

A: Duhet të shkoj te Petriti, por nuk ka autobus.

B: Mund të shkosh me taksi.

A: Ku mund të gjej taksi?

B: Para hotelit.

sepse	because
shoh	(I) see
përditë	every day

A: Pse nuk shkon me shokët e tu?

B: Sepse ata i shoh përditë, kurse ty nuk të shoh përditë. Dua të jem me ty sot.

ke qenë	(you) have been
më parë	before
hera e parë	the first time
ndonjëherë	any time; ever
kam qenë	(I) have been

herë time  
A: A ke qenë më parë në Kosovë?  
B: Jo, kjo është hera e parë. Po ti, a ke qenë ndonjëherë në Angli?  
A: Po, kam qenë dy herë në Angli.

kam punuar	(I) have worked
gjatë (+ <i>Abl.</i> )	during
vikend	weekend
çka keni bërë	what have you done
kam shkuar	(I) have gone
kam pushuar	(I) have rested
gjithë	all; the whole
pakëz	a little (bit)

Genci: Unë kam punuar në kopsht gjatë vikendit. Po ju, çka keni bërë?

Marku: Unë kam shkuar në kinema me Merin.

Beti: Unë kam shkuar në restorant me Riçardin.

Nora: Unë kam pushuar gjatë gjithë vikendit dhe përsëri jam pakëz e lodhur.

## II/ GRAMMATICAL PATTERNS

### Modal Verbs

Duhet and mund can be used as modal verbs just like *should*, *must*, *can* and *could* in English. Like the modals in English, they also keep the same form for all persons when followed by a main verb. Notice the different degrees of obligation denoted by different uses of duhet:

duhet të shkoj	I should go
më duhet të shkoj	I must go
më duhet patjetër (by all means) të shkoj	I must go (stronger obligation)

Notice the difference in behaviour of mund compared to *can* in English. When mund is not followed by a main verb it takes the appropriate verb endings:

- A mund të vijsh nesër tek Can you come to my place tomorrow?

- Po, mund tē vij./Po,  
mundem.

After modals such as **duhet** and **mund** the main verb is always in the subjunctive.

### The Perfect Tense

This tense mainly corresponds to the Present Perfect in English (meaning 'have done'). It is formed in a similar way by means of the auxiliaries **kam** (*have*) or **jam** (*be*) plus the participle. **Kam** is used with active verbs, and **jam** with verbs termed 'non-active'. ('Non-active' covers passive and reflexive forms; non-active verbs are designated as such in the glossary at the end of the book).

The participle of **punoj** is **punuar** and the Perfect Tense of **punoj** is

<b>kam punuar</b>	I have worked	<b>kemi punuar</b>	we have worked
<b>ke punuar</b>	you have worked	<b>keni punuar</b>	you have worked
<b>ka punuar</b>	he/she has worked	<b>kanē punuar</b>	they have worked

Here is an example of a non-active verb:

**quhem** (*be called*)

<b>jam quajtur</b>	I have been called	<b>jemi</b>	we have been called
<b>je quajtur</b>	you have been called	<b>quajtur</b>	called
<b>eshtē</b>	he/she has been called	<b>jeni quajtur</b>	you have been called

The Perfect of non-active verbs should not be confused with the Present Passive in English. Study the following examples:

<b>Active verb:</b>	<b>Quaj</b>	I call ( <i>somebody something</i> )
	<b>Kam quajtur</b>	I have called ( <i>somebody something</i> )
<b>Non-active verb:</b>	<b>Quhem</b>	I am called
	<b>Jam quajtur</b>	I have been called

The non-active Perfect can also be easily confused with the construction **jam** followed by an adjective deriving from a participle. Notice the difference:

**Jam i lodhur**

I am tired

**Jam lodhur**

I have got tired

The verb here is **lodh** 'tire'/**lodhem** 'get tired'.

Here is a list of some of the verbs introduced before now, showing the participle and the singular imperative. (Full treatment of the imperative will be found in Unit 21.)

<i>Present</i>	<i>Participle</i>	<i>Imperative</i>	<i>Meaning</i>
bisedoj	biseduar	bisedo	talk
çoj	çuar	ço	take to; send
dërgoj	dërguar	dërgo	send
dëshiroj	dëshiruar	dëshiro	wish; desire
jetoj	jetuar	jeto	live
punoj	punuar	puno	work
shkoj	shkuar	shko	go
shkruaj	shkruar	shkruaj	write
dua	dashur	duaj	want
eci	ecur	ec	walk
fal	falur	fal	give away
flas	folur	fol	speak
di	ditur	di	know
gjej	gjetur	gjej	find
luaj	luajtur	luaj	play
lodh	lodhur	lodh	tire ( <i>someone</i> )
përshëndet	përshëndetur	përshëndet	greet
pres	pritur	prit	wait
shes	shitur	shit	sell
shëtit	shëtitur	shëtit	stroll
zgjedh	zgjedhur	zgjedh	choose
ul	ulur	ul	sit, seat
vij	ardhur	eja	come
rri	ndenjur	rri	stay
këmbej	këmbyer	këmbe	exchange
thyej	thyer	thyej	break
bëj	bëre	bëj	do
blej	blerë	blrij	buy
pi	pirë	pi	drink

zë	zënë	zër	catch
ha	ngrënë	ha	eat
bie	rënë	bjer	fall
jap	dhënë	jep	give
them	thënë	thuaj	say
shoh	parë	shih	see
marr	marrë	merr	take
jam	qenë	ji	be
kam	pasur	ki	have

### ■ III/ DIALOGUE

#### NORA U SHKRUAN PRINDËRVE

- Nora:* Merita, a vjen me mua? Më duhet të blej disa zarfa.
- Merita:* Do të shkruash letra?
- Nora:* Po, kam disa shokë e shoqe të cilëve më duhet t'u shkruaj. Por së pari do t'u shkruaj prindërve. Nuk i kam shkruar askujt qysh se kam ardhur. Përtoj të shkruaj letra.
- Merita:* Edhe unë jam përtace. Shumë rrallë shkruaj letra. Por gëzohem shumë kur marr letra.
- Nora:* Edhe unë jam e tillë. Përtoj të shkruaj, por më pëlqen të marr letra.
- Merita:* Unë shpesh nuk di çka të shkruaj.
- Nora:* Edhe mua shpesh më ndodh ashtu. Por tash kam çka t'u tregoj prindërve. Do t'u tregoj se po kaloj shumë mirë në Kosovë. Do t'u tregoj se e kam vizituar Dritën në Prizren; se prindërít e Dritës më kanë pritur mirë. Do t'u tregoj se kemi qenë në peshkim. A kam çka t'u tregoj tjetër?
- Merita:* Sigurisht do t'u shkruash për motin. Për ju anglezët moti është shumë me rëndësi.
- Nora:* O po, patjetër. Do t'u shkruaj se moti ka qenë i mirë; se kemi pasur ditë të bukura me diell.
- Merita:* A kanë shkuar prindërít e tu në pushim këtë verë?
- Nora:* Jo, ende nuk kanë shkuar. Ndoshta do të shkojnë kur të kthehem unë. Ata zakonisht shkojnë në Spanjë.

- Merita:* Përvendetet prindërít për mua, të lutem.
- Nora:* Gjithsesi. Ti i ke takuar prindërít e mi kur ke qenë në Angli.
- Merita:* Po. Ke prindër shumë të mirë. A di çka, Norë. Po u dërgoj një kartolinë. A t'u dërgoj një kartolinë me një pamje të qytetit apo një me veshje kombëtare?
- Nora:* Një me veshje kombëtare do t'u pëlqejë më shumë. Merita, mos të harrojmë të kthejmë në bankë pastaj. Do të këmbej ca para. I kam shpenzuar gati të gjitha.
- Merita:* Ani, Norë, pasi t'i blejmë zarfat e pullat postale, shkojmë në bankë.

#### Vocabulary

zarfa	envelopes
letra	letters
të cilëve	to whom (pl.)
së pari	first; at first
prindërve	to the parents
askujt	to nobody/anybody
qysh se	since
përtoj	(I am) lazy
përtace	lazy (fem.)
rrallë	rarely; seldom
gëzohem	(I am) pleased
marr letra	receive letters
e tillë	such (fem.)
më ndodh	happens to me
ashtu	so; like that
tregoj	tell
tjetër	other; else
se	that
çka tjetër	what else
sigurisht	certainly
me rëndësi	with importance (lit.)
patjetër	by all means
diell	sun
pushim	holiday

ende	still; yet
ndoshta	perhaps; maybe
përshëndeti	greet them ( <i>imperative</i> )
gjithsesi	by all means
a di çka	you know what
pamje	view
veshje kombëtare	national costume
mos tē harrojmë	let us not forget
këmbej ca para	(I) exchange some money
i kam shpenzuar	(I) have spent them
gati tē gjitha	almost all
pasi	after
pullat postale	the stamps

**IV/ EXERCISES**

(1) Answer the following questions on the dialogue:

- 1 Çka i duhet Norës tē blejë?
- 2 Kujt do t'i shkruajë Nora?
- 3 Kujt do t'i shkruajë së pari?
- 4 A i ka shkruar kujt qysh se ka ardhur në Kosovë?
- 5 Pse nuk shkruan ajo letra shpesh?
- 6 A shkruan Merita letra shpesh?
- 7 A u pëlqen Norës e Meritës tē marrin letra?
- 8 Çka do t'u tregojë Nora prindërve?
- 9 A do t'u shkruajë pér motin?
- 10 Si ka qenë moti?
- 11 Ku shkojnë zakonisht prindërit e Norës në pushim?
- 12 A i ka takuar Merita prindërit e Norës?
- 13 Kur i ka takuar?
- 14 Çka thotë ajo pér prindërit e Norës?
- 15 Çka do t'u dërgojë ajo atyre?
- 16 Ku do tē shkojnë Nora e Merita pasi t'i blejnë zarfat e pullat postale?
- 17 Pse do tē shkojnë atje?

(2) Put the following sentences in the second and third person singular:

*Example:* Unë do tē punoj nē kopsht.

Ti do tē punosh nē kopsht.

Ai/ajo do tē punoje nē kopsht.

- 1 Do tē lexoj (*read*) një libër.
- 2 Do tē blej një veturë.
- 3 Do tē ha drekë nē restorant.
- 4 Do t'i shkruaj një letër shoqes.
- 5 Do tē këmbej ca para nē bankë.
- 6 Do t'i dërgoj vëllait një dhuratë pér ditëlindje.
- 7 Do tē zgjedh ca kartolina pér shokët.
- 8 Sot do tē flas shqip.
- 9 Nesër do tē rri nē shtëpi.

(3) Supply the Perfect Tense of the verbs in brackets:

- 1 (*unë*) Para disa ditësh (*a few days ago*) e .....  
(lexoj) një libër.
- 2 Ky libër më ..... (pëlqej) shumë.
- 3 Kur e ..... (vizitoj) Nora shokun?
- 4 I ..... (tregoj) shokut se do tē vijsh.
- 5 Nora e Riçardi ..... (shkoj) nē restorant.
- 6 Nora ..... (pushoj) por përsëri është e lodhur.
- 7 Petriti e Genci i ..... (dërgoj) një letër shokut nē shqip.
- 8 Unë e ti nuk ..... (marr) letër nga shoku.
- 9 A ..... (zë) peshq ndonjëherë, Mark?
- 10 (*unë*) E ..... (gjej) një restorant tē mirë.  
Quhet 'Tratoria Romantika'.
- 11 (*unë*) Ende nuk e ..... (takoj) shoqen e saj.
- 12 (*ata*) Nuk e ..... (kuptoj) mësimin mirë.
- 13 Ai gjithnjë (*always*) ..... (dëshiroj) tē bëhet (*become*) mjek.
- 14 Ju e ..... (shëtit) gjithë Evropën (*Europe*).

## (4) Do as in the example:

*Example:* Do të shkoj në kino / bashkë në teatër

Mos shko në kino. Të shkojmë (*let's go*) bashkë në teatër.

- 1 Sot do të udhëtoj për Prizren / nesër bashkë
- 2 Do të shkoj me autobus / bashkë me taksi
- 3 Do të blej cigare / çokolatë
- 4 Do të flas anglisht / shqip
- 5 Do të zë peshq sot / bashkë të dielën
- 6 Do t'i dërgoj Norës një kartolinë nesër / një bashkë sot
- 7 Do të mësoj frëngjisht / bashkë turqisht

## (5) Complete the following situations using the Perfect Tense:

- (a) Moti ..... (jam) shumë i keq (*bad*). Ka qenë ftohtë dhe nuk ..... (shkoj) në kinema unë e Agimi.
- (b) – Je e lodhur, Norë.  
– Sigurisht. .... (punoj) në kopsht dy orë.
- (c) – Je i gëzuar, Genc.  
– Sigurisht. .... (marr) një dhuratë për ditëlindje nga një shoqe angleze.
- (d) – Kur e ke ..... (blej) këtë veturë?  
– Para tri vjetësh.  
– A të ka ..... (punoj) mirë?  
– Shumë mirë.
- (e) – A ke ..... (ha) drekë?  
– Jo, nuk kam ..... (ha) ende.  
– Pse?  
– Nuk dëshiroj të ha vetëm.

## Unit Eight

### ■ I/ SITUATIONS

humbur	lost
shpallje	announcement
sa vlen	what's it worth
lexoj	read

A: Më ka humbur qeni.

B: Pse s'e jep një shpallje në gazetë?

A: Sa vlen? Qeni im s'di të lexojë.

shpejtësi	speed
dritë	light
arrij	arrive
tepër herët	too early

*Mësuesi:* A di të më tregosh me ç'shpejtësi udhëton drita?

*Nxënësi:* Jo, por e di se këtu arrin tepër herët.

njerëz	people
duke	while
kafe	coffee
i pari	the first (one)
tha	said
aq . . . sa	so . . . that
(i/e) mençur	clever
ta dërgoj	to send it
u merr erë	sniffs them
kuti	box
(i/e) freskët	fresh
i dyti	the second (one)
gjithnjë	always
cigare	cigarette
më së shumti	most

të dy	the two; both (of them)
pyes	ask
i treti	the third (one)
dëgjoj	hear
për ndonjë qen	of any dog
njeri	man
e mundshme	possible ( <i>fem.</i> )
udhëheq	run; lead
dyqan	shop
blerje	shopping

Disa njerëz, duke pirë kafe, bisedojnë për qentë e tyre. I pari tha:

'Qeni im është aq i mençur sa që mund ta dërgoj të më blejë vezë. Ai u merr erë kutiave dhe nuk i merr vezët nëse nuk janë të freskëta.'

I dyti tha:

'Qeni im është aq i mençur sa që gjithnjë shkon të më blejë cigare. Ai e di cilat më pëlqejnë më së shumti.'

Të dy njerëzit e pyetën të tretin:

'A ke dëgjuar për ndonjë qen që është më i mençur sesa qentë tanë?'

Njeriu i tretë tha:

'Është vetëm një qen më i mençur sesa qentë tuaj. Qeni im.'

Dy njerëzit e tjerë thanë:

'Nuk është e mundshme.'

I treti tha:

'Qeni im e udhëheq dyqanin ku e bëjnë blerjen qentë tuaj.'

## II/ GRAMMATICAL PATTERNS

### The Simple Past (Past Definite)

The following are the characteristic sets of endings for this tense, for different persons in singular and plural.

Singular	Plural
-a	-am/-ëm/-më
-e	-at/-ët/-të
-i/-u	-an/-ën/-në

Since the stem of most of the verbs on which this tense is built ends in a vowel, for ease of pronunciation a consonant, usually

the sound [v], comes between the verb stem and the ending for the first and second person singular. Some verbs form this tense irregularly. Below are a number of verbs grouped according to the way they form this tense:

#### I. Example:

punoj	
Singular	Plural
punova	punuam
punove	pnuuat
punoi	pnuuan

All verbs ending in -oj in the first person singular of the Present Tense conjugate in the same way. Such are:

bisedoj	- talk
çoj	- take to; send
dërgoj	- send
dëshiroj	- wish; desire

#### II Example:

gjej	
Singular	Plural
gjeta	gjetëm
gjete	gjetët
gjeti	gjetën

Other verbs conjugating like gjej are: mbaj (*hold; keep*), di, luaj

#### III. Example:

blej	
Singular	Plural
bleva	blemë
bleve	bletë
bleu	blenë

Other verbs conjugating like blej are: kthej (*turn; return*), këmbej, fryj (*blow*)

#### IV. Example:

shkruaj	
Singular	Plural
shkrova	shkruam

shkrove	shkruat
shkroi	shkruan

The verb **paguaj** (*pay*) conjugates in the same way.

#### V. Example:

<b>hyj</b> ( <i>enter</i> )	
<i>Singular</i>	<i>Plural</i>
hyra	hymë
hyre	hytë
hyri	hynë

The verb **bëj** conjugates in the same way.

#### VI. Example:

<b>lut</b> ( <i>ask, pray, plead</i> )	
<i>Singular</i>	<i>Plural</i>
luta	lutëm
lute	lutët
luti	lutën

The verbs **fal** (*give away, excuse*), **nis** conjugate in the same way.

#### VII. Example:

<b>marr</b>	
<i>Singular</i>	<i>Plural</i>
mora	morëm
more	morët
mori	morëm

Verbs of this type undergo a change in the stem. The endings follow the above pattern. Some examples are: **zgjedh** – **zgjodha**, **heq** – **hoqa** (*remove*), **sjell** – **solla** (*bring, fetch*), **flas** – **fola**, **shes** – **shita**, **pres** – **prita** (*wait*), **zë** – **zura**, **vë** – **vura** (*put*), **dua** – **deshë**.

A number of verbs undergo more change in the stem and some of them a complete change.

#### VIII. Example:

<b>ha</b>	
<i>Singular</i>	<i>Plural</i>
hëngra	hëngrëm
hëngre	hëngrët

#### hëngri      hëngrën

Two other verbs of this type are: **rri** – **ndenja**, **vij** – **erdha**. Notice that the endings follow the pattern of other more regular verbs given above.

#### IX. Example:

#### them

<i>Singular</i>	<i>Plural</i>
thashë	thamë
the	thatë
tha	thanë

A few other verbs that follow this pattern are: **jap** – **dhashë**, **shoh** – **pashë**, **lë** – **lashë** (*leave*).

#### The Simple Past of **jam** and **kam**:

<b>jam</b>		<b>kam</b>	
qeshë	qemë	pata	patëm
qe	qetë	pate	patët
qe	qenë	pati	patën

#### ■ III/ READING PASSAGE

#### ZANA NË DYQANIN E PEMËVE DHE PERIMEVE

Sot Zana do ta bëjë blerjen për herë të parë. Ajo mendon se tash është e madhe dhe di ta bëjë blerjen. Nëna e lejoi ta bëjë blerjen pa qenë e sigurt se do ta bëjë si duhet.

Zana mori paratë dhe shportën, veshi pallton, mbathi këpucët dhe shkoi. Dyqani i pemëve dhe perimeve nuk është larg shtëpisë së Zanës. Nëna e Zanës e njeh pemëshitësin. Ai quhet Shpend. Shpendi është një njeri shumë i mirë dhe i sjellshëm. Ai i njeh pothuaj të gjithë blerësit, të cilët e duan dhe e nderojnë shumë. Të gjithë blerësit e quajnë Baca Shpend. Ai gjithnjë shet pemë dhe perime të freskëta. Nga pemët shet mollë, dardhë, rrush, limonë, qershi, portokaj, banane, fiq, kumbulla, pjeshkë e të tjera. Nga perimet shet specia, hudhra, qepë, domate, patate, tranguj, karota, groshë e të tjera. Shpendi ndonjëherë shet edhe bulmete të ndryshme si qumësht, kos, gjalpë, djathë e të tjera.

Meqë nëna e Zanës e njeh Shpendin, edhe nëse bën Zana ndonjë gabim në blerje, nuk prish punë.

Vocabulary	
pemë	fruit
perime	vegetable
për herë të parë	for the first time
mendoj	think
lejoj	permit, let
i/e sigurt	sure
si duhet	as one should
shportë	basket
vesh	put on ( <i>clothes</i> )
pallto	coat
mbath	put on ( <i>shoes, socks</i> )
këpucë	shoes
njoh	know ( <i>somebody</i> )
pemëshitës	greengrocer
njeri	man
i sjellshëm	polite ( <i>masc.</i> )
pothuaj	almost
blerës	buyer
nderoj	respect
Bacë	'Uncle' ( <i>used as an endearment to address an older person, or brother</i> )
gjithnjë	always
shes	sell
i/e freskët	fresh
mollë	apple
dardhë	pear
rrush	grapes
limonë	lemon
qershi	cherry
portokall	orange
banane	banana
fik	fig
kumbull	plum
pjeshkë	peach
e të tjera	and so on
spec	green pepper
hudhër	garlic
qepë	onion

domate	tomato
patate	potato
trangull	cucumber
karotë	carrot
groshë	bean
bulmet	dairy product
të ndryshme	different ( <i>fem. pl.</i> )
qumëshë	milk
kos	sour milk
gjalpë	butter
djathë	cheese
meqë	since
gabim	mistake
nuk prish punë	it doesn't matter

#### Exercise

(1) Answer the following questions on the reading passage:

- 1 Çka do të bëjë Zana sot?
- 2 Çka mendon ajo?
- 3 Si e lejon nëna ta bëjë blerjen?
- 4 Çka mori Zana?
- 5 Çka veshi ajo?
- 6 Çka mbathi ajo?
- 7 Ku është dyqani i pemëve dhe perimeve?
- 8 A e njeh nëna e Zanës pemëshitësin?
- 9 Si quhet pemëshitësi?
- 10 Si e quajnë blerësit atë?
- 11 Çfarë (*what . . . like*) është ai?
- 12 A e nderojnë blerësit atë?
- 13 Çka shet Shpendi nga pemët?
- 14 Po nga perimet?
- 15 Çka shet tjetër ndonjëherë?

#### ■ IV/ DIALOGUE

**ZANA E BËN BLERJEN**  
 Petriti: Ku shkoi Zana, nënë?  
 Nëna: Shkoi në dyqanin e Bacës Shpend.

Petriti: Çka i the tē blejë?  
 Nëna: I thashë tē na blejë ca pemë e perime.  
 Petrifi: Nuk besoj se Zana di ta bëjë blerjen.  
 Nëna: As unë, por nuk prish punë edhe nëse gabon. Shpendi na njeh.  
 Petrifi: Ja po vjen Zana me shportën plot. Eja, Zanë, e na trego si e bëre blerjen?  
 Zana: Prit.... Sapo hyra në dyqan, i thashë Bacës Shpend, 'Puna mbarë, Baca Shpend!'. Ai më tha, 'Mbarë paç, çupa ime. Urdhëro, ç'dëshiron tē blesh?'. Pastaj unë i kërkova një kilogram rrush, gjysmë kilogrami qepë, dy kilogramë mollë... krejt çka më porositi nëna. Ja, këtu i kam tē gjitha në shportë.  
 Petrifi: Sa kushtuan tē gjitha këto, Zanë?  
 Zana: Nuk di. Baca Shpend nuk më tregoi.  
 Petrifi: Pse nuk e pyete kur ia dhe tē hollat, Zanë?  
 Zana: Uh, paskam harruar t'ia jap tē hollat. Më fal nënë....  
 Nëna: S'ka gjë, bija ime. Ia jap unë më vonë. Por, mos harro, kur tē blesh diçka, duhet edhe tē paguash.

**Vocabulary**

<b>besoj</b>	believe
<b>as unë</b>	me neither
<b>gaboj</b>	make a mistake
<b>plot</b>	full
<b>prit!</b>	wait!
<b>sapo</b>	as soon as
<b>hyj (në)</b>	enter
<b>puna mbarë!</b>	'may your work go well' <i>a reply to the previous</i>
<b>mbarë paç</b>	little girl ( <i>a term of endearment</i> )
<b>çupë</b>	'what can I do for you'
<b>urdhëro</b>	ask for; request
<b>kërkoj</b>	kilogram
<b>kilogram</b>	entirely; everything
<b>krejt</b>	order
<b>porosit</b>	cost
<b>kushtoj</b>	money ( <i>only has plural form</i> )
<b>të Holla</b>	

<b>paskam</b>	I have ( <i>showing surprise</i> )
<b>s'ka gjë</b>	it doesn't matter; it's nothing
<b>gjë</b>	thing
<b>më vonë</b>	later
<b>diçka</b>	something
<b>paguaj</b>	pay

*Notice:* një kilogram rrush a kilo of grapes. The nominative case follows expressions of weight.

**V/ EXERCISES**

(2) Fill in the blanks:

- (a) Sot Zana ..... blerjen pér ..... tē parë. Ajo ..... se di ..... blerjen. Nëna e ..... ta bëjë blerjen pa ..... e sigurt se do ta bëjë si .....
- (b) Zana ..... shportën, ..... pallton, ..... këpucët dhe .....
- (c) Dyqani ..... dhe ..... nuk është larg ..... së ..... Nëna e Zanës ..... pemëshitësin. Ai ..... Shpend. Shpendi është ..... shumë i mirë dhe ..... Ai ..... pothuaj tē gjithë ..... Ai she ..... dhe perime ..... Ndonjëherë shet edhe ..... tē ndryshme.
- (d) Sapo hyri në dyqan, Zana i tha pemëshitësit: '.....' Pemëshitësësi i tha Zanës: '.....'
- (e) Zana i ..... shitésit një ..... rrush, ..... kilogrami qepë dhe dy ..... mollë.
- (f) Zana ..... t'ia japë tē hollat shitésit. Nëna e Zanës ..... më vonë.

- (3) Change the person in the following sentences as in the example:

*Example:* Punova nē kopsht. (Ai)  
Punoi nē kopsht.

- 1 Bleva një libër. (Ti)
- 2 E takova Petritin. (Ne)
- 3 Shkova nē kinema. (Ata)
- 4 Më tha ta takoj këtu. (Ata)
- 5 Erdha vonë. (Ju)
- 6 Fola me Petritin. (Ne)
- 7 Hyra nē dhomë. (Ata)
- 8 Lexova një libër. (Ai)
- 9 I shkrova shokut një letër. (Ai)
- 10 Mora një letër nga prindërit. (Ne)

- (4) Put the verb in the Simple Past as in the example:

*Example:* Çdo ditë shkoj nē punë nē orën nëntë.  
(Sot . . . . nē dhjetë)  
Sot shkova nē orën dhjetë.

- 1 Çdo ditë e lexoj gazetën.  
(Sot . . . . (neg.) )
- 2 Çdo javë i vizitoj prindërit.  
(Këtë javë . . . . (neg.) )
- 3 Zakonisht ha drekë nē shtëpi.  
(Sot . . . . nē restorant)
- 4 Çdo të diel shkojnë nē peshkim.  
(Këtë të diel . . . . (neg.) )
- 5 Petriti zë shumë peshq.  
(Këtë të diel . . . . (neg.) )
- 6 Zakonisht nëna e bën blerjen.  
(Sot . . . . Zana)
- 7 Çdo mbrëmje jam nē shtëpi.  
(Dje (yesterday) . . . . (neg.) )
- 8 Çdo ditë kam shumë punë.  
(Sot . . . . (neg.) )

- 9 Çdo ditë shkoj nē punë me veturë.  
(Sot . . . . me autobus)
- 10 Çdo ditë vij nē shkollë nē orën dhjetë.  
(Sot . . . . nē orën njëmbëdhjetë)

## Unit Nine

### ■ I SITUATIONS

konstruktoj	construct, make
kompjuter	computer
sillet	behaves
si ashtu	how's that, how come
sa herë	whenever
fajësoj	blame

A: E kam konstruktuar një kompjuter që sillet pothuaj si njeri.

B: Si ashtu?

A: Sa herë bën ndonjë gabim, e fajëson kompjuterin tjetër.

heq	take off, take away
gjips	plaster, gypsum, cast
duart	hands
kurrë	never

A: Shok mjek, kur të ma hiqni gjipsin nga duart, a do të mund të luaj nē piano?

B: Sigurisht.

A: Shumë mirë. Më parë kurrë s'kam mundur të luaj nē piano.

Babai:	Çka ke mësuar sot, Luli?
Luli:	Sot mësova të shkruaj.
Babai:	O, shumë mirë. Çka shkrove?
Luli:	Nuk di. Ende nuk kam mësuar të lexoj.

kanal	channel
televizor	television set

A: Ku është Kanali Anglez?

B: Nuk di, nuk na e zë televizori.

duke + participle	indicates progressive tense
mbrapsht	upside down
po si jo	of course
lehtë	easy

A: A e di se je duke e lexuar gazetën mbrapsht?

B: E di, po si jo. Mos po mendon se është lehtë.

## II/ GRAMMATICAL PATTERNS

### The Simple Past of Non-active Verbs

The difference between the Simple Past for active and non-active verbs can be seen by studying the forms of the verb **laj** (*wash*) and **lahem** (*get washed/be washed*) given below.

laj – active	lahem – non-active
lava	lamë
lave	latë
lau	lanë

It can be noticed that the endings are the same for the non-active forms as for the active forms, except for the third person singular which has no ending. All non-active forms are preceded by the so-called non-active clitic **u**. As the meaning of the non-active covers the passive and the reflexive, the above verb **u lava** can mean *I was washed* as well as *I washed myself*. Below the third person singular of the non-active forms for a number of verbs corresponding to the groups given in the previous unit is shown:

punoi	u punua	worked / was worked
gjeti	u gjet	found / was found
bleu	u ble	bought / was bought
shkroi	u shkrua	wrote / was written
foli	u fol	spoke / was spoken
mori	u mor	took / was taken
zgjodhi	u zgjodh	chose / was chosen

Knowing the participle of the verb helps you to guess the form of the Simple Past more easily.

### The Plural of Nouns

The plural of nouns in Albanian, like in many other languages, is rather complicated. Here are some characteristic endings:

-ë	fshatar	fshatarë	villager
-nj	bari	barinj	shepherd
-enj	lumë	lumenj	river
-inj	shkop	shkopinj	stick
-llarë	baba	baballarë	father
-rë	bri	briërë	horn
-ër	prind	prindër	parent
-a	vajzë	vajza	girl
-e	kujtim	kujtime	memory
-ra	gjë	giëra	thing
-	shtëpi	shtëpi	house

Note that some masculine singular nouns take the ending -e and in this case become feminine in the plural, like **kujtim**.

The ending -a is selected by both feminine and masculine nouns. This ending does not always affect the gender of the noun.

The rest of the endings given above are all masculine.

There are nouns that form the plural by undergoing changes in their stem. Some of them form little groups which makes remembering them a little easier. Such are:

Singular	Plural	
fik	fiq	fig
mik	miq	friend
armik	armiq	enemy
zog	zogj	bird
portokall	portokaj	orange
shekull	shekuj	century
buall	buaj	waterbuffalo bull
bir	bij	son
lepur	lepuj	hare; rabbit

Some other nouns, as well as changing within the stem also take a plural ending, such as:

<i>Singular</i>	<i>Plural</i>	
rrezik	rreziqe	danger
lëng	lëngje	juice
breg	brigje	hill

Here are some irregular plurals:

<i>Singular</i>	<i>Plural</i>	
dorë	duar	hand
derë	dyer	door
grua	gra	woman
djalë	djem	boy
dash	desh	ram
thes	thasë	sack
kalë	kuaj	horse
ka	qe	ox
rreth	rrathë	circle

From now on the plural will be given with each new noun in the vocabulary and the best thing to do is to learn it as you learn each new word.

### ■ III/ READING PASSAGE

#### NË PIKNIK

Dje, të rinjtë dhe të rejet nga Anglia, bashkë me disa shokë e shoqë nga Prishtina, e kaluan një ditë në piknik. Herët në mëngjes u takuan para hotelit.

Në orën tetë u nisën për në Deçan. Deçani është një qytezë rreth pesëmbëdhjetë kilometra larg Pejës. Aty gjendet një manastir i vjetër të cilin e vizituan studentët apo arritën atje. Manastiri ndodhet në një grykë të bukur malesh. Nëpër grykë gjarpëron një lumë i vogël me ujë të pastër si loti.

Pak më lart nga manastiri, midis pishave të larta, është një motel. Aty studentët hëngrën drekë pasi që e vizituan manastirin. Pas drekës ata shëtitën nëpër malin me drunj të lartë dhe buzë lumi. Pas një shëtitjeje bukur të gjatë shumica u ndien të lodhur,

veçanërisht Nora. Pastaj të gjithë zbritën buzë lumi, gjetën një vend të përshtatshëm dhe u ulën për të pushuar. Pushuan aty disa orë duke dëgjuar muzikë, duke biseduar, duke treguar shaka. Me vete patën lëngje pemësh dhe pije të tjera. Disa prej tyre patën aparate fotografike dhe bënë shumë fotografi të bukura. Moti që i bukur, me diell. Të gjithë u kënaqën.

Rreth orës pesë pasdite u nisën për në Prishtinë. Në Prishtinë arritën rreth orës shtatë.

#### Vocabulary

piknik, -ë	picnic
të rinjtë	the young ( <i>masc. pl.</i> )
të rejet	the young ( <i>fem. pl.</i> )
kaloj	pass, spend ( <i>time</i> )
nis	start
për në	for, to
qytezë, -a	little town
rreth	around
kilometër, -ra	kilometer
aty	there
gjendem	(am) situated
ndodhem	happen (to be)
grykë, -a	gorge
mal, -e	forest ( <i>fem. in pl.</i> )
nëpër	through, about
gjarpëroj	snake ( <i>verb</i> )
lumë, -enj	river
ujë, -ra	water
i/e pastër	clean, clear
lot, -	tear
pak më lart	a little higher up
midis	among
pishë, -a	pine tree
lartë	high, tall
pas	after
dru, druri, drunj	tree
buzë lumi	by the river
shëtitje, -	(a) walk
gjatë	long
shumica	most (of them)

ndihem	feel
veçanërisht	especially
zbres	get down, descend
i përshtatshëm	suitable ( <i>masc.</i> )
e përshtatshme	suitable ( <i>fem.</i> )
duke dëgjuar	listening
duke treguar	telling
shaka, -ja, -	joke
lëng pemësh	fruit juice
pije, -	drink
aparate fotografike	cameras
me diell	sunny
kënaqem	enjoy
pasdite	afternoon

**IV/ EXERCISES**

(1) Answer the following questions on the reading passage:

- 1 Çka bënë dje të rintjtë dhe të rejat nga Anglia?
- 2 Me kë shkuan në piknik?
- 3 Ku shkuan në piknik?
- 4 Ku është Deçani?
- 5 Çka ka në Deçan?
- 6 Çka bënë studentët pasi që e vizituan manastirin?
- 7 Po pasi që hëngrën drekë?
- 8 A u ndien të lodhur pas shëtitës?
- 9 Kush që veçanërisht e lodhur?
- 10 Ku shkuan pastaj?
- 11 Çka bënë aty?
- 12 Kur u nisën për në Prishtinë?
- 13 Kur arritën në Prishtinë?

(2) Put the object noun in the plural:

*Example:* E dua shokun.  
I dua shokët.

1 E pashë një student.

- 2 E takova shoqen.
- 3 Bleva një libër.
- 4 Mora një letër.
- 5 Hëngra një mollë.
- 6 Bleva një gazetë.
- 7 Vizitova një fshat.
- 8 E kuptova mësimin (*lesson*).
- 9 Bisedova me një djalë.

(3) Change the following sentences using the dative case instead of the accusative:

*Example:* Po flas me shokun.  
Po i flas shokut.

- 1 Po flas me Norën.
- 2 Po flas me ty.
- 3 Po flas me disa shokë.
- 4 Po flas me ty e me Denisin.
- 5 Po flas me motrat.
- 6 Po flas me vëllanë.
- 7 Po flas me nënën.
- 8 Po flas me Merin shqip.
- 9 Drita po flet me Norën anglisht.
- 10 Nora po flet me Dritën shqip.

(4) Put the noun in brackets in the right case:

*Example:* Pushojmë buzë (lumë).  
Pushojmë buzë lumit.

- 1 Po shkojmë te (Petrit).
- 2 Erdha nga (Prizren).
- 3 Nora është nga (Londër).
- 4 Ky libër është (Zanë).
- 5 Ia dhashë gazetën (Riçard).
- 6 U nisën për në (Deçan).
- 7 E mora librin prej një (shok).
- 8 U shkrova një letër (prindër).
- 9 I telefonova (motër).
- 10 E mora një kartolinë prej një (studente).

(5) Make sentences following the pattern in the example:

*Example:* Bardhi – kafe, çaj

Bardhi e do kafenë, por më shumë i pëlqen çaji.

1 Ata – skijim (*skiing*), not (*swimming*)

2 Unë – futboll, basketball

3 Beti – qytet, fshat

4 Ai – shi (*rain*), dëborë (*snow*)

5 Marku – film, teatër

6 Riqardi – punë, pushim

7 Petriti – televizion, radio

8 Meri – Londër, Oksford

9 Ti – pemë (*pl.*), perime

10 Ajo – mollë (*pl.*), portokaj

## Unit Ten

### ■ I/ SITUATIONS AND PROVERBS

koprrac, -ë	miser ( <i>man</i> )
nga një gotë	a glass each
tavolinë	table
pranë	beside; by
sharmante	charming ( <i>fem.</i> )
liker	liqueur
thërras	invite, call
edhe pak	a little while
mu	just
kam ndërmend	intend, have in mind

Dy koprrracë po e pinin nga një gotë në një kafene. Në tavolinën pranë tyre dy shoqe sharmante po pinin kafe e liker.

– A t'i thërrasim në tavolinën tonë? – pyeti njëri.

– Më mirë të presim edhe pak – tha tjetri. Mu tash e kanë ndërmend të paguajnë.

përgjigjem	answer
thirrje	call
ishte	was
bukuroshe, -	beauty ( <i>fem.</i> )
përtej	across, over
deshë	<i>imperf.</i> of want
gjithçka	everything
fik	put out

Derisa burri po shikonte në dritare, gruaja iu përgjigj thirrjes në telefon.

– Kush ishte – pyeti burri.

– Bukuroshja e shtëpisë përtej rrugës.

– Ç'deshi në këtë kohë?

– Pyeti a shikove gjithçka dhe a mund ta fikë dritën tash.

hap	open
pus, -e	well ( <i>fem. in pl.</i> )
(i) ri	new
pështyj	spit
i vjetri	the old one ( <i>masc.</i> )

Nëse hap pus të ri, mos pështyj në të vjetrin.

(If you dig a new well, don't spit in the old one.)

### II/ GRAMMATICAL PATTERNS

#### *The Imperfect*

This tense corresponds to the English ‘used to’ construction and also to the Past Continuous Tense (‘I was doing’ etc.) Its characteristic endings are:

-ja	-nim
-je	-nit
-te/-nte/-ste	-nin

For example: punoja      punonim  
                   punoje      punonit  
                   punonte     punonin

Only the Imperfect of **jam**, **kam** and **them** differs a little from the rest of the verbs. Notice this difference:

jam	kam	them
isha ishim	kisha kishim	thosha thoshim
ishe ishit	kishe kishit	thoshe thoshit
ishte ishin	kishte kishin	thoshte thoshin

Notice that for those verbs that undergo a change in the second person plural of the Present Tense, this change is kept in the Imperfect for all persons, singular and plural. For example:

	Present	Imperfect	
	2nd pers. pl.	1st pers. sing.	
heq:	hiqni	hiqja	take off, remove
blej:	blini	blija	buy
pjek:	piqni	piqja	bake
vras:	vritni	vritja	shoot
zë:	zini	zija	catch
bie:	bini	bija	bring, fall
dua:	doni	doja	want
djeg:	digjni	digija	burn

Here are the endings for the Imperfect of non-active verbs:

-(h)esha	-(h)eshim
-(h)eshe	-(h)eshit
-(h)ej	-(h)eshin

Compare the verb **laj** (*wash*) in active and non-active forms:

laja	lanim	lahesha	laheshim
laje	lanit	laheshe	laheshit
lante	lanin	lahej	laheshin

The main use of this tense is to express the development of an action in the past without referring to its beginning or termination. To express the continuity of an action at a certain time in the past it can be used preceded by the particle **po**, e.g.:

po punoja	I was working
po lahesha	I was washing myself/being washed

It can also express an action which was either usual or repeated in the past, e.g.:

**Atëherë shkoja shpesh në teatër.** I often used to go to the theatre then.

**Atëherë lahesha shpesh në lumë.** I often used to wash (myself) in the river then.

It is also used in indirect (reported) speech mainly to agree in tense with the main verb, e.g.:

**Nora tha se nuk donte të shkonte në peshkim.** Nora said that she did not want to go fishing.

**Nora tha se donte të lahej.** Nora said she wanted to wash.

### *The Imperfect Subjunctive*

Notice that the Imperfect Subjunctive is formed just by putting **të** in front of the forms of the Imperfect, e.g.

punoj	nisem
të punoja	të punonim
të punoje	të punonit
të punonte	të punonin

të nisesh	të niseshim
të niseshe	të niseshit
të nisej	të niseshin

The Imperfect Subjunctive is often used to agree in tense either with the Simple Past or the Imperfect of the main verb in the sentence, e.g.:

**Filloi të punonte në kopsht.** He/she started to work (working) in the garden.

**Filloi të zhdukej në errësirë.** He/she/it started to disappear (or disappearing) in the darkness.

### ■ III/ READING PASSAGE

#### NËNA E BRENGOSUR

Një mbrëmje, Vjollca u brengos shumë për birin e saj, Shkumbinin. Shkumbini rrallëherë del në mbrëmje. Pothuaj kurrë nuk shkon në kafene me shokë. Nuk pi alkohol, nuk pi cigare, është i përpiktë në çdo punë.

Vjollca kishte arsyet të brengosej. Kur u bë bukur vonë, ajo filloi t'u telefononte shokëve të Shkumbinit. Të gjithë shokët e Shkumbinit i thanë se nuk dinin gjë për të. 'Diçka nuk është në

rregull,' mendoi ajo. 'Do ta qortoj kur tē vijë nē shtëpi,' tha me vete.

Ora ishte gati dymbëdhjetë kur cingëroi zilja e derës. Vjollca e hapi derën. Ishte Shkumbini. Në fytyrë i vërehej një ndjenjë faj. Kundërmonte alkohol.

'Mos je i dehur, Shkumbini?' e pyeti Vjollca.

'Jo, nuk jam i dehur fare,' u përgigji ai.

'Po tē vjen era alkohol,' i tha e ēma.

'E piva vetëm një gotë me një shok,' shtoi Shkumbini.

'Me cilin shok ishe? U telefonova tē gjithë shokëve tē tu. Ulu dhe më trego ku ke qenë,' i tha ajo.

'Në tē vërtetë isha me një shoqe,' tha Shkumbini turpshëm.

'S'ka asgjë tē keqe në këtë, biri i nënës, por ti kurrë nuk shkon në kafene.'

'E di, nënë, është dashur tē tē lajmëroj se do tē vonohem,' tha Shkumbini pa pritur ta mbaroje fjalën e ēma.

'A s'do tē më tregosh cila është ajo shoqe?' e pyeti e ēma.

'Do tē tē tregoj, nënë, por jo tash. Ende është herët. Çdo gjë me kohë,' tha Shkumbini.

'Ani, biri im. Ti e di më së miri. Kur ta merr mendja se është koha, mund ta sjellësh në drekë. Do t'ju bëj një drekë tē mirë,' i tha e ēma.

'Falemnderit, nënë,' i tha Shkumbini nënës së tij tē zhbrengosur.

#### Vocabulary

i/e brengosur	worried
brengosem	(am) worried
bir, bij	son
rrallëherë	rarely
dal	go out
alkohol	alcohol
pi cigare	smoke
i/e përpiktë	punctual
arsye, -	reason
u bë vonë	it became late
filloj	begin
në rregull	alright
qortoj	scold
me vete	to oneself

cingëroj	ring
zile, -	bell
fytyrë, -a	face
vërehem	(am) noticed
ndjenjë, -a	feeling
faj, -e	guilt ( <i>fem. in pl.</i> )
kundërmoj	smell
pyes	ask
fare	at all
erë, -ra	scent, smell; wind
tē vjen era	you smell (of)
e ēma	his/her mother
shtoj	add
në tē vërtetë	actually
turpshëm	shyly
s'ka asgjë tē keqe	there's nothing wrong
është dashur tē . . .	I should have . . .
lajmëroj	inform, let know
vonohem	(am) late
pa pritur	without waiting
mbaroј	finish
mbaroј fjalën	<i>lit.</i> finish the word
çdo gjë me kohë	everything at its own time
më së miri	best
mendje, -	mind
ma merr mendja	I think
sjell	bring
i/e zhbrengosur	soothed

#### IV/ EXERCISES

(1) Answer the following questions on the reading passage:

- 1 Për kë u brengos Vjollca një mbrëmje?
- 2 A del Shkumbini shpesh?
- 3 A shkon ai shpesh në kafene me shokë?
- 4 Çfarë është Shkumbini?
- 5 Ç'bëri Vjollca kur u bë vonë?
- 6 Ç'i thanë shokët e Shkumbinit?

- 7 Ç'tha ajo me vete?  
 8 Sa ishte ora kur erdhi Shkumbini në shtëpi?  
 9 Ç'i vërehej në fytyrë Shkumbinit?  
 10 Me kë ishte Shkumbini në kafene?

(2) Put the following sentences into indirect speech:

- Example:* Mos je i dehur?  
 Vjollca e pyeti Shkumbinin .....  
 Vjollca e pyeti Shkumbinin mos ishte i dehur.

- 1 Nuk jam i dehur fare.  
 Shkumbin i tha Vjollcës se .....  
 2 Me cilin shok ishe?  
 Vjollca e pyeti Shkumbinin .....  
 3 Ulu dhe më trego ku ke qenë.  
 Vjollca i tha Shkumbinit të ulej dhe .....  
 .....  
 4 Në të vërtetë isha me një shoqe.  
 Shkumbini i tha Vjollcës se .....  
 5 Ti kurrë nuk shkon në kafene.  
 Vjollca i tha Shkumbinit se .....

(3) Put the following sentences into indirect speech:

- Example:* Po e lexoj një libër.  
 Tha se po e lexonte një libër.

- 1 Po mësoj shqip.  
 2 Po u shkruaj prindërve.  
 3 Po punoj në kopsht.  
 4 Qeni po luan me macen.  
 5 Po e shikoj një film në televizion.  
 6 Po blej ca pemë e perime.  
 7 Po pi kafe me Petritin.  
 8 Nora e Drita po hanë drekë.  
 9 Riçardi e Denisi po pushojnë.  
 10 Drita po bisedon me disa turistë.

(4) Complete the following sentences with the imperfect subjunctive:

*Example:* Filloi / shkruaj një letër  
 Filloi të shkruante një letër.

- 1 Desha / blej një libër  
 2 Shkuan / luaj futboll  
 3 U ulëm / pushoj nën hije (*in the shade*)  
 4 Doli / blej gazetën  
 5 Erdhën / bisedoj me ne  
 6 U ulën / ha darkë  
 7 Filluan / analizoj (*analyze*) filmin  
 8 Deshën / shpëtoj (*rescue*) shokun  
 9 Erdhën / rri me mua  
 10 Më thanë / marr ombrellën (*umbrella*) me vete

(5) Translate the following sentences into Albanian:

- 1 When the bell rang I was dressing (*vishem*).  
 2 When the phone rang he was shaving (*rruhem*).  
 3 When Drita came Nora was washing.  
 4 When mother came Drita was combing her hair (*krihem*).  
 5 When Mary came Betty was resting (*çlodhem*).  
 6 When we went out it was raining (*bie shi*).  
 7 When Liz came back Nora was sleeping (*fle*).  
 8 When Nora woke up (*zgjohem*) Liz was reading.

(6) Translate into Albanian:

Mark had to wash and get dressed quickly this morning. He had to go to Brighton today to visit a friend. When he got outside he saw that it was raining. He went back and took his umbrella. He then ran (*vrapoј*) to catch the train. When he arrived the train was still waiting. He didn't have time to buy his ticket but he knew that he could buy it on the train. When he arrived at Brighton, his friend was waiting for him

at the station. They had a lot to tell each other (*njëri-tjetrin*) because the last (*fundit*) time they met was last (*kaluar*) June. Mark told his friend about his visit to Kosovo. They spent all day together. Mark returned home by train. When he arrived home around ten thirty it was still raining.

(7) Translate into English:

(From now on, translations into English will not be given in the Key.)

Dje, Petriti e Marku shkuan e i morën fotografitë që i bënë në Deçan. Kur u kthyen te hoteli, i gjetën shokët dhe shoqet e tyre ulur përjashta. Ata po pinin kafe dhe po bisedonin. Marku e Petriti u ulën me ta. Marku i nxori fotografitë nga çanta dhe filluan t'i shikonin. Kishte shumë fotografi. Të gjitha ishin të bukura. Fotografitë kalonin nga dora në dorë. Në një fotografi shiheshin disa prej tyre duke pushuar pranë lumit. Në një tjeter Meri e Beti po freskoheshin në lumë. Në shumë prej tyre shihej mali me pisha të larta.

‘Shikoni sa bukur ka dalë Nora këtu!’ tha njëri.

‘Nuk po shihet se është e lodhur fare,’ tha tjetri.

‘Shikojeni këtë,’ tha një tjeter. ‘A nuk po shihet këtu se Riçardi ka uri (*hunger*)?’

Të gjithë qeshën (*laugh*). Ata vazhduan (*continue*) t'i shikonin fotografitë, të talleshin (*joke*) e të qeshnin deri sa erdhi koha të shkonin në darkë.

## Unit Eleven

### ■ IV SITUATIONS

kamarier, -ë	waiter
çfarë	how; what like
i mesëm/e mesme	medium
mineral-e	mineral

A: Kamarier!

B: Urdhëroni.

A: Na sjell dy kafe, të lutem.

B: Çfarë i doni kafetë?

A: Një pa sheqer dhe një të mesme.

B: A dëshironi ujë mineral?

A: Po, na sjell edhe dy gota ujë mineral.

i/e fortë	strong
jam mësuar me	I am used to
mbetem	remain ( <i>non-act.</i> )
gjumë	sleep

A: A të pëlqen kafja turke?

B: Po, më pëlqen shumë, por është pak e fortë.

A: Ashtu është, por unë jam mësuar me të.

B: Nëse pi kafe turke në mbrëmje, mbetem pa gjumë.

listë, -a	list
gjellë, -	dish
lista e gjellëve	the menu

A: Urdhëroni?

B: Dëshirojmë të hamë drekë.

A: Ja lista e gjellëve.

B: Falemnderit.

birrë, -a	beer
i/e fërguar	fried

mish	meat
i/e përzier	mixed
skarë, -a	grill
sallatë, -a	salad
tarator, -ë	yoghourt dish
shishe, -	bottle
verë, -ra	wine
i kuq, e kuqe	red

A: A jeni gati të porositni?

B: Po, na sillni dy birra së pari. Pastaj një peshk të fërguar përmua dhe mish të përzier nga skara për shokun.

A: A dëshironi sallatë?

B: Po. Një sallatë të përzier dhe një tarator.

A: Dëshironi diçka nga pijet?

B: Një shishe verë të kuqe, ju lutem.

postë, -a	post office
drejt	straight
kthej	turn
në të majtë	on the left
metër, -a	metre
nja	about
në të djathëtë	on the right
cilido	whichever ( <i>masc.</i> )
qoshk, -qe	kiosk ( <i>fem.</i> <i>in pl.</i> )

A: Më falni, ju lutem.

B: Urdhëroni.

A: A dini të më tregoni ku është posta?

B: Shkon drejt, pastaj ktheni në rrugën e parë në të majtë. Ecni një pesëdhjetë metra dhe do të jeni te posta. Posta është në të djathëtë.

A: Ju falemnderit.

B: Me nder qofshi.

A: . . . Uh, gati harrova. . . .

B: Urdhëroni, urdhëroni.

A: Ku mund të blej pulla postale?

B: Mund të blini në postë, por edhe në cilido qoshk.

A: Falemnderit shumë dhe më falni që ju mora kohë.

B: S'ka gjë.

## II/ GRAMMATICAL PATTERNS

### Agreement of Adjectives

You have come across a lot of adjectives by now and may have noticed that many of them are preceded by the so-called adjective clitics which in form are the same as the genitive clitics. Adjectives usually follow the noun they modify and have to agree with it in number, gender and case. Sometimes it is possible to use adjectives before the noun they modify but this is mainly done for stylistic purposes. When they precede the noun they behave a bit differently.

Let us now see how adjectives behave when they modify a noun in different cases both in singular and plural:

#### Masculine Singular

	Indefinite	Definite
Nom.	një djalië i mirë	djali i mirë
Acc.	një djalië të mirë	djalin e mirë
Gen.	i/e një djali të mirë	i/e djalit të mirë
Dat.	një djali të mirë	djalit të mirë
Abl.	(prej) një djali të mirë	(prej) djalit të mirë

#### Feminine Singular

	Indefinite	Definite
Nom.	një vajzë e mirë	vajza e mirë
Acc.	një vajzë të mirë	vajzën e mirë
Gen.	i/e një vajze të mirë	i/e vajzës së mirë
Dat.	një vajze të mirë	vajzës së mirë
Abl.	(prej) një vajze të mirë	(prej) vajzës së mirë

#### Masculine Plural

	Indefinite	Definite
Nom.	ca djem të mirë	djemtë e mirë
Acc.	ca djem të mirë	djemtë e mirë
Gen.	i/e ca djemve të mirë	i/e djemve të mirë
Dat.	ca djemve të mirë	djemve të mirë
Abl.	(prej) ca djemësh të mirë	(prej) djemve të mirë

*Feminine Plural*

<i>Indefinite</i>	<i>Definite</i>
-------------------	-----------------

<i>Nom.</i>	ca vajza <b>të mira</b>	vajzat <b>e mira</b>
<i>Acc.</i>	ca vajza <b>të mira</b>	vajzat <b>e mira</b>
<i>Gen.</i>	i/e ca vajzave <b>të mira</b>	i/e vajzave <b>të mira</b>
<i>Dat.</i>	ca vajzave <b>të mira</b>	vajzave <b>të mira</b>
<i>Abl.</i>	(prej) ca vajzash <b>të mira</b>	(prej) vajzave <b>të mira</b>

As can be seen from the above examples, only the clitic undergoes changes with singular nouns and masculine plural nouns.

Some feminine adjectives have a feminine ending as well as being marked by the feminine clitic **e**, and some drop the vowel **ë** in the feminine form, e.g.

i sjellshëm	<b>e sjellshme</b>
i sotëm	<b>e sotme</b>
i mesëm	<b>e mesme</b>

A number of adjectives do not take clitics at all. Some are given in the list below (-e is the feminine ending):

trim-e	brave
dinak-e	cunning
gojëmjaltë	honey-mouthed
zemërkeq-e	bad-hearted
zemërmadh-e	big-hearted

Adjectives that have no clitics do not change at all for the different cases.

Most masculine adjectives form the plural by changing the clitic **i** into **të** (in the Nominative, indefinite form), with the exception of a small number of adjectives, such as:

i keq	<b>të këqij</b>	bad
i lig	<b>të ligj</b>	weak
i madh	<b>të mëdhenj</b>	big
i vogël	<b>të vegjël</b>	small

i zi	<b>të zinj</b>	black
i ri	<b>të rinj</b>	young, new

Masculine adjectives that take no clitics form the plural in the following ways:

- (a) by taking the plural ending **-ë**, e.g.:

abstrakt	<b>abstrakte</b>
absurd	<b>absurdë</b>
kimik	<b>kimikë</b>

- (b) by taking no plural ending, e.g.:

krijues	creative
veprues	acting
pyetës	interrogative

- (c) if the adjective is a 'converted' noun (i.e. a noun used as an adjective), or if the second element of a complex adjective is a masculine noun, then the plural form of the noun is used, e.g.:

djem trima	brave boys
kokëkunguj	squash-headed

However, if the second element is a feminine or an uncountable noun, then the adjective takes no plural ending, e.g.:

hundëshkabë	hook-nosed
kokëmish	blockhead; stupid

Feminine adjectives form the plural in the following ways (in the Nominative, indefinite form):

- (a) by changing the clitic **e** into **të** and taking no plural ending, e.g.:

<b>e sotme</b>	<b>të sotme</b>	today's
<b>e sjellshme</b>	<b>të sjellshme</b>	polite

- (b) by taking a plural ending as well, e.g.:

<b>e afërt</b>	<b>të afërtë</b>	close
<b>e mirë</b>	<b>të mira</b>	good
<b>e zezë</b>	<b>të zeza</b>	black

- (c) irregularly, e.g.:

<b>e keqe</b>	<b>të këqia</b>	bad
<b>e madhe</b>	<b>të mëdha</b>	big

Feminine adjectives that have no clitics form their plural in the following ways:

(a) by taking no plural ending at all, e.g.:

dinake	cunning
trime	brave
sygacë	flashing-eyed

(b) by taking the ending **-a**. This sometimes involves a change of stem, e.g.:

plakë	plaka	old
gojëmadhe	gojëmëdha	big-mouthed
fatkeqe	fatkëqia	unfortunate

When the adjective precedes the noun, which can be done for stylistic purposes, it takes the endings which are usually added to the noun, and the noun remains unchanged:

	Masculine	Feminine
Nom.	i miri djalë	e mira vajzë
Acc.	të mirin djalë	të mirën vajzë
Gen.	(i/e) të mirit djalë	(i/e) së mirës vajzë
Dat.	të mirit djalë	së mirës vajzë
Abl.	(prej) të mirit djalë	(prej) së mirës vajzë

The same happens in the plural.

It is always possible to have more than one adjective modifying the same noun. When the noun is in the indefinite form, then the second adjective has the same form as the first. However, there are some changes when the noun is in the definite form. Study these changes in the tables below:

	Masculine Singular Definite
Nom.	djali i mirë dhe i sjellshëm
Acc.	djalin e mirë dhe të sjellshëm
Gen.	i/e djalit të mirë dhe të sjellshëm
Dat.	djalit të mirë dhe të sjellshëm
Abl.	(prej) djalit të mirë dhe të sjellshëm

	Masculine Plural Definite
Nom.	djemtë e mirë dhe të sjellshëm
Acc.	djemtë e mirë dhe të sjellshëm

- Gen. i/e djemve të mirë dhe të sjellshëm  
 Dat. djemve të mirë dhe të sjellshëm  
 Abl. (prej) djemve të mirë dhe të sjellshëm

- Feminine Singular Definite*  
 Nom. vajza e mirë dhe e sjellshme  
 Acc. vajzën e mirë dhe të sjellshme  
 Gen. i/e vajzës së mirë dhe të sjellshme  
 Dat. vajzës së mirë dhe të sjellshme  
 Abl. (prej) vajzës së mirë dhe të sjellshme

- Feminine Plural Definite*  
 Nom. vajzat e mira dhe të sjellshme  
 Acc. vajzat e mira dhe të sjellshme  
 Gen. i/e vajzave të mira dhe të sjellshme  
 Dat. vajzave të mira dhe të sjellshme  
 Abl. (prej) vajzave të mira dhe të sjellshme

### Colours

The colours (**ngjyrat**) may be used as adjectives or as adverbs in Albanian.

As adjectives, the masculine and feminine forms are as below:

i bardhë,	e bardhë	white
i zi,	e zezë	black
i kuq,	e kuqe	red
i kaltër,	e kaltër	blue
i gjelbër,	e gjelbër	green
i verdhë,	e verdhë	yellow

The corresponding adverbial forms are:

bardh
zi
kuq
kaltër
gjelbër
verdh

An example of adverbial use is:

E ngjyrosi murin bardh. He painted the wall white.

**III/ READING PASSAGE****NË RESTORANT**

Sot të rindjtë anglezë janë ftuar për drekë nga disa shokë shqiptarë. Ata do të hanë drekë në restorantin »Rugova«. Ky restoran ka një dekor karakteristik. Muret e restorantit janë të mbuluara me punime të ndryshme dore të artizanatit – me vegla muzikore folklorike, me pjesë të veshjes kombëtare e të tjera. Shpesh edhe kamarierët janë të veshur me veshje kombëtare.

Në këtë restoran, pos gjellëve të zakonshme, përgatiten edhe gjellë karakteristike shqiptare. Petriti me shokë me qëllim e zgjodhën pikërisht këtë restoran.

Dreka do të jetë në orën dy, pasi që të kthehen nga vizita në Shpellën e Gadimës. Shpella e Gadimës nuk është larg nga Prishtina. Kjo është një shpellë që u zbulua rastësisht nga një fshatar para dhjetë-pesëmbëdhjetë vjetësh. Shpella është e mermertë dhe shumë shkencëtarë mendojnë se është e vetmja e këtij tipi në botë. Brenda në shpellë mund të shihet edhe një fenomen ende i pashpjegueshëm. Fjala është për degëzimin e disa stalaktiteve në kundërshtim me ligjet e fizikës. Petriti është i bindur se shpella do t'u duket shumë interesante shokëve e shoqeve nga Anglia.

**Vocabulary**

<b>ftoj</b>	invite
<b>dekor, -e</b>	decor ( <i>fem. in pl.</i> )
<b>karakteristik-e</b>	characteristic
<b>mur, -e</b>	wall ( <i>fem. in pl.</i> )
<b>mbuloj</b>	cover
<b>i/e mbuluar</b>	covered
<b>punim, -e</b>	work ( <i>fem. in pl.</i> )
<b>i ndryshëm</b>	different ( <i>masc.</i> )
<b>e ndryshme</b>	different ( <i>fem.</i> )
<b>artizanat, -e</b>	craftsmanship ( <i>fem. in pl.</i> )
<b>vegël, -a</b>	tool, instrument
<b>muzikor-e</b>	musical
<b>folklorik-e</b>	folk
<b>pjesë, -</b>	part
<b>pos</b>	except
<b>i zakonshëm</b>	usual ( <i>masc.</i> )
<b>e zakonshme</b>	usual ( <i>fem.</i> )

<b>përgatiten</b>	are prepared
<b>me qëllim</b>	on purpose
<b>pikërisht</b>	exactly
<b>rezervoj</b>	reserve
<b>shpellë, -a</b>	cave
<b>zbuloj</b>	discover
<b>rastësisht</b>	by accident
<b>fshatar, -ë</b>	villager
<b>i/e mermertë</b>	of marble
<b>shkencëtar, -ë</b>	scientist
<b>e vetmja</b>	the only one ( <i>fem.</i> )
<b>tip, -a</b>	type
<b>botë, -ra</b>	world
<b>fenomen, -e</b>	phenomenon ( <i>fem. in pl.</i> )
<b>i pashpjegueshëm</b>	inexplicable ( <i>masc.</i> )
<b>e pashpjegueshme</b>	inexplicable ( <i>fem.</i> )
<b>degëzim, -e</b>	branching ( <i>fem. in pl.</i> )
<b>stalaktit, -e</b>	stalactite ( <i>fem. in pl.</i> )
<b>në kundërshtim me</b>	opposing, in opposition to
<b>ligj, -e</b>	law
<b>fizikë</b>	physics
<b>bindur</b>	convinced
<b>dukem</b>	seem

**IV/ EXERCISES**

(1) Answer the following questions on the reading passage:

- 1 Nga kush janë ftuar për drekë sot të rindjtë anglezë?
- 2 Në cilin restoran do të hanë drekë?
- 3 Me çka janë të mbuluara muret e këtij restoranti?
- 4 Çka përgatitet në këtë restoran pos gjellëve të zakonshme?
- 5 Në orën sa do të jetë dreka?
- 6 Çka do të vizitojnë studentët?
- 7 Si u zbulua Shpella e Gadimës?
- 8 Çka mendojnë disa shkencëtarë për të?
- 9 Ç'fenomen i pashpjegueshëm mund të shihet në shpellë?
- 10 A është i bindur Petriti se shpella do t'u duket interesante studentëve anglezë?

- (2) Complete the following sentences with the appropriate form of the adjective **i/e/të/së mirë-a**:

*Example:* Kam një shtëpi .....  
Kam një shtëpi të mirë.

- 1 Ky është vend .....
- 2 Ata janë studentë .....
- 3 Ato janë nxënëset .....
- 4 Kjo shtëpi ka disa dhoma .....
- 5 Ajo ishte një dramë (*drama*) .....
- 6 Ky është libri i vajzës .....
- 7 Këtë letër e mora prej ca shokësh .....
- 8 E pashë djalin .....
- 9 Ua dhashë vajzave .....
- 10 Ai është libri i nxënësit .....
- 11 Bisedova me mësuesin .....
- 12 E mësova prej mësuesit .....
- 13 Vizituan vende .....
- 14 Pushuan në kopshte .....

- (3) Make the following sentences plural:

*Example:* Kjo është vajzë e sjellshme.  
Këto janë vajza të sjellshme.

- 1 Bisedova me një djale të mirë.
- 2 Kjo është një pishë e lartë.
- 3 Kjo dhomë është e vogël.
- 4 Lapsi i vogël është mbi (*on*) tryezë.
- 5 Kjo derë është e madhe.
- 6 Ky libër është i keq.
- 7 Ky djale është i ri.
- 8 Ajo vajzë është e re.
- 9 Ky mal është i bukur.
- 10 Ai njeri është zemërkeq.
- 11 Plani i sotëm është i mirë.
- 12 Ky peshk është i madh.
- 13 Ky qytet është i vjetër.
- 14 Kjo mollë është e freskët.

- (4) Put the following sentences into the plural:

*Example:* Ky libër është i mirë.  
Këta libra janë të mirë.

- 1 Kjo ndërtesë (*building*) është e madhe.
- 2 Ky djale është i vogël.
- 3 Ky vend është i bukur.
- 4 Ky lumë është i gjatë.
- 5 Ky mal është i lartë.
- 6 Kjo pishë është e lartë
- 7 Ky qytet është i vjetër.
- 8 Kjo angleze është e lodhur.
- 9 Ky plak (*old man*) është i mençur.
- 10 Ky kalë është i shpejtë (*fast*).

- (5) Change the following sentences as in the example:

*Example:* Vajza e vogël ka një mace të zezë.  
Macja e vajzës së vogël është e zezë.

- 1 Lumi i vogël ka ujë të pastër.
- 2 Kopshti i madh ka lule të bukura.
- 3 Nxënësja e mirë ka një dhomë të vogël.
- 4 Shtëpia e bardhë ka kopsht të madh.
- 5 Restoranti i mirë nuk ka gjellë të këqia.
- 6 Njeriu i sjellshëm ka fjalë të mira.
- 7 Rruga kryesore ka drunj të mëdhenj.
- 8 Dimri i gjatë ka ditë të ftohta.
- 9 Vajzat e bukura kanë fat të keq.
- 10 Shpella interesante ka një fenomen të paspjegueshëm.

- (6) Change the following sentences as in the example:

*Example:* Banesa ime është e vogël.  
Unë kam një banesë të vogël.

- 1 Shoqja ime është e bukur.
- 2 Shoku im është i sjellshëm dhe i mirë.
- 3 Pishat e Deçanit janë të bukura dhe të larta.
- 4 Qeni i Markut është i madh dhe i mençur.

- 5 Uji i lumenjve është i ftohtë.
- 6 Dritarja e dhomës sime (*my*) është e madhe.
- 7 Ajri (*air*) i bjeshkës është i pastër.
- 8 Valixhja e Norës është bukur e rëndë.
- 9 Shoku i Denisit është i përpiktë.
- 10 Shtëpia e tyre është e madhe.
- 11 Birra në këtë restorant është e ftohtë.
- 12 Lulet e kopshtit të Betit janë të kuqe.

## Unit Twelve

### ■ I/ SITUATIONS

<b>orë dore</b>	wrist watch
<b>ndal</b>	stop
<b>kohë pas kohe</b>	from time to time ( <i>lit. time after time</i> )
<b>nevojë, -a</b>	need, necessity
<b>pastroj</b>	clean
<b>dëftesë, -a</b>	receipt
<b>qenka</b>	<i>Adm. of jam</i> (is + surprise)
<b>që sa vjet</b>	for how many years
<b>kujtim, -e</b>	keepsake, souvenir
<b>javën e ardhshme</b>	next week

- A: Mirëdita.  
B: Mirëdita. Urdhëroni.  
A: A mund ta shikoni këtë orë dore. Po më ndalet kohë pas kohe.  
B: Sigurisht. . . . Ka nevojë të pastrohet.  
A: Sa do të kushtojë?  
B: 1500 dinarë.  
A: A më duhet dëftesë?  
B: Gjithsesi. Qenka orë e mirë. Që sa vjet e keni?

- A: E kam që dhjetë vjet. E kam kujtim nga gjyshi. Kur mund të vij ta marr?

- B: Javën e ardhshme, të martën.  
A: Shumë mirë. Ditën e mirë!  
B: Ditën e mirë!

<b>orëndreqës, -</b>	watchmaker
<b>mos ka ndodhur</b>	has anything happened
gjë	
<b>paska</b>	<i>Adm. of kam</i> (has + surprise)
<b>aksident, -e</b>	accident ( <i>fem. in pl.</i> )
<b>dje</b>	yesterday
<b>ashtu?</b>	is it so?
<b>lëndoij</b>	injure, hurt
<b>megjithatë</b>	nevertheless
<b>thashë</b>	I thought maybe . . . ( <i>lit. I said maybe</i> )
<b>menjëherë</b>	immediately

- A: Mirëdita, Agron.  
B: Mirëdita, Blerim.  
A: Ku ishe?  
B: E lashë orën te orëndreqësi.  
A: Të kërkova në shtëpi.  
B: Mos ka ndodhur gjë?  
A: Agimi qenka në spital.  
B: Çka paska?  
A: Paska pasur një aksident të vogël dje.  
B: Ashtu! A është lënduar shumë?  
A: Jo shumë, por megjithatë duhet të rrrijë në spital disa ditë. Thashë ndoshta dëshiron të shkojmë e ta vizitojmë bashkë.  
B: Ani, po shkojmë menjëherë.

- |                      |               |
|----------------------|---------------|
| <b>mbrëmë</b>        | last night    |
| <b>regjistër, -a</b> | register      |
| <b>motër, -a</b>     | nurse, sister |
- A: Mirëdita, djem. Urdhëroni.  
B: E kemi një shok këtu në spital, por nuk dimë në ç'dhomë është.  
A: Si quhet?  
B: Agim Shpati.

- A: Kur ka ardhur në spital?  
 B: Mbrëmë.  
 A: Vetëm një moment të shikoj në regjistër. . . Agimi është në dhomën 304.  
 B: A mund ta shohim?  
 A: Po, tash është koha e vizitave.  
 B: Ju falemnderit, motër.  
 A: Me nder qofshi.

më mirë	better
shpëtoj	save; escape; rescue
ngas veturën	drive
ma lëshoi njëra	one of my tyres went flat
gomë	
lëshoj	let go/loose/off, release
gomë, -a	lit. rubber, tyre
përplas	hit, strike, slam
bri rrugës	by the road
dëmtoj	damage
qoftë e kaluar	may it belong to the past

- A: Si po ndihesh, Agim?  
 B: Më mirë, falemnderit.  
 C: Mirë paske shpëtuar.  
 A: Po, po, mirë. Ka mundur të ndodhë më keq.  
 B: Mos ishe i dehur?  
 A: Jo, kurrë nuk pi kur duhet ta ngas veturën.  
 C: Si ndodhi aksidenti atëherë?  
 A: Ma lëshoi njëra gomë dhe e humba kontrollin. Vetura më mori në të djathtë dhe u përplasa për një dru bri rrugës. Vetura u dëmtua bukur shumë, por unë shpëtova lehtë.  
 B/C: Qoftë e kaluar!  
 A: Ju falemnderit.

## II/ GRAMMATICAL PATTERNS

### The Admirative Mood

This mood does not exist in English. In other words, what it expresses in Albanian has no grammatical equivalent in English. Instead, other means are used in English for the same purpose.

The Admirative mood is used to express surprise and/or unexpectedness.

This mood has four tenses: Present, Imperfect, Perfect, and Pluperfect. Present and Perfect are more common than the other two.

To form the Present and Imperfect tenses of this mood, the present and imperfect tenses of the verb **kam** are used as endings, and these are added to a shortened form of the participle. Note, however, that there is some modification to the imperfect forms of **kam** when used in this way. The Present and Imperfect Admirative endings are:

Present	Imperfect
-kam	-kësha
-ke	-këshe
-ka	-kësh/kej
-kemi	-këshim
-keni	-këshit
-kan	-këshin

Here are some verbs in the Present Admirative alongside their citation forms and participles:

Cit. form	Participle	Pres. Adm.
punoj	punuia-r	punuakam
laj	la-rë	lakam
hap	hap-up	hapkam
jam	qen-ë	qenkam
ha	ngrën-ë	ngrënksam, hëngërkam
them	thën-ë	thënkam
kam	pas-up	paskam
rri	ndenj-up	ndenjkam
shes	shit-up	shitkam

The Present Tense of the Admirative is used to express surprise or unexpectedness about something that is going on as the speaker is saying it, e.g.:

Pali i laka enët. Oh, look! Paul is washing up.

It can sometimes be associated with the particle **po** to stress the duration of an action, e.g.:

Pjetri po punuaka në kopsht. Look! Peter's working in the garden.

The Imperfect expresses something that was going on at a particular time in the past, e.g.:

**Pali po e lakësh veturën.** Paul was washing the car!

To form the Perfect and Pluperfect tenses of the Admirative, the Present Admirative and Imperfect Admirative forms of **kam** are used (**paskam etc., paskësha etc.**) followed by the participle.

<i>Perfect</i>	<i>Pluperfect</i>
<b>paskam + participle</b>	<b>paskësha + participle</b>
<b>piske</b>	<b>paskëshe</b>
<b>paska</b>	<b>paskësh(-kej)</b>
<b>paskemi</b>	<b>paskëshim</b>
<b>paskeni</b>	<b>paskëshit</b>
<b>paskan</b>	<b>paskëshin</b>

The Perfect Tense of the Admirative is used like the Present Perfect in English plus a dose of surprise or unexpectedness, e.g.: **Paska ardhur Pjetri.** Look! Peter has come.

The Pluperfect of the Admirative is used like Past Perfect in English expressing at the same time surprise or unexpectedness, e.g.:

**Atëherë e kuptoi se e paskësh humbur një rast të mirë.** Then he understood that he had lost a good opportunity.

You may sometimes come across a subjunctive form of the Admirative and also the forms of a second Perfect or of a second Pluperfect such as:

<i>Subjunctive</i>	<b>të lakam</b>
<i>Perfect II</i>	<b>paskam pasë larë</b>
<i>Pluperfect II</i>	<b>paskësha pasë larë</b>

You may very occasionally come across a future tense of the type **do të lakam.**

Notice the difference between the Admirative forms for active and non-active verbs:

<i>Present</i>	<b>lakam</b>	<b>u lakam</b>
<i>Imperfect</i>	<b>lakësha</b>	<b>u lakësha</b>
<i>Perfect</i>	<b>paskam larë</b>	<b>qenkësha larë</b>

<i>Pluperfect</i>	<b>paskësha larë</b>	<b>qenkësha larë</b>
<i>Subjunctive</i>	<b>të lakam</b>	<b>t'u lakam</b>
<i>Perfect II</i>	<b>paskam pasë larë</b>	<b>paskam qenë larë</b>
<i>Pluperfect II</i>	<b>paskësha pasë larë</b>	<b>paskësha qenë larë</b>

### *The Optative Mood*

The Optative Mood is used to express the speaker's wish. This mood has two tenses, Present and Perfect. The negative form is obtained by using the negative particle **mos** in front of the verb.

Here are the endings for the Present Tense of the Optative:

- a
- 
- të
- im
- i
- in

Notice that before these endings another element is added to the stem of the verb (except for the third person singular) in one of the following forms:

- fsh- (after vowels)
- sh- (after consonants except nasals)
- ç- (after nasals)

Notice one irregularity in verbs which add -fsh- to the stem, in that only -f- is added before the ending -të in the 3rd person singular.

Here is an example:

<b>rroj</b> ( <i>live</i> )
<b>rrofsha</b> ( <i>may I live</i> )
<b>rrofsh</b>
<b>rroftë</b>
<b>Rroftë Nënë Tereza.</b> Long live Mother Teresa.

Here are some verbs in the Present Tense of the Optative given alongside the citation form and the participle (only the first person singular is given):

<i>Cit. form</i>	<i>Participle</i>	<i>Pres. Opt.</i>
<b>punoj</b>	<b>punuar</b>	<b>punofsha</b>
<b>thyej</b>	<b>thyer</b>	<b>thefsha</b>
<b>kruaj</b>	<b>kruar</b>	<b>krofsha</b> ( <i>may I scratch</i> )

shkruaj	shkruar	shkrofsha
luaj	luajtur	luajsha
hyj	hyrë	hyfsha
pres <sup>1</sup>	prerë	prefsha ( <i>may I cut</i> )
pres <sup>2</sup>	pritur	pritsha ( <i>may I wait</i> )
vij	ardhur	ardhsha
heq	hequr	heqsha
dal	dalë	dalsha
hap	hapur	hapsha
mbjell	mbjellë	mbjellsha ( <i>may I plant</i> )
marr	marrë	marrsha
gjej	gjetur	gjetsha
them	thënë	thënça
lë	lënë	lënça
zë	zënë	zënça
rri	ndenjur	ndenjça
shpie	shpënë/shpurë	shpënça/shpufsha ( <i>may I take to</i> )
ha	ngrënë	ngrënça/hëngërsha
jap	dhënë	dhënça

The basic use of the Present Tense of the Optative is to express the speaker's wish at, or following, the moment of speaking, e.g.:

Mos vdeksh kurrë.

May you never die.

Qofsh i gëzuar.

May you be happy.

Ju këndoftë zemra.

*lit.* May your heart sing.

For non-active verbs this tense is formed by placing the non-active particle **u** (the same one as used for the Simple Past of non-active verbs) before the verb, e.g.:

lafsh u lafsh      may you wash/may you be washed

The Perfect Tense of the Optative is formed by using the Present of the Optative of the verb **kam** for active and **jam** for non-active verbs plus the participle of the main verb, e.g.

Active

paça larë (*may I have washed*)

Non-active

qofsha larë (*may I have been washed*)

paç	„	qofsh	„
pastë	„	qoftë	„
paçim	„	qofshim	„
paçi	„	qofshi	„
paçin	„	qofshin	„

The Perfect Tense of the Optative has generally the same basic uses as the Present, but referring to the past. However, the use of this tense is rather restricted. Here are a couple of examples:

E pastë ngrënë djalli. (*lit. May the devil have eaten it.*) To hell with it.

Në paçim punuar edhe ne ashtu, s'do ta kemi punën mirë. If we have done the same, it won't be good for us.

#### Conditional Clauses

The Present Optative is also used in conditional clauses to express a possibility, and is used with the subordinating conjunction **në** or **edhe në** (*if/even if*), e.g.:

Në shkofsha në Angli, do të të lajmëroj. If I go to England, I will let you know.

Edhe në fjetsha, zemrën s'ma vë kush dot në gjumë. Even if I sleep, no one will put my heart to sleep.

#### ■ III/ READING PASSAGE

##### NË FSHAT

Ju kujtohet se para disa ditësh Meri, Beti e Riçardi shkuan në fshat me Meritën. Ata kaluan një vikend të bukur në fshat. Jo vetëm që u kënaqën me jetën e qetë e pa zhurmë të fshatit, por atyre gjithashtu u lanë mbresa shumë të mira gjyshi dhe gjyshja e Meritës. Sa herë që i bënин gjyshit të Meritës ndonjë shërbim të vogël, ai i uronte me fjalët më të mira. Ai u thoshte, 'U rritsh, bija ime!, U gëzofsh, djali im!'. Riçardin e Betin ndonjëherë i ngucute nga pak duke u thënë, 'E marrsh një nuse të mirë!' ose 'E gjetsht një djalë të mirë.'

Fëmijëve të vegjël shpesh u thoshte nga dashuria, 'Mos të çeltë drital!' apo 'Të ngrëntë qeni!'

Gjyshi shpesh u tregonte përralla të bukura dhe ngjarje të

vjetra. Zakonisht përrallat i fillonte me ‘Paskan qenë shtatë vëllezër . . .’ apo ‘Paskan qenë tri motra . . .’ etj., ndërsa të gjithë ulur rrëth tij e dëgjonin me vëmendje.

Shpesh i pyeste mysafirët anglezë për vendin e tyre dhe për jetën atje. Përgjigjet e tyre i përcillte me habi e admirim duke thënë, ‘Po ky qenka vend i mirë!’. I pyeste kryesishët për pleqtë në Angli, për kujdesin ndaj tyre dhe u thoshte, ‘Pleqtë kudo sjellin vetëm kokëçarje, por mos harroni se ua keni borxh kujdesin pleqve.’

Në fund plaku i këndshëm i detyroi mysafirët anglezë t'i premtionin se do ta vizitonin përsëri. Kur po niseshin për në Prishtinë ai u tha:

‘Ju qoftë rruga e mbarë! Ejani përsëri.’

Mysafirët iu përgjigjën:

‘Mbarë paç dhe ju ardhshim për të mirë.’

#### Vocabulary

më kujtohet	I remember ( <i>lit. it is remembered to me</i> )
jo vetëm që	not only
jetë, -a	life
i/e qetë	calm, peaceful
zhurmë, -a	noise
gjithashtu	also
mbresë, -a	impression
sa herë (që)	whenever
shërbim, -e	service, favour ( <i>fem. in pl.</i> )
uroj	bless, congratulate
rritem	grow up, grow
nguc	tease
nuse, -	bride
dashuri	love
çel	open
mos të çeltë drita	may the dawn find you dead ( <i>lit. may the light not open you</i> )
përrallë, -a	fairy tale
ngjarje, -	event, happening
etj.	etc.

ndërsa	while, whereas
vëmendje	attention
përgjigje	answer ( <i>n.</i> )
përcjell	follow, see off
habi	surprise
adimirim	admiration
kryesishët	mainly
kujdes	care
ndaj	towards
kudo	wherever
kokëçarje, -	problem ( <i>lit. head-splitting</i> )
borxh, -e	debt ( <i>fem. in pl.</i> )
fund	bottom
në fund	in the end, finally
i këndshëm	nice, sweet ( <i>masc.</i> )
detyroj	make, force
premtoj	promise
ju qoftë rruga e mbarë	have a nice journey
ju ardhshim për të mirë	‘may we come to you in good times’

#### IV/ EXERCISES

(1) Answer the following questions on the reading passage:

- 1 Ku shkuan Meri, Beti e Riçardi para disa ditësh?
- 2 Me kë shkuan atje?
- 3 Çfarë ështëjeta në fshat?
- 4 Kush u la mbresë mysafirëve anglezë?
- 5 Çka u thoshte gjyshi kur i bënин ndonjë shërbim?
- 6 Si i ngucute Riçardin e Betin ndonjëherë?
- 7 Si u thoshte fëmijëve të vegjël nga dashuria?
- 8 Çka u tregonte gjyshi?
- 9 Si i fillonte përrallat zakonisht?
- 10 A i pyeste gjyshi mysafirët për Anglinë?
- 11 Për çka i pyeste kryesishët?
- 12 Ç'i detyroi t'i premtionin mysafirët në fund?
- 13 Çka u tha kur i përcollit?
- 14 Si iu përgjigjën mysafirët?

(2) Change the following sentences using the Admirative:

*Example:* Po bie shi.  
Po rënska shi.

- (a) 1 Nuk kam para.
  - 2 Nuk është film i mirë.
  - 3 Riçardi nuk ka urë.
  - 4 Nora nuk është e lodhur.
  - 5 Ata po punojnë në kopsht.
  - 6 Ata po e pastrojnë dhomën.
  - 7 Shpresë po këndon në koncert.
  - 8 Qeni po luan me macen.
  - 9 Drita e bën drekën gati.
  - 10 Nora shkruan letra.
  - 11 Drita flet anglisht.
  - 12 Marku po shkon nesër për Angli.
  - 13 Kjo shpellë është interesante.
  - 14 Uji është i ftohtë.
  - 15 Denisi luan futboll mirë.
- 
- (b) 1 Qeni lahet në lumë.
  - 2 Manastiri shihet nga këtu.
  - 3 Denisi rruhet në mbrëmje.
  - 4 Beti takohet (*meet*) me një djale.
  - 5 Meri vishet bukur.
- 
- (c) 1 Na kanë ardhur dy mysafirë.
  - 2 Nora e ka humbur valixhen.
  - 3 Riçardi është lënduar pakëz.
  - 4 Agimi ka pasur një aksident të vogël.
  - 5 Marku është kthyer në Angli.
  - 6 Beti është gëzuar sepse ka marrë letër nga nëna.
- 
- (d) 1 Pjetri po lante veturën.
  - 2 Pali po punonte në kopsht.
  - 3 Ata po shitnin pemë.
  - 4 Ai po mësonte kinezisht.
  - 5 Ato po luanin futboll.

(3) Put the following sentences in the Optative mood:

*Example:* Dëshiroj t'ju vijmë për të mirë.  
Ju ardhshim për të mirë.

- 1 Dëshiroj të shihemi për të mirë.
- 2 Dëshiroj të të bëjë mirë.
- 3 Dëshiroj ta marrë djalli.
- 4 Dëshiroj ta thyesh qafën (*neck*).
- 5 Dëshiroj të jesh i gëzuar.
- 6 Dëshiroj të gëzohesh.
- 7 Dëshiroj të rrrosh sa malet.
- 8 Dëshiroj të kalojnë mirë.
- 9 Dëshiroj të udhëtoni mirë.
- 10 Dëshiroj të kesh fat.
- 11 Dëshiroj të jetosh njëqind vjet.

(4) Translate the following sentences into Albanian using the Optative:

- 1 May you never grow up.
- 2 May you never get old (*plakem*).
- 3 May you (*pl.*) never be happy.
- 4 May you never come back.
- 5 May they never see a nice day.

# Unit Thirteen

## ■ I/ SITUATIONS

<b>ftohem</b>	catch a cold
<b>notoj</b>	swim

A: Bisedova me Dritën. Më tha se ishte ftohur.

B: Si qenka ftohur?

A: Më tha se kishte notuar para disa ditësh.

B: A kishte shkuar te mjeku?

A: Po. Mjeku i kishte dhënë aspirin dhe i kishte thënë të rrinte në shtrat disa ditë.

A: A i telefonove Petrit?

B: Po, por nuk ishte në shtëpi.

A: Ku ishte?

B: Vëllai i tij më tha se kishte shkuar në spital. Një shok i tij kishte pasur një aksident të vogël.

A: Cili shok?

B: Agimi. Mendoj se nuk e ke takuar Agimin ende.

<b>ndeshje, -a, -</b>	match
<b>shënoj</b>	score, note
<b>gol, -i, -a</b>	goal
<b>ekip, -i, -e</b>	team ( <i>fem. in pl.</i> )
<b>lojë, -a, -ra</b>	game
<b>habitëm</b>	(am) surprised
<b>sjellje, -a, -</b>	behaviour
<b>korrekt-e</b>	correct
<b>shikues, -i, -</b>	spectator

A: A e shikuat ndeshjen?

B: Po, por arrițem pak vonë. Kur shkuam, ndeshja kishte filluar. Prishtina kishte shënuar një gol.

A: A qe ndeshja interesante?

B: Po, shumë interesante. Më vonë ekipi mysafir shënoi një gol.

Pastaj, në gjysmën e dytë të lojës Prishtina shënoi edhe dy gola. U habita me sjelljen korrekte të shikuesve.

<b>terren, -i, -e</b>	terrain ( <i>fem. in pl.</i> )
<b>skijim, -i</b>	skiing

A: A erdhi Nora?

B: Shkova ta prisja në stacion por u vonova pak.

A: A e takove fare?

B: Po, ajo ishte nisur. Ishte lodhur shumë me valixhen e saj të rëndë.

A: A kishte kaluar mirë në Prizren?

B: Po, më tha se ishte kënaqur. Kishte qenë një ditë në bjeshkë në Brezovicë.

A: Kam dëgjuar për Brezovicën.

B: Ka terrene shumë të mira për skijim.

## II/ GRAMMATICAL PATTERNS

### The Pluperfect Tense

This tense is formed by putting the Imperfect of the auxiliaries **kam** and **jam** (the first for active, the second for non-active verbs) in front of the participle of the main verb. The easiest way to remember this tense is by comparing it with the Perfect Tense, which as you know by now, mainly corresponds to the Present Perfect in English, e.g.:

**kam punuar** (*I have worked*)

**kisha punuar** (*I had worked*)

**jam larë** (*I have been washed, I have washed myself*)

**isha larë** (*I had been washed, I had washed myself*)

To remind you of the Imperfect of **kam** and **jam** here they are in the singular and plural:

<b>kisha</b>	<b>isha</b>
<b>kishe</b>	<b>ishe</b>
<b>kishte</b>	<b>ishte</b>
<b>kishim</b>	<b>ishim</b>
<b>kishit</b>	<b>ishit</b>
<b>kishin</b>	<b>ishin</b>

To get the Pluperfect of any verb, all you need to know is the participle of the verb, e.g.:

punoj	kisha punuar
vij	kisha ardhur
luaj	kisha luajtur
zë	kisha zënë
shpie	kisha shpënë

As you may guess this tense corresponds to the Past Perfect in English (meaning 'had worked' etc.) The basic use of the Pluperfect is to express something that has happened before a particular moment in the past. For example:

**Marku mendoi sa shumë kishte mësuar për dy javë.**

Mark thought how much he had learned in two weeks.

**Beti mendoi se ishte takuar njëherë me Agimin.**

Betty thought that she had met Agim once.

**Denisi na tregoi se si kishte hipur në dru dhe ishte rrëzuar.**

Dennis told us how he had climbed on the tree and had fallen. The two main uses of this tense can best be seen if we put two of the above examples into direct speech:

**Marku mendoi: 'Sa shumë kam mësuar për dy javë.'**

**Denisi tha: 'Hipa në një dru dhe u rrëzova.'**

Time expressions often used with the Pluperfect are:

atë ditë	that day	atë vit	that year
që atë ditë	since that day	atë vjeshtë	that autumn
në atë kohë	at that time	deri atëherë	till then

For example:

**Që atë ditë nuk e kishte takuar më Agimin.** Since that day she/he had not met Agim.

**Atë vit kishte rënë borë e madhe.** That year there had been a big snowfall.

**Deri atëherë nuk e kishte njojur Ylberin sa duhet.** Till then he/she had not known Ylber well enough.

A subordinating conjunction often used with this tense is:

**para se** before (lit. before that)

For example:

**Para se të kthehej në shtëpi kishte blerë disa libra.** Before returning home he/she had bought some books.

### III/ READING PASSAGE

#### NJË DITË E PRAPË

Ora është shtatë e një çerek në mbrëmje. Fatmiri është ulur në kafenë »Lisi« dhe po e pret Shpendin. Shpendi është dashur të vinte në orën shtatë. Fatmiri po lexon diçka në »Rilindje« dhe po mendon se çka ka ndodhur me Shpendin që u vonua. Sapo e porositi një kafe, ia bëhu Shpendi.

**Shpendi:** Mirëmbrëma, Fatmir.

**Fatmiri:** Mirëmbrëma, Shpend.

**Shpendi:** Të lutem më fal që u vonova.

**Fatmiri:** Thashë mos të ka ndodhur gjë.

**Shpendi:** Jo, jo, asgjë s'më ka ndodhur, por tërë dita më ka shkuar mbrapsh sot. Në mëngjes, ora më ishte ndalur dhe u vonova në punë.

**Fatmiri:** Edhe unë vonohem ndonjëherë.

**Shpendi:** Sapo arrita në punë, fqinji që banon nën mua më telefonoi. Kisha harruar ta ndal ujin në banjë. Uji kishte filluar t'i pikte në banesë.

**Fatmiri:** Ani, çka bëre?

**Shpendi:** U nisa menjëherë për në banesë. Kur arrita atje e pashë se e kisha humbur çelësin.

**Fatmiri:** Si ia bëre atëherë?

**Shpendi:** U desh ta thërras vëllanë nga puna. Për fat m'u kujtua se ia kisha dhënë vëllait një çelës para disa ditësh.

**Fatmiri:** Gjithkujt i ngatërohen punët nganjëherë.

**Shpendi:** Prit. Ka edhe më.

**Fatmiri:** Edhe më?!

**Shpendi:** Hyra në banesë, e mylla rubinetin, e mblohdha ujin në dyshemë me një peshqir dhe u nisa shpejt e shpejt të kthehesha në punë. Kur dola e pashë se po binte shi. Mora taksi. Sapo zbrita nga taksia, zura në thua dhe u rrëzova në baltë. U përleva i téri.

**Fatmiri:** Vërtet paske pasur ditë të prapë.

**Shpendi:** Për fat shefi kishte qenë duke dalë nga ndërtesa. Kur më pa ashtu të baltosur, filloi të qeshte dhe më tha të shkoja në shtëpi.

**Fatmiri:** Mos të ndodhi edhe diçka tjetër që u vonove tash?

*Shpendi:* Jo, por sapo u bëra gati të nisesha, m'u kujtua se i kisha premtuar motrës ta prisja në stacion.

**Vocabulary**

(From now on for each noun in the vocabulary, the singular definite form and the plural indefinite are given.)

i/e prapë	wrong, unruly
lis, -i, -a	oak tree
është dashur	should have
rilindje, -a	renaissance ( <i>name of a newspaper</i> )
(ja) bëh	here/there I come
ia bëhu	there he/she came
thashë mos . . .	'I wondered whether . . .'
banoj	live
nën	under(neath)
pik	drop, drip
çelës, -i, -a	key
si ia bëre	what did you do (about it) ( <i>lit.</i> how did you do to it)
gjithkush	everybody
ngatërröhem	(get) entangled
nganjëherë	sometimes
edhe më	more
mbyll	close
rubinet, -i, -e	tap ( <i>fem. in pl.</i> )
mbledh	gather, collect
dysheme, -ja, -	floor
peshqir, -i, -ë	towel
shpejt e shpejt	quickly
zë në thua	trip up ( <i>lit. catch on the toe nail</i> )
rrëzohem	fall over
baltë, -a	mud
përlyhem	(get) mucky
i tëri	the whole ( <i>masc.</i> ); all over
vërtet	really, truly
shef, -i, -a	boss
ndërtesë, -a, -a	building

i/e baltosur  
qesh

muddy  
laugh

**IV/ EXERCISES**

(1) Answer the following questions on the reading passage:

- 1 Ku është Fatmiri?
- 2 Kë po e pret?
- 3 Kur ia bëhu Shpendi?
- 4 Ç'ditë pati Shpendi sot?
- 5 Pse u vonua Shpendi në punë?
- 6 Kush i telefonoi kur arriti në punë?
- 7 Çka kishte ndodhur?
- 8 A hyri Shpendi menjëherë në banesë kur shkoi atje?
- 9 Pse nuk hyri?
- 10 Çka u desh të bënte?
- 11 Ç'i ndodhi tjetër Shpendit pastaj?
- 12 Kush e pa Shpendin të baltosur?
- 13 Çka i tha ai?
- 14 Pse u vonua Shpendi në mbrëmje?

(2) Complete the following sentences using the Pluperfect of the verbs in brackets:

*Example:* Para se të vinte këtu . . . te Petriti.  
(shkoj)  
Para se të vinte këtu kishte shkuar te Petriti.

- 1 Kur erdhën ata, Nora . . . për Prizren.  
(nisem)
- 2 Kur arrita në shtëpi, Pali i . . . enët. (laj)
- 3 Para se të vinte nëna, Drita e . . . kuzhinën.  
(pastroj)
- 4 Para se të dilte në kafene, . . . darkë. (ha)
- 5 Atë ditë Skënderi . . . shumë peshq. (zë)
- 6 I . . . Agronit ta takojë në stacion. (premtoj)
- 7 Pa rënë mirë në shrat, (atë) e . . . gjumi.  
(zë)

- 8 Ishte i lodhur sepse . . . . . tērē ditēn nē kopsht. (punoj)
- 9 Nora . . . . . një fustan (*dress*) tē bardhë. (vesh)
- 10 Riçardi . . . . . gjithë ditēn. (lexoj)
- 11 Kamarieri u . . . . . nga një kafe. (sjell)
- 12 Shpendi . . . . . ta ndalte ujin. (harroj)
- 13 Sapo (ai) . . . . . nga taksia, . . . . . nē baltë. (zbres; rrëzohem)
- 14 Shefi i . . . . . tē shkonte nē shtëpi. (them)
- 15 Zana . . . . . ca pemë dhe perime. (blej)

(3) Rewrite the following passage using the Pluperfect. Begin like this:

*Nora tha se një ditë para se tē vinte këtu . . .*

*Nora:* Një ditë para se tē vija këtu, u çova (*got up*) shumë herët. Hëngra mëngjes dhe e bëra valixhen gati. Pastaj shkova nē bankë dhe nxora pak tē holla. Për drekë shkova te shoqja ime, Liza. Hëngrëm drekë bashkë dhe biseduam pér pushimet. Ia dhashë Lizës një çelës tē banesës që tē kujdesej (*take care*) pér macen dhe pér lulet. Më vonë shkova dhe i vizitova prindërit. Te prindërit ndenja rrëth dy orë. Në mbrëmje shkova nē shrat më (*more*) herët se (*than*) zakonisht. Më zuri gjumi (*fell asleep*) menjëherë. Fjeta rrëth dhjetë orë atë natë (*night*).

(4) Translate the following sentences into Albanian:

- 1 He had not seen his parents for a long time.
- 2 She had had that dog for fifteen years.
- 3 She had lived in that flat for twenty years.
- 4 I had been on holiday for two weeks.
- 5 They had studied Albanian for two years.
- 6 I had not read that book, but I knew it was good.
- 7 They had never had such a good time.
- 8 He had washed the car before it started raining.
- 9 He had ordered a cup of coffee and was waiting for his friend.
- 10 They had just arrived when the match began.

### (5) Reading Comprehension

*Make sure you understand everything by using the vocabulary given underneath.*

Paska qenë një mbret. Ky mbret e paska pasur një hall tē madh. Një ditë u ul dhe po mendonte. ‘C’është kjo punë me mua? Unë e di se njerëzve u thinjen më parë flokët, pastaj mjekra.’ I mblođhi dijetarët dhe u tha:

‘Ose ma zgjidhni këtë punë, ose do t’ju vras!’

Dijetarët u përpinqën tē gjenin përgjigje, por nuk gjetën. Dolën një ditë tē kërkonin ndonjë dijetar tjetër. Në një mal e takuan një bari me dele. Bariu i kishte flokët tē thinjura, krejt tē bardha, kurse mjekrën ende tē zezë. Dijetarët e pyetën bariun:

‘Or mik, a mund tē na thuash pse flokët i ke tē bardha e mjekrën tē zezë?’

‘Flokët më janë zbardhur nga mendimet,’ u tha bariu, ‘sepse vras kokën si ta mbaj familjen, bagëtinë . . . Kam njëmijë halle.’

‘Po mbreti,’ i thanë dijetarët, ‘pse i ka flokët e zeza e mjekrën tē bardhë?’

‘Puna e mbretit është tjetër,’ u tha bariu. ‘Ai nuk e lodh kokën sepse ka çdo gjë. Për tē tjerët nuk mendon fare, kurse mjekra i është zbardhur sepse vetëm atë e lodh, duke përtypur tërë ditën.’

<b>mbret, -ër</b>	king
<b>hall, -e</b>	problem
<b>thinjem</b>	go grey
<b>flokë</b>	hair
<b>mjekër, -a</b>	beard
<b>mbledh</b>	get together
<b>dijetar, -ë</b>	learned man
<b>zgjidh</b>	solve
<b>përpinqem</b>	try
<b>bari, -nj</b>	shepherd
<b>dele, -</b>	sheep
<b>zbardh</b>	whiten

mendim, -e	thought, thinking
vras kokén	ponder, wrack my brains
mbaj	hold, support
bagëti	livestock
njëmijë	thousand
kokë, -a	head
përtyp	chew

## Unit Fourteen

### ■ I/ SITUATIONS

dënoj	punish
dikush	someone
dikë	someone (acc.)
natyrisht	naturally
detyrë, -a, -a	duty
detyra shtëpie	homework

A: Mësuese a do ta dënoje dikë për një gjë që nuk e ka bërë?  
 B: Natyrisht se jo.  
 A: Shumë mirë sepse sot nuk i kam bërë detyrat e shtëpisë.

që të mos	so that (I) do not; not to
i bie	(I) hit it/him/her
gisht, -i, -a/ërinj	finger
çekan, -i, -ë	hammer

A: Do të jepja çdo gjë ta dija q'duhet të bëj që të mos u bie gishtave me çekan.  
 B: Është gjë e lehtë. Mbaje çekanin me të dyja duart.

lag	soak, wet
lagem	get soaked, wet
A: Si kaluat dje në piknik?	
B: Do të kishim kaluar shumë më mirë po mos të binte shi.	
A: A ju lagu shiu shumë?	
B: Do të na lagte edhe më shumë po mos të vinte Petriti e të na merrte me veturë.	

do të blija	I'd buy
ndihmoj	help
i/e varfér	poor
ndërtoj	build
shtëpizë, -a, -a	little house
A: Çka do të bëje po të kiske para?	
B: Do të blija një veturë të re.	
A: Po ti?	
C: Do të blija shumë libra.	
A: Po ti?	
D: Do të udhëtoja nëpër botë.	
A: Po ti?	
E: Do t'u ndihmoja të varférve.	
A: Po ti?	
F: Do ta ndërtoja një shtëpizë në bjeshkë.	

adresë, -a, -a	address
A: Po të na kishte shkruar Nora para disa ditësh, sot do ta merrnim letërën.	
B: Do të na kishte shkruar por sigurisht nuk ka pasur kohë.	
A: Do t'i shkruanim ne por nuk ia dimë adresën.	

### II/ GRAMMATICAL PATTERNS

#### The Conditional Tenses

To find the form of the Present Conditional, use the particle *do* followed by the Imperfect Subjunctive.

Active	Non-active
do të punoja	do të lahesha
do të punoje	do të laheshe

do tē punonte	do tē lahej
do tē punonim	do tē laheshim
do tē punonit	do tē laheshit
do tē punonin	do tē laheshin
(I would work etc.)	(I would wash myself etc)

The Present Conditional is used to express an action that will take place provided some particular condition is fulfilled, e.g.:

Sikur tē ishte më i talentuar, do tē bëhej aktor i mirë. If he was more talented, he would become a good actor.

The Past Conditional is formed by adding the participle of the main verb to the Present Conditional of the verb **kam** for active or **jam** for non-active verbs.

Active	Non-active
do tē kisha punuar	do tē isha larë
do tē kiske punuar	do tē ishe larë
do tē kishte punuar	do tē ishte larë
do tē kishim punuar	do tē ishim larë
do tē kishit punuar	do tē ishit larë
do tē kishin punuar	do tē ishin larë

The Past Conditional is used to express an action that could have taken place had a particular condition been fulfilled, e.g.:

Ta kisha marrë ombrellën me vete, nuk do tē isha lagur. Had I taken the umbrella with me, I wouldn't have been soaked.

Sentences containing a conditional are commonly introduced by a clause beginning in one of the following ways:

- (a) by the Present Subjunctive, e.g. **tē jem**, **tē kem** e.g.:

Tē jem si ti, nuk do tē rrija këtu. If I were you, I wouldn't stay here.

- (b) by the Past Subjunctive which can also be preceded by **po** or **sikur**, e.g.:

Po/Sikur tē punoja çdo ditë kështu, do t'i kisha punët më mirë. If I worked like this every day, I would be better off.

- (c) by **në vend tëndin** (*in your place*), e.g.:

Në vend tëndin unë do tē veproja ndryshe. In your place I would act differently.

### III/ READING PASSAGE

#### EDHE NE DO TË VINIM NË KINEMA

Riçardi, Beti, Meri dhe Agroni sonte ishin në kinema. Ata shikan filmin ‘Uka i Bjeshkëve të Nemuna’. Filmi u pëlqeu shumë e sidomos pamja madhështore e bjeshkëve. Pasi mbaroi filmi, ata u nisën drejt hotelit. Rrugës po bisedonin për jetën në bjeshkë. Meri tha se po tē kishte pasur mundësi ajo do tē kishte jetuar gjithnjë në bjeshkë. Agroni i tha sejeta në bjeshkë është shumë e mirë por shtoi se ka edhe vështirësi. Ai e pyeti Merin nëse do tē jetonte në bjeshkë gjatë dimrit kur ka shumë borë dhe bën shumë ftohtë; kur disa pjesë mbeten me javë tē izoluara tërësish. Meri mendoi pak dhe, kur e kujtoi tē ftohtët, tha se dimrit nuk do tē jetonte në bjeshkë. . . .

Para se tē arrinin në hotel, i takuan Markun e Petritin.

- Marku:** Ku ishit?
- Riçardi:** Në kinema.
- Marku:** Pse s'na treguat? Ndoshta do tē kishim ardhur edhe ne. Ndoshta do tē kishin ardhur edhe tē tjerët. S'e kishim ndërmend tē shkonim as ne. Rastësish u takuan me Agronin. Ai na tha se ndoshta filmi do tē ishte interesant për ne dhe na propozoi ta shikonim. Ta dinim se po shkonim në kinema, do t'u tregonim tē gjithëve.
- Beti:**
- Meri:** Po bisedonim për Bjeshkët e Nemuna ku ishte xhiruar filmi. Ishin vërtet bjeshkë tē bukura.
- Marku:** Edhe unë e Petriti po bisedonim për bjeshkët, por jo për Bjeshkët e Nemuna. Po bisedonim për Brezovicën. Petriti thotë se do tē ishte mirë tē shkonim në Brezovicë një ditë tē gjithë bashkë.
- Meri:** Do tē ishte mirë tē shkojmë tē shtunën herët në mëngjes dhe tē rrimë deri tē dielën në mbrëmje. Kështu do tē kishim mundësi tē kënaqeshim pak më shumë atje. Unë i dua bjeshkët shumë, sidomos në verë kur nuk është ftohtë.
- Marku:** Do tē shohim pasi tē bisedojmë edhe me tē tjerët.

#### Vocabulary

**Bjeshkët e Nemuna**  
**sidomos**

The Accursed Mountains  
especially

madhështor-e	magnificent
mundësi, -a, -	possibility
vështirësi	difficulty
i/e izoluar	isolated
tërësisht	completely
kujtoj	remember
të ftohtët	the cold
as	neither
propozoj	propose
xhiroj	shoot ( <i>a film</i> )
kënaqem	please (myself)

**IV/ EXERCISES**

(1) Answer the following questions on the reading passage:

- 1 Kush ishte në kinema?
- 2 Ç'film shikuan?
- 3 A u pëlqeu filmi?
- 4 Çka u pëlqeu veçanërisht?
- 5 Çka tha Meri për bjeshkët?
- 6 A do të jetonte ajo në bjeshkë edhe gjatë dimrit?
- 7 Pse?
- 8 Me kë u takuan duke shkuar në hotel?
- 9 Për çka po bisedonin Marku e Petriti?
- 10 Çka tha Meri?

(2) Complete the following sentences with the Present Conditional of the verbs in brackets:

Example: Të kisha kohë ..... prindërit. (vizitoj)  
 Të kisha kohë do t'i vizitoja prindërit.

- 1 Ta dija se do të vije, ..... edhe ty. (ftoj)
- 2 Sikur të kisha kohë, ..... të mësoj spanjisht. (filloj)
- 3 Po të flisja mirë shqip, ..... nëpër fshatra. (shkoj)
- 4 Po të kishte mjaft (*enough*) para, ..... në skijim çdo vit. (shkoj)

- 5 Po të kishim fotoaparat (*camera*), ..... ca fotografi të bukura këtu. (bëj)
- 6 Po të kishim ngrënë darkë, ..... nga një gotë. (pi)
- 7 Po të mos më duhej të punoja, ..... në shtrat. (rrj)
- 8 Po të mos kisha nevojë për para, nuk ..... fare. (punoj)
- 9 Të ishe më i sjellshëm, gjithkush ..... (dua)
- 10 Të ishim më të gjatë, ..... basketboll. (luaj)

N.B. New vocabulary needed for Exercises 3, 4 and 5 is given after each exercise.

(3) Match the two halves of the following sayings.

- |                            |                                   |
|----------------------------|-----------------------------------|
| 1 Po të isha flutur .....  |                                   |
| 2 Po të isha luan .....    |                                   |
| 3 Po të isha bletë .....   |                                   |
| 4 Po të isha gjarpër ..... |                                   |
| 5 Po të isha lule .....    |                                   |
| 6 Po të isha zog .....     |                                   |
| 7 Po të isha lumë .....    |                                   |
| 8 Po të isha fushë .....   |                                   |
| 9 Po të isha yll .....     |                                   |
| 10 Po të isha diell .....  |                                   |
| 11 Po të isha ujk .....    |                                   |
| 12 Po të isha agim .....   |                                   |
| a                          | ... do të udhëtoja me diellin.    |
| b                          | ... do t'i ushqëja lulet.         |
| c                          | ... do ta vizitoja çdo lule.      |
| d                          | ... do t'i thumboja përtacët.     |
| e                          | ... do ta ngrohja çdo zemër.      |
| f                          | ... do ta praroja gjithë botën.   |
| g                          | ... do të flija me qengjin.       |
| h                          | ... do të këndoja çdo mëngjes.    |
| i                          | ... do të gjarpëroja nëpër fushë. |
| j                          | ... do të vallëzoja me hënën.     |
| k                          | ... s'do ta haja Kësulkuqen.      |
| l                          | ... s'do ta përdorja helmin.      |

flutur, -a, -a	butterfly
luan, -i, -ë	lion
bletë, -a, -	bee
gjarpër, -i, -inj	snake
fushë, -a, -a	field
yll, -i, yje	star
ujk, -u, ujq	wolf
agim, -i, -e	dawn ( <i>fem. in pl.</i> )
ushqej	feed
thumboj	sting
ngroh	warm (v.)
praroj	gild
qengj, -i, -a	lamb
vallëzoj	dance
hënë, -a	moon
Kësulkuqe, -ja	Red Riding-hood
përdor	use
helm, -i, -e	poison ( <i>fem. in pl.</i> )

## (4) Reading comprehension

Denisi sot pati dy befasi për gruan e tij. Ai kishte blerë një veturë të përdorur dhe një shtëpi të vjetër. Denisi dhe grua e tij u nisën me veturë për ta parë shtëpinë. Së pari, vetura nuk i pëlqeu gruas së Denisit aspak. Kur e pyeti Denisi gruan se ç'është dashur të bënte, ajo tha:

'Unë do ta kisha testuar veturën te ndonjë mekanik; do t'ia kisha shikuar motorin; do t'ia kisha provuar frenat; do ta kisha shikuar a është e ndryshkur. . . .'

Kur arritën te shtëpia, gruaja e Denisit ishte edhe më e pakënaqur kur pa se dritatet nuk mbylleshin; nuk kishin xhamë të dyfishtë, kurse disa duhej të ndërroheshin; nuk kishte nxemje qëndrore; kopshti ishte i parregulluar; në banjë nuk kishte pasqyrë; dyshemetë s'ishin të shtruara me qilima; muret s'ishin të gëlqerosura; nuk kishte garazh; perdet ishin të vjetra; bodrumi ishte i papastër, kurse orendi nuk kishte fare.

Denisi tha se i kishte ditur të gjitha këto, por gjithashtu e kishte ditur edhe sa të holla kishte.

befasi, -a, -	surprise
përdorur (i/e)	used
aspak	at all
testoj	test
motor, -i, -ë	engine
provож	try, test
frena	brakes
ndryshkur (i/e)	rusty
pakënaqur (i/e)	dissatisfied
mbyll	close
xhamë, -i, -a	glass
dyfishtë (i/e)	double
duhej	should
ndërroj	change
nxemje, -a	heating
qëndror, -e	central
parregulluar (i/e)	untidy
pasqyrë, -ja, -e	mirror
dyscheme, -ja, -	floor
shtroj	lay
qilim, -i, -a	carpet
gëlqeros	paint
garazh, -i, -e	garage ( <i>fem. in pl.</i> )
perde, -ja, -	curtain
bodrum, -i, -e	cellar ( <i>fem. in pl.</i> )
papastër (i/e)	dirty
orendi, -a, -	furniture

## (5) Translate the following passage into Albanian:

Mark and Petrit bought a few lottery tickets. They are now talking about what they would do if they won the first prize, which is very big. Mark says that they should spend it travelling around the world, and visiting all the countries that they have always wanted to see. Petrit says that they should not forget (*harroj as*) their friends as well. He adds that perhaps they should visit fewer countries, but go together with their friends. In the end Mark says that perhaps they should wait to see whether they have won before they spend all the money!

lottery	<b>loto</b> , -ja, -
win	<b>fitoj</b>
prize	<b>çmim</b> , -i, -e, shpërblim
always	<b>gjithmonë</b>

## Unit Fifteen

### ■ I/ SITUATIONS AND PROVERBS

<b>merrem (me)</b>	I do ( <i>lit. I'm taken with</i> )
<b>në përgjithësi</b>	in general
<b>skitar, -i, -ë</b>	skier
<b>ndër</b>	amongst
<b>i rrezikshëm</b>	dangerous
A: A merresh me sport, Petrit?	
B: Merrem nga pak. Sporti, në përgjithësi, më pëlqen shumë.	
A: A të pëlqen skijimi?	
B: Më pëlqen, por nuk jam skitar i mirë. Agroni është skitari më i mirë ndër ne.	
A: Cili është sporti më i mirë për ty?	
B: Më i miri sport për mua është futbolli, ndërsa më i keqi boksi.	
A: Disa sporte janë bukur të rrezikshme. Edhe skijimi është i rrezikshëm.	
B: Po, kur isha i vogël e theva këmbën në skijim.	

<b>sa më . . . aq</b>	the more . . . the more . . .
<b>më . . .</b>	
<b>ëmbël</b>	sweet
A: Sot dita është edhe më e bukur se kur ishim në Deçan.	
B: Po. Tash edhe kemi kohë të kënaqemi më shumë.	
A: Por edhe do të lodhemi më shumë.	

**B:** Sa më e lodhur të jesh, aq më i këndshëm është pushimi.  
**A:** Edhe gjumi është më i ëmbël kur lodhesh, sidomos në bjeshkë.

<b>meritoj</b>	deserve
<b>notë, -a, -a</b>	mark
<b>hartim, -i, -e</b>	essay, composition
<b>i/e ulët</b>	low

**A:** Nuk mendoj se e kam merituar notën një në këtë hartim.  
**B:** As unë nuk mendoj se e ke merituar notën një, por kjo është nota më e ulët.

<b>vuaj</b>	suffer
<b>amnezi, -a</b>	amnesia
<b>që sa kohë</b>	for how long ( <i>lit. since how much time</i> )

**A:** Doktor, unë vuaj nga amnezia.  
**B:** Që sa kohë?  
**A:** Që sa kohë çka?!

<b>dinar, -i, -ë</b>	dinar
<b>xhep, -i, -a</b>	pocket
<b>pantallona</b>	trousers

**A:** Luli, po t'i gjeje tre dinarë në xhepin e majtë dhe dy në xhepin e djathë, q'do të kishe?  
**B:** Sigurisht pantallonat e dikujt tjetër.

<b>as . . . as</b>	neither . . . nor
<b>budalla, -i, -enj</b>	fool
<b>rrëzoj</b>	fell
<b>degë, -a, -</b>	branch
<b>vet</b>	own
<b>kruaj</b>	scratch

As ti s'je më i mençur, as unë s'jam më budalla.  
(*Lit: Neither you are more clever, nor am I more stupid.*)  
Lisin e madh e rrëzojnë degët e veta.  
(*A big tree is felled by its own branches.*)  
Çdo i mençur i ka borxh budallait.  
(*Every clever person is in debt to a stupid one.*)  
Si dora jote s'të kruan e askujt.  
(*Nobody's hand scratches you as well as your own.*)

## II/ GRAMMATICAL PATTERNS

### *Comparison of Adjectives*

You know quite a lot about adjectives by now. You have also come across some adjectives in the comparative degree like **më i mirë** (*better*). Here all the degrees will be given in a more formal way so that you can use them with any adjective where it is possible.

The positive is the unmarked or neutral form, the one we have come across in most of the previous units, e.g.

shtëpia e vogël  
Nora është e lodhur  
bjeshkët e larta

The comparative is usually marked by **më** (*more, -er*) and precedes the adjective, which is then followed by **se**, **sesa** (*than*) or **nga** (*from*). Notice this in the following examples:

Sot dita ishte më e mirë se dje.  
Today the day was better than yesterday.  
Beti është më e bukur sesa e zgjuar.  
Betty is more pretty than intelligent.  
Ai është më i shpejt nga unë.  
He is quicker than me.

To express the idea '*less + adj. than*', use the following construction:

Sot Nora ishte më pak e lodhur se ditëve të tjera.  
Today Nora was less tired than on the other days.  
Ajo është më pak zemërmirë nga e motra.  
She is less warm-hearted than her sister.  
Ai është më pak dinak sesa i rrezikshëm.  
He is less cunning than dangerous.

The superlative corresponds to *most + adj., -est* in English. Notice that the qualified noun is in the definite form. This differentiates it from the comparative, e.g.:

Ajo ishte dita më e lumtur e jetës sime.  
That was the happiest day of my life.  
However, if the adjective precedes the qualified noun, the latter

then is indeclinable, whereas the adjective is in the definite form and takes the endings which usually go on the noun, e.g.:

Ajo ishte më e lumtura ditë e jetës sime.  
Atje e kalova më të mirën pjesë të jetës sime.  
There I spent the best part of my life.

Here are some more examples:

Ai është më i gjati ndër shokët e tij.  
He is the tallest amongst his friends.  
Ajo është më e shpejta në klasë.  
She is the fastest in the class.  
Ai është më i vjetri në fshat.  
He is the oldest in the village.  
Kjo është ndërtesa më e lartë në qytet.  
This is the highest building in the town.  
Ajo është më e bukura nga të gjithat.  
She is the prettiest of all.  
Marku është më i zgjuari prej nesh.  
Mark is the most intelligent of us.  
Ai është njëri ndër shkrimitarët më të mëdhenj.  
He is one of the greatest writers.  
Këto do të janë kujtime nga më të bukurat.  
These will be amongst the best memories.

When equating two things, usually expressed as '*as . . . as . . .*' in English, this is done in Albanian by using one of the following expressions:

(po) aq . . . sa/si (edhe)  
sa . . . aq (edhe)  
(sa) . . . sa  
. . . si  
kaq . . .  
aq . . .

The following examples will make this clear:

Nora është sa e bukur aq edhe e sjellshme.  
Nora is as pretty as she is polite.  
Ata janë aq të këqij sa edhe të rrezikshëm.  
They are as bad as they are dangerous.  
Ai është sa i mirë aq i zgjuar.  
He is as good as he is intelligent.

Ai është sa i gjerë sa i gjatë.  
He is as wide as he is tall.  
**Kurrë s'kam qenë e kënaqur sa atë ditë.**  
I have never been as pleased as that day.  
**Ai ishte trim si zana.**  
He was as brave as a fairy. (This means very brave in Albanian.)  
**Si mund të jesh kaq i keq?**  
How can you be so bad? (*kaq i keq* = this bad)  
**Si mund të ishte aq i qëndrueshëm?**  
How could he be so firm?

Remember that *sa më . . . aq më* corresponds to ‘the + comparative adj. . . . the + comparative adj.’ in English, e.g.:

Vera është sa më e vjetër aq më e mirë.  
The older wine is, the better it is.

Notice also the way of expressing ‘more and more’ using *gjithnjë e më . . . ,* e.g.:

Ai është gjithnjë e më i suksesshëm.  
He is more and more successful.

### ■ III/ READING PASSAGE

#### NË BJESHKË

Meri ka shpirt romantik. Ajo gjithashtu është adhuruesja më e madhe e natyrës ndër të gjithë studentët anglezë. Gjatë gjithë dites dje u kënaq me bukuritë që ofrojnë Bjeshkët e Sharit. Në mbrëmje ra herët në gjumë me qëllim që të ngrihej herët të nesërmën.

Agimi sapo ka zënë të zbardhë. Mizëria e yjeve ka zënë të venitet. Vetëm ylli i mëngjesit ende shndrit në qiejj. Nga lindja kanë zënë të shihen rrezet e para që thyhen në kreshtat e thepisura të bjeshkëve dhe bien në majën e lartë në anën tjetër duke i dhënë ngjyrë ari. Vesa e bardhë argjend sikur edhe ajo zgjohet nga gjumi dhe pret të derdhen mbi të rrezet e diellit para se të tertiqet për gjithë ditën.

Është pothuaj qetësi absolute. Vetëm aty-këtu në largësi dëgjohet ndonjë e lehur e rrallë qensh. Këtyre të lehurave herëherë u bashkohet edhe kënga e zogjve. Dielli nxjerr një sy aty ku

priten dy faqe mali dhe e tregon fuqinë e vet mbi errësirën. Natyra merr ngjyrat e veta.

Kur u ngrit dielli mbi kurorën e pishave shtathedhura, që duke-shin edhe më madhështore me hijet e tyre të zgjatura, e gjeti Merin ulur mbi një shkëmb duke e vështruar këtë bukuri që magjeps.

#### Vocabulary

shpirt, -i, -ra	soul
romantik-e	romantic
gjithashtu	also
adhurues, -i, -	admirer (masc.)
adhuruese, -ja, -	admirer (fem.)
natyre, -a	nature
bukuri, -a	beauty
ofroj	offer
me qëllim që	in order to
ngrihem	get up, stand up
të nesërmën	on the morrow
mizëri, -a	multitude, swarm
venitem	fade
shndrit	twinkle, glitter
qiell, -i, qiej	sky
lindje, -a, -	east, sunrise, birth
zë + Subjunctive	begin to . . .
rreze, rrezja, -	beam
kreshtë, -a, -a	crest
i/e thepisur	sharp-edged
majë, -a, -	peak
anë, -a, -	side
ngjyrë, -a, -a	colour
ar, -i	gold
vesë, -a	dew
argjend, -i	silver
derdh	pour
tërhiqem	withdraw
qetësi, -a	calmness, quietness
absolut-e	absolute
aty-këtu	here and there

largësi, -a, -	distance
e lehur, -a	barking
rrallë	rare
herë-herë	now and again
bashkohem	join, accompany
këngë, -a, -	song
nxjerr	take out
sy, -ri, -	eye
pritem	intersect; cut (myself)
faqe, -ja, -	face; cheek
faqe mali	mountain face
fuqi, -a	strength, force
errësirë, -a	darkness
kurorë, -a, -a	crown
shtathedhur	slim ( <i>read as: shtat-hedhur</i> )
i/e zgjatur	lengthened
shkëmb, -i, -inj	rock
vështroj	observe
magjeps	enchant

#### IV/ EXERCISES

(1) Answer the following questions on the reading passage:

- 1 Ç'shpirt ka Meri?
- 2 A është ajo adhuruese e natyrës?
- 3 Me çka u kënaq dje gjatë gjithë ditës?
- 4 Ç'bëri në mbrëmje?
- 5 Pse ra herët në gjumë?
- 6 Kur u ngrit të nesërmën?
- 7 Ç'po ndodhte me mizërinë e yjeve?
- 8 Cili yll shndriste ende?
- 9 Çka zuri të shihej nga lindja?
- 10 Ku thyhen rrezet e para të diellit?
- 11 Ku bien ato?
- 12 Ç'pret vesa e bardhë?
- 13 Çka dëgjohet aty-këtu në largësi?

- 14 Çka u bashkohet të lehurave të qenve?
- 15 Ç'bën dielli tash?
- 16 Ku e gjeti Merin kur u ngrit dielli mbi kurorën e pishave?
- 17 Çka po bënte Meri aty?

Translate the following questions and then answer them. (Try to guess the meaning of some of the words before you look them up in the vocabulary which follows the exercise):

- 1 Më shumë të pëlqen lindja e diellit apo perëndimi i diellit?
- 2 Më shumë të pëlqen agimi apo muzgu?
- 3 Më shumë të pëlqen drita apo errësira?
- 4 Më shumë të pëlqen dita apo nata?
- 5 Më shumë të pëlqen qielli i kthjellët apo i vranët?
- 6 Më shumë të pëlqen ngjyra e bardhë apo e zezë?
- 7 Më shumë e do detin apo liqenin?
- 8 Më shumë e do hënën apo yjet?
- 9 Më shumë e do mëngjesin apo mbrëmjen?
- 10 Më shumë e do bjeshkën apo vërrinë?
- 11 Më shumë e do shiun apo borën?
- 12 Më shumë e do dimrin apo verën?
- 13 Më shumë e do vjeshtën apo pranverën?
- 14 Më shumë e do të ftohtët apo të nxehët?
- 15 Më shumë i do lulet apo barin?
- 16 Më shumë i do lumenjtë apo përrrenjtë?
- 17 Më shumë të pëlqen puna apo pushimi?
- 18 Më shumë të pëlqen pushimi në bjeshkë apo në det?
- 19 Më shumë të pëlqen vera e kuqe apo e bardhë?
- 20 Më shumë të pëlqejnë qytetet apo fshatrat?

perëndim, -i, -e	sunset
muzg, -u, muzgje	dusk
i/e kthjellët	clear
i/e vranët	cloudy
det, -i, -e	sea
vërr, -a	plain
nxehët	heat, warmth
bar, -i, -ëra	grass
perr/ua, -oi, -enj	stream

## (2) Make sentences equating the two adjectives:

*Example:* Boksi është i dëmshëm (*damaging*), i rrezikshëm.  
Boksi është sa i dëmshëm aq edhe i rrezikshëm.

- 1 Nora është e lumtur dhe e lodhur.
- 2 Petriti është djalë i mirë dhe i sjellshëm.
- 3 Skijimi është sport i mirë dhe i rrezikshëm.
- 4 Drita është punëtore (*hard-working*) dhe e zgjuar.
- 5 Jeta është e ëmbël dhe e vështirë (*difficult*).

## (3) Change the following sentences as in the example:

*Example:* I shkrova letër shoqes më të mirë.  
I shkrova letër më të mirës shoqe.

- 1 Ajo është vajza më e mirë.
- 2 E pashë vajzën më të mirë.
- 3 Kjo është shtëpia e vajzës më të mirë.
- 4 Ia dhashë librin vajzës më të mirë.
- 5 E mora një letër prej vajzës më të mirë.
- 6 Ato janë vajzat më të mira.
- 7 I pashë vajzat më të mira.
- 8 Kjo është shtëpia e vajzave më të mira.
- 9 Ua dhashë librin vajzave më të mira.
- 10 E mora një letër prej vajzave më të mira.

## (4) Translate into English:

Natyra është e bukur derisa nuk e prek dora e njeriut. Njeriu, shpesh duke pasur ndërmend ndonjë qëllim të caktuar, nuk mendon se me dorën e vet po dëmton diçka që është e vlefshme pikërisht për të. Shekulli në të cilin jetojmë ka përjetuar zhvillimin më të bujshëm në shumë fusha, por njëherit ky zhvillim ka krijuar një situatë për pasoja të paparapashme. Nëse nuk reagojmë shpejt, mund t'i paguajmë shtrenjtë të gjitha të arriturat. Aksioni për ruajtjen e natyrës është më i vlefshëm sesa interes i momental për njeriun. Çrrégullimi i baraspeshimit natyror nuk e dëmton vetëm njeriun, por edhe gjallesat e tjera. Njeriu është përgjegjës për të gjitha, prandaj duhet ta përdor arsyen dhe të jetë më largpamës.

*Vocabulary*

prek	touch
i/e caktuar	particular
e vlefshme	valuable
shekull, -i, shekuj	century
përjetoj	experience
zhvillim, -i, -e	development
i bujshëm	rapid
njëherit	at the same time
krijoj	create
situatë, -a, -a	situation
pasojë, -a, -	consequence
i paparapashëm	unpredictable
reagoj	react
shtrenjtë	expensively, dearly
arritur	achievement
aksion, -i, -e	action
ruajtje, -a	preservation
interes, -i, -a	interest
momental-e	momentary
çrrégullim, -i, -e	disorder
baraspeshim, -i, -e	balance
gjallesë, -a, -a	being
përgjegjës-e	responsible
prandaj	therefore
largpamës-e	far-sighted

# Unit Sixteen

## ■ I/ SITUATIONS

lirisht	freely
dashurohem	fall in love
fatkeqësish	unfortunately
vë veshin	pay attention
ia bëj	do (something) about it
disi	somewhat
bind	convince
seriozisht	seriously

A: S'e di a mund të të tregoj diçka.

B: Fol lirisht.

A: Jam dashuruar keq.

B: S'ka asgjë të keqe në këtë.

A: Por, fatkeqësish, ajo që e dashuroj unë nuk ma vë veshin fare.

B: Ani, si do t'ia bësh?

A: Nuk di. Do të përpinqem disi ta bind se e dua seriozisht.

mërshit	bore (v.)
së tepërm	very much
ditë për ditë	every day
bie në dashuri	fall in love
shpreh	express
hapur	openly
rast, -i, -e	opportunity
kalimthi	in passing
i turpshëm	shy
fort i mirë	very good
me kohë	with time, in time
i/e afërt	close

A: Më ka mërshitur së tepërm Ylberi.

B: Pse?

A: Ditë për ditë më thërrret me telefon.

B: Mos, ndoshta, ka rënë në dashuri me ty?

A: Ndoshta, por nuk po e shpreh këtë hapur.

B: Do të ishte mirë t'i japësh rast.

A: E kam takuar disa herë kalimthi, por duket se është i turpshëm.

B: Po a të pëlqen ty ai?

A: Më pëlqen bukur shumë. Më kanë thënë se është djalë fort i mirë.

B: Sigurisht me kohë do të jeni më të afërt.

ditë-ditë

there are days

kështu

like this

përtaci, -a

laziness

luftoj

fight

heq qafe

get rid of (*lit. take off from my neck*)

merru!

take (something) up!

kot

in vain

A: Ditë-ditë më duket se nuk kalon koha fare.

B: Kështu më duket edhe mua nganjëherë. Zakonisht kjo ndodh kur nuk di çka të bësh.

A: Kurrë më parë s'më ka ndodhur kështu.

B: Mos të ka zënë përtacia? Nuk është lehtë të luftosh me përtacinë.

A: Ndoshta, por duhet ta heq qafe disi.

B: Merru me diçka. Puno diçka. Thonë se më mirë është të punosh kot sesa të rrish kot.

i kam punët mirë

get on well

dorë për dore

hand in hand

ngaherë

for a long time

vërej

notice

i humbur

lost

i hareshëm

cheerful

A: Duket se Ylberi i ka punët mirë me Lulen.

B: Vërtet?

A: E pashë dje dorë për dore me të.

B: Shumë mirë, sepse ngaherë s'kam parë njeri më të dashuruar se Ylberin.

- A: Ashtu čshtë. Të gjithë e kemi vërejtur këtë. Sa herë që e takoja, fliste ngadalë dhe pak si i humbur.  
 B: Shpresoj se tash përsëri do të jetë i hareshëm.

## II/ GRAMMATICAL PATTERNS

### *Adverbs*

Adverbs are indeclinable. By now you probably know the meaning of quite a few adverbs. Some more adverbs will be given here so that you can have a clearer view of the whole class, and an extensive reference list. As in many other languages, if wanted, most adverbs can be grouped into those of manner (e.g. mirë 'well'), quantity (e.g. shumë 'much') or location in time and space (e.g. sot 'today', këtu 'here').

In terms of their formal characteristics, they can belong to one of the following groups:

#### (a) Simple adverbs:

Included in this group are adverbs formed by dropping *i/e* from the adjective.

afër (near)	atje (there)
larg (far)	aty (there)
keq (badly)	këtu (here)
mirë (well)	prapa (behind)
lart (high)	pas (after)
poshtë (low)	rrotull (around)
krejt (entirely)	rreth (round)
fare (at all)	rrafsh (flatly)
andej (that way)	këndej (this way)
ashtu (like that)	kështu (like this)
sot (today)	dje (yesterday)
sonte (tonight)	pardje (the day before yesterday)
nesër (tomorrow)	vjet (last year)
pasnesër (the day after tomorrow)	sivjet (this year)
nesër mbrëma (tomorrow evening)	mbrëmë (last night)
	moti (a long time ago)

#### herët (early)

#### (b) Adverbs derived from different cases of nouns or adjectives:

ditën (by day)	një ditë (one day)
natën (by night)	një natë (one night)
një kohë (one time)	një mbrëmje (one evening)
anash (aside)	

#### së bashku (together)

së paku (at least)	së tepërmë ((too) much)
së fundi (at last)	së andejmi (therefore)

#### (c) Participles used as adverbs:

hapur (openly)	fshehur (hidden)
kaluar (riding)	papritur (unexpectedly)
shkoqur (clearly)	parreshtur (non-stop)

#### (d) Adverbs formed with characteristic suffixes:

-i)sht	fatmirësht (luckily)
hollësish (in detail)	fatkeqësht (unluckily)

#### -as/-azi

barkas, barkazi (crawling)
fshehtas, fshehtazi (secretly)
gjunjas, gjunjazi (on one's knees)
radhas, radhazi (in turn)
majtas, majtazi (on the left)
djathtas, djathtazi (on the right)
fytas, fytazi (at each other's throats)

#### -thi

fluturimthi (quickly)	kalimthi (in passing)
rrëmbimthi (rushingly)	arithi (upright)

#### -çë

qençë (doglike)	fshatarçë/fshaçë (as in a village)
-----------------	------------------------------------

## (e) Compound adverbs:

gjith- + -ashtu	<b>gjithashtu</b>	(also)
gjith- + -një	<b>gjithnjë</b>	(always)
gjith- + -monë	<b>gjithmonë</b>	(always)
gjith- + -herë	<b>gjithherë</b>	(always)
kur- + -do	<b>kurdo</b>	(whenever)
ku- + -do	<b>kudo</b>	(wherever)
si- + -do	<b>sido</b>	(anyhow)
qysh- + -do	<b>qyshdo</b>	(in any way)
nga- + -do	<b>ngado</b>	(anywhere)
sa- + -do	<b>sado</b>	(no matter how)
kur - do - herë	<b>kurdoherë</b>	(anytime)
nga - ndonjë - herë	<b>ngandonjëherë</b>	(sometimes)
di - kur	<b>dikur</b>	(at some time)
di - si	<b>disi</b>	(somehow)
ndo - kund	<b>ndokund</b>	(somewhere)
di - kund	<b>dikund</b>	(somewhere)
di - ku	<b>diku</b>	(somewhere)
as - gjë - kundi	<b>asgjëkundi</b>	(nowhere)
as - kund	<b>askund</b>	(nowhere)
kurr - kund	<b>kurrkund</b>	(nowhere)
as - kurr - kund	<b>askurrkund</b>	(nowhere)
gjë - kundi	<b>gjëkundi</b>	(somewhere)
tjetër - kund	<b>tjetërkund</b>	(somewhere else)
një- -herë	<b>njëherë</b>	(once)
asnëjë- -herë	<b>asnëjëherë</b>	(never)
menjë- -herë	<b>menjëherë</b>	(immediately)
nga- -herë	<b>ngaherë</b>	(a long time ago)
për- -herë	<b>përherë</b>	(always, all the time)
kurdo- -herë	<b>kurdoherë</b>	(at any time)
përnjë- -herë	<b>përnjëherë</b>	(all of a sudden)
shpesh- -herë	<b>shpeshherë</b>	(often)
rrallë- -herë	<b>rrallëherë</b>	(rarely)

<b>pér- -ballë</b>	<b>pérballë</b>	(opposite)
<b>pér- -bri</b>	<b>pérbri</b>	(aside)
<b>pér- -dhe</b>	<b>pérdhë</b>	(on the ground)
<b>pér- -fundi</b>	<b>pérfundë</b>	(underneath)
<b>pér- -krahu</b>	<b>pérkrahu</b>	(by the arm)
<b>pér- -mes</b>	<b>pérmes</b>	(by means of)
<b>pér- -qark</b>	<b>pérqark</b>	(around)
<b>pér- -rreth</b>	<b>pérreth</b>	(around)
<b>pér- -ditë</b>	<b>pérditë</b>	(every day)
<b>pér- -natë</b>	<b>pérnatë</b>	(every night)
<b>pér- -herë</b>	<b>pérherë</b>	(always)
<b>ndér - kaq</b>	<b>ndérkaq</b>	(however)
<b>do - si - do</b>	<b>dosido</b>	(no matter how)
<b>një - lloj</b>	<b>njëlloj</b>	(the same)
<b>kësi - soj</b>	<b>kësisoj</b>	(like this)
<b>si - do - ku - do</b>	<b>sidokudo</b>	(anyhow, still)
<b>vet - vetiu</b>	<b>vetvetiu</b>	(spontaneously)
<b>anë - e - kënd</b>	<b>anekënd</b>	(everywhere)
<b>buz - a - gaz</b>	<b>buzagaz</b>	(smilingly)

## (f) Hyphenated adverbs:

<b>copë-copë</b> (to pieces)	<b>palë-palë</b> (in pairs)
<b>copa-copa</b> (to pieces)	<b>tufë-tufë</b> (in bunches)
<b>flokë-flokë</b> (in flakes)	<b>shumë-shumë</b> (at most)
<b>shkallë-shkallë</b> (step by step)	<b>aty-këtu</b> (here and there)
<b>grupe-grupe</b> (in groups)	<b>vende-vende</b> (in places)
<b>herë-herë</b> (at times)	<b>dita-ditës</b> (day by day)
<b>pjesë-pjesë</b> (piece by piece)	<b>dredha-dredha</b> (tortuously)

Notice that most of these adverbs are reduplicated.

## (g) Phrasal adverbs:

<b>me natë</b> (before dawn)	<b>me vrap</b> (quickly)
<b>me kohë</b> (in time)	<b>me ngut</b> (hastily)
<b>me pahir</b> (unintentionally)	
<b>me të egër</b> (wildly)	<b>me të mirë</b> (nicely)
<b>me të keq</b> (badly)	<b>me të qetë</b> (calmly)
<b>me të shpejtë</b> (quickly)	<b>me të butë</b> (softly)

për bukuri (*beautifully*)

për së largu (*from afar*)  
 pér së gjeri (*from the broad side*)  
 pér së gjati (*lengthwise*)  
 pér së larti (*from high up*)

prej kohe/kohësh (*long ago*)

më këmbë (*on foot*)  
 më dysh (*into two*)  
 më tresh (*into three*)  
 më katersh (*into four*)

rreth e rreth (*all around*)  
 varg e varg/vistér (*in a row*)  
 ditë (e) natë (*day and night*)  
 fund e krye (*tip to toe*)  
 hundë e buzë (*flat on your face*)  
 orë e çast (*now and again*)  
 shkel e shko (*slap-dash*)  
 dimër e verë (*winter and summer*)  
 verë e dimër (*summer and winter*)  
 poshtë e lart (*up and down*)  
 pranë e pranë (*next to*)  
 mirë e mirë (*well enough*)

ditë pér ditë (*every day*)  
 natë pér natë (*every night*)  
 mëngjes pér mëngjes (*every morning*)  
 javë pér javë (*every week*)  
 dorë pér dore (*hand in hand*)  
 fjalë pér fjalë (*word for word*)  
 kokë pér kokë (*head to head*)  
 pikë pér pikë (*exactly*)  
 drejt pér drejt (*directly*)  
 brenda pér brenda (*from within*)  
 tani pér tani (*for now*)

pér turp (*shamefully*)

pér së ngushti (*narrowly*)  
 pér së shpejti (*quickly*)  
 pér së tepërmë (*exceedingly*)

breg më breg (*from hill to hill*)  
 degë më degë (*from branch to branch*)  
 shpat më shpat (*from slope to slope*)  
 shteg më shteg (*from path to path*)  
 skaj më skaj (*from corner to corner*)  
 gju më gju (*knee to knee*)  
 gojë më gojë (*mouth to mouth*)  
 sy më sy (*eye to eye*)  
 buzë më buzë (*lip to lip*)  
 faqe më faqe (*cheek to cheek*)  
 kot më kot (*in vain*)

dita me ditë (*by the day*)  
 kurrën e kurrës (*never ever*)  
 pak nga pak (*little by little*)

nga dita në ditë (*from day to day*)  
 nga çasti në çast (*from moment to moment*)  
 nga viti në vit (*from year to year*)

(h) *A number plus the Ablative case of the noun fije/fill (thread):*  
 njëfish ‘onefold’ (*single*)  
 dyfish ‘twofold’ (*double*)  
 trefish ‘threefold’ (*treble*)

#### Comparison of Adverbs

Some adverbs may have a comparative or even a superlative degree. The comparison of adverbs is similar to the comparison of adjectives (see the previous Unit). Compare the following examples:

Ai është i shpejtë. He is fast.

Ai vrapon shpejt. He runs fast.

Ai është më i shpejtë se unë. He is faster than me.

Ai vrapon më shpejt se unë. He runs faster than me.

Ai është më i shpejti. He is the fastest.

Ai vrapon më shpejt nga të gjithë. He runs faster than all.

Ai vrapon më së shpejti. He runs the fastest.

**III/ READING PASSAGE****KTHIMI NË ANGLI**

Studentët anglezë po e përfundojnë vizitën e tyre në Kosovë. Sot ata udhëtojnë për në Angli. Aq sa janë të gjëzuar që po kthehen në vendlindje, aq janë të pikëlluar që po ndahen nga shokët e tyre.

Ndër të gjithë, Nora është më e gjëzuar. Ajo po kthehet në Angli së bashku me Dritën. Drita ka qenë në Angli edhe më parë, por asnjëherë nuk ka kaluar shumë kohë në Londër sepse Nora jetonte me prindërit në Jork. Tash Drita do të kalojë dy javë në Londër sepse Nora studion atje. Drita pret me padurim të vizitojë pjesët më interesante të Londrës, muzetë, galeritë e arteve, sheshet madhështore, parqet, etj., për të cilat ka dëgjuar shumë.

Studentët do të fluturojnë me aeroplan nga Prishtina në Beograd prej ku pastaj kanë aeroplan për Londër. Shumë nga shokët e tyre shqiptarë kanë dalë në aeroportin e Prishtinës në Sllatinë për t'i përcjellë.

Marku do të kthehet në Prishtinë përsëri pas disa javësh. Ai dëshiron ta studiojë gjuhën shqipe. Nora për pak nuk mbeti në Prishtinë sepse mezi e gjeti biletën në çantën e saj bukur të madhe të dorës.

Erdhi koha të përhëndeteshin, dhe ndarja, si çdo ndarje, ishte e pikëllueshme. Disa u larguan të përlotur, disa mbetën të përlotur. . .

Aeroplani u nis, mori hovin e duhur dhe lehtas u shkëput nga toka. Ata që kishin dalë t'i përcillnin shokët dhe shoqet e tyre që po udhëtonin, e shikuan aeroplanin duke u ngritur në qiellin e kaltër dhe duke u zvogëluar pak nga pak në largësi.

**Vocabulary**

përfundoj	finish
vendlindje, -a, -	birthplace
i/e pikëlluar	sad
ndahem	part, (am) separated
asnijëherë	never
studioj	study
muzé, -u, -	museum

galeri, -a, -	gallery
art, -i, -e	art (fem. in pl.)
shesh, -i, -e	square (fem. in pl.)
park, -u, parqe	park (fem. in pl.)
etj. (e të tjerë-a)	etc.
fluturoj	fly
aeroplan, -i, -ë	aeroplane
aeroport, -i, -e	airport (fem. in pl.)
përcjell	see off
mezi	hardly
përhëndetem	greet each other
ndarje, -a, -	parting, separation
e pikëllueshme	sad
largohem	be distanced from, move away
i/e përlotur	tearful
hov, -i, -e	stride; run-up (fem. in pl.)
i/e duhur	necessary
lehtas	easily
shkëputem	be detached, take off
tokë, -a	ground, earth
zvogëlohem	become smaller

**IV/ EXERCISES**

(1) Answer the following questions on the reading passage:

- 1 Kur kthehen studentët anglezë në Angli?
- 2 Me çka do të udhëtojnë ata?
- 3 Ku do ta ndërrojnë aeroplanin?
- 4 Kush ka dalë në Sllatinë t'i përcjellë?
- 5 A janë ata të gjëzuar apo të pikëlluar?
- 6 Pse është Nora më e gjëzara?
- 7 A ka qenë Drita në Angli më parë?
- 8 A ka kaluar shumë kohë në Londër?
- 9 Ku ka jetuar Nora më parë?
- 10 Pse tash jeton në Londër?

- 11 Sa kohë do të qëndrojë (*stay*) Drita në Londër?
- 12 Çka shpreson të vizitojë?
- 13 Kush do të kthehet në Prishtinë përsëri pas disa javësh?
- 14 Pse do të kthehet?
- 15 Çfarë është moti?

(2) Change the following sentences using adverbs instead of adjectives:

*Example:* Nora është e ngadalshme (*slow*). (ecën)  
Nora ecën ngadalë.

- 1 Marku është i shpejtë. (vrapon)
- 2 Kënga e Betit është e bukur. (këndon)
- 3 Fjala e tij është e hapur. (flet)
- 4 Ajo ishte e lirë në bisedë (*conversation*). (fliste)
- 5 Takimi (*meeting*) ynë ishte i rastit. (u takuam)
- 6 Vonesa (*delay*) e saj është e zakonshme. (vonohet)
- 7 Ky libër është i shtrenjtë (*expensive*). (kushton)

(3) Substitute an appropriate adverb for the words in italics:

*Example:* Sot në mbrëmje do të shkoj në kino.  
Sonte do të shkoj në kino.

- 1 Para dy ditësh isha te Petriti.
- 2 Dje në mbrëmje e takova Agronin.
- 3 Pas dy ditësh do të kthehem i në Angli.
- 4 Vitin e kaluar isha në Spanjë.
- 5 Ka shumë kohë që nuk jemi parë.
- 6 Nesër në mbrëmje do të shkojmë në teatër.
- 7 Gjatë ditës bën shumë nxeh të (*hot*).
- 8 Gjatë natës bën freskët.
- 9 Gjatë verës shkoj në Detin Adriatik.
- 10 Gjatë dimrit shkoj në skijim.

(4) Complete the following sentences with the opposite adverb:

*Example:* Ose është poshtë, ose është .....  
Ose është poshtë, ose është lart.

- 1 Kur ka dëshirë, punon mirë, kur nuk ka dëshirë, punon .....
- 2 Kur është moti i mirë shkoj atje, kur nuk është, tri .....
- 3 Nëse punon kështu, të ndihmoj, nëse punon ..... nuk të ndihmoj.
- 4 Kur flet shpejt nuk e kuptoj, kur flet ..... e kuptoj.
- 5 Kur jam afër e dëgjoj, kur jam ..... nuk e dëgjoj.
- 6 Kur punoj shumë ndihem i lodhur, kur punoj ..... nuk ndihem i lodhur.
- 7 Kur çohem (*get up*) herët, shkoj në punë me kohë, kur çohem ..... vonohem.
- 8 Kur jemi bashkë, më kalon koha shpejt, kur jam ..... nuk më kalon koha fare.
- 9 Nëse shkon këndeje, ndoshta takohemi, nëse shkon ..... sigurisht nuk do të takohemi.
- 10 Ai na foli shkurtimisht (*briefly*), unë pata dëshirë të na fliste .....
- 11 Është mirë kur e takon dikë qëllimisht (*on purpose*), por shpesh është edhe më mirë kur e takon dikë .....

(5) Translate the following into Albanian:

Sam is a clerk in an office (*zyrë*). He goes to work every day, but he doesn't like work very much. He always reads the newspaper at work. When he gets to the office, he first does the crossword (*e plotësoj fjalëkryqin*) in the newspaper. Every day he comes home at 3:30. He never helps his wife in the kitchen. He usually watches TV in the evening. He is always very happy when it is the weekend. He goes fishing every Sunday, but never brings anything home.

# Unit Seventeen

## ■ IV SITUATIONS AND PROVERBS

papagall, -i, papagaj	parrot
pronar, -i, -ë	owner
poliglot, -i, -ë	polyglot
krenari, -a	pride
me krenari	proudly
furrë, -a, -a	oven
pjek	bake
piqem	(am) baked
dëshprim, -i, -e	despair ( <i>fem. in pl.</i> )

as gojën s'e ka çelur hasn't even opened its mouth

Një njeri bleu një papagall që fliste pesë gjuhë. Pagoi njëmijë dollarë për të. Pronari i dyqanit i tha se do t'ia dërgonte në shtëpi pas dy orësh. Njeriu shkoi në punë. Tëré ditën u tregoi shokëve të punës se si kishte blerë një papagall poliglot. Kur e mbaroi punën, nuk u ndal në kafene, si zakonisht, për ta çuar një gotë, por shkoi drejt e në shtëpi. E pyeti gruan me krenari nëse kishte arritur papagalli.

'Po,' iu përgjigj ajo.

'Ku është?'

'Në furrë duke u pjekur. Ende nuk është gati.'

'Në furrë? ! Por ai i ka ditur pesë gjuhë?' i tha njeriu plot dëshprim.

'As gojën s'e ka çelur.'

vetë	-self, oneself
vete, vetja	-self, oneself
bërtas	shout

A: Me kë po flet ky njeri?

B: Vetë me veten.

A: Pse atëherë po bërtet kaq shumë?

B: Nuk dëgjon mirë.

time	my
komandoj	command, give orders
thjesht	simply
urdhëroj	give orders
kryhem	(am) finished

A: Unë në shtëpinë time komandoj më shumë se mbreti.

B: Si ashtu?

A: Shumë thjesht. Mbreti urdhëron një herë dhe ajo punë kryhet, kurse unë urdhëroj njëzet herë dhe puna nuk kryhet.

vitrinë, -a, -a	shop window
optikë, -a	optics

Në vitrinën e një dyqani të optikës shkruante:

'Nëse nuk e shihni atë që dëshironi, keni ardhur mu aty ku duhet'

gjenjeshtar, -i, -ë	liar
kap	catch
kapem	get caught
topall, -i, -ë	lame person
xhelazi, -a	jealousy
pasqyrë, -a, -a	mirror
e metë, -a, të meta	deficiency, defect
duroj	endure, stand
fatkeqësi, -a, -	misfortune
me anë të	by means of
vetëvrasje, -a, -	suicide
diamant, -i, -e	diamond
përpunoj	refine, process

Gjenjeshtari kapet më lehtë se topalli.

(A liar is caught more easily than a lame person.)

Xhelozia vjen bashkë me dashurinë, por nuk ikën me të.

(Jealousy comes together with love, but doesn't go away with it.)

Pasqyra më e bukur për njeriun është miku i vjetër që ia thotë të metat.

(The best mirror for a person is the old friend who tells him the whole truth.)

Është më lehtë ta durosh fatkeqësinë sesa të shpëtosh me anë të vetëvrasjes.

(It is easier to endure bad luck than to escape by means of suicide.)

Mendimet janë si diamanti, sa është vështirë të gjenden, aq është vështirë të përpunohen.

(*Thoughts are like diamonds – as difficult to find as they are to be refined.*)

## II/ GRAMMATICAL PATTERNS

### Possessive Adjectives

**im, yt, i tij, i saj, ynë, juaj, i tyre etc.**

These are not new to you. They have been introduced in Unit Six but only in the Nominative case. A full table for all the cases is given below. They are used attributively, that is, following the noun, e.g. **shoku im**.

Note that the Genitive particle (see Unit Six) has been omitted for simplicity, since there is only one common form to learn for Genitive, Dative and Ablative.

My

CASE	singular		plural	
	masc.	fem.	masc.	fem.
Nom.	shoku im	shoqja ime	shokët e mi	shoqet e mia
Acc.	shokun tim	shoqen time	shokët e mi	shoqet e mia
Gen./ Dat./ Abl.	shokut tim	shoqes sime	shokëve të mi	shoqeve të mia

Your (sing.)

Nom.	shoku yt	shoqja jote	shokët e tu	shoqet e tua
Acc.	shokun tënd	shoqen tënde	shokët e tu	shoqet e tua
Gen./ Dat./ Abl.	shokut tënd	shoqes sate	shokëve të tu	shoqeve të tua

His

Nom.	shoku i tij	shoqja e tij	shokët e tij	shoqet e tij
Acc.	shokun e tij	shoqen e tij	shokët e tij	shoqet e tij
Gen./ Dat./ Abl.	shokut të tij	shoqes së tij	shokëve të tij	shoqeve të tij

Her

Nom.	shoku i saj	shoqja e saj	shokët e saj	shoqet e saj
Acc.	shokun e saj	shoqen e saj	shokët e saj	shoqet e saj
Gen./ Dat./ Abl.	shokut të saj	shoqes së saj	shokëve të saj	shoqeve të saj

Our

Nom.	shoku ynë	shoqja jonë	shokët tanë	shoqet tona
Acc.	shokun tonë	shoqen tonë	shokët tanë	shoqet tona
Gen./ Dat./ Abl.	shokut tonë	shoqes sonë	shokëve tanë	shoqeve tona

Your (pl.)

Nom.	shoku juaj	shoqja juaj	shokët tuaj	shoqet tuaja
Acc.	shokun tuaj	shoqen tuaj	shokët tuaj	shoqet tuaja
Gen./ Dat./ Abl.	shokut tuaj	shoqes suaj	shokëve tuaj	shoqeve tuaja

## Their

<i>Nom.</i>	shoku i tyre	shoqja e tyre	shokët e tyre	shoqet e tyre
<i>Acc.</i>	shokun e tyre	shoqen e tyre	shokët e tyre	shoqet e tyre
<i>Gen./ Dat./ Abl.</i>	shokut të tyre	shoqes së tyre	shokëve të tyre	shoqeve të tyre

*The reflexive possessive i/e vet*

This adjective can stand instead of the third person possessives both in the singular and the plural. For example, instead of saying:

Ai e mori librin e tij. He took his book.

which can be ambiguous since e tij 'his' can refer either to ai 'he' or to somebody else, we can say:

Ai e mori librin e vet. He took his own book.

In this case there is no ambiguity. Notice from the table below all the possible forms of this adjective.

CASE	singular		plural	
	<i>masc.</i>	<i>fem.</i>	<i>masc.</i>	<i>fem.</i>
<i>Nom.</i>	shoku i vet	shoqja e vet	shokët e vet	shoqet e veta
<i>Acc.</i>	shokun e vet	shoqen e vet	shokët e vet	shoqet e veta
<i>Gen./ Dat./ Abl.</i>	shokut të vet	shoqes së vet	shokëve të vet	shoqeve të veta

*Kinship*

For nouns of kinship there is an alternative way of expressing possession. This is possible only with the possessives *im*, *ime*, *yt*, *jote*. These precede the nouns (e.g. *vëlla*, *motër*, etc.), and have different forms from those used when they follow the noun.

CASE	<i>masculine</i>		<i>feminine</i>	
<i>Nom.</i>	<i>im</i> / <i>yt</i>	<i>vëlla</i>	<i>ime</i> / <i>jot</i>	<i>motër</i>
<i>Acc.</i>	<i>tim</i> / <i>tët</i>	<i>vëlla</i>	<i>time</i> / <i>tët</i>	<i>motër</i>
<i>Gen./Dat./Abl.</i>	<i>tim</i> / <i>tyt</i>	<i>vëllai</i>	<i>sime</i> / <i>sat</i>	<i>motre</i>

For the same nouns another alternative exists for the third person which entails using the particle in front of the noun. The meaning of the particle in all such cases is *his*, *her* or *their*, and the context reveals which is relevant. Notice that elision takes place before nouns beginning with a vowel.

CASE	<i>masculine</i>		<i>feminine</i>	
<i>Nom.</i>	i vëllai	i ati	e motra	e ëma
<i>Acc.</i>	të vëllanë	të atin	të motrën	t'ëmën
<i>Gen./Dat./Abl.</i>	të vëllait	t'et	së motrës	s'ëmës

<i>Nom./Acc.</i>	<i>të vëllezërit</i>	<i>të motrat</i>
<i>Gen./Dat./Abl.</i>	<i>të vëllezërve</i>	<i>të motrave</i>

*Pronouns*

You have already met many kinds of pronouns and their forms. Here some types of pronouns will be briefly outlined with more emphasis on the forms you have not yet come across.

Pronouns are usually classified into groups, of which a few are considered here. The remaining groups will be met later.

(a) *Personal pronouns:*

unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato

(b) *Reflexive pronouns:*

vetja (vetvetja) (-self, oneself)

Notice that this pronoun declines like a feminine noun. It has only the singular form, but substitutes for both singular and plural

nouns. It can also be preceded by some prepositions. Here are some examples:

**Vetja i pëlqen më shumë se kushdo tjetër.** He/she likes him/herself more than anybody else.

**Mos e vë veten në rrezik.** Don't put yourself in danger.

**Nëse nuk i beson vetes, s'mund t'i besosh askujt.** If you don't trust yourself, you can't trust anybody.

**Punët e vvetesë i duken më të rëndësishmet.** His/her affairs seem to him/her the most important.

**Ai mendon vetëm për veten.** He thinks only about himself.

**I mori disa shokë me vete.** He took some friends with him.

**Ata, për veten e tyre, punuan mjaft.** As far as they are concerned, they worked enough.

<b>E dëmtova veten</b>	I hurt (damaged) myself
<b>E dëmtove veten</b>	You hurt yourself
<b>E dëmtoi veten</b>	He/she hurt him/herself
<b>E dëmtuam veten</b>	We hurt ourselves
<b>E dëmtuat veten</b>	You hurt yourselves
<b>E dëmtuan veten</b>	They hurt themselves

(c) *The identifying pronoun:  
vetë*

This pronoun does not change for number or case, e.g.:

**Ai vetë deshi të vinte.** He himself wanted to come.

**Ju vetë u thatë të shkonin.** You yourselves told them to go.

**Dera u hap vetë.** The door opened itself.

**Puna nuk kryhet vetë.** The work doesn't finish itself.

**Shpesh njeriut i mërzitet vetëjeta.** Life itself is often boring to man.

(d) *Reciprocal pronouns:*

**njëri-tjetrin njëra-tjetren shoku-shokun (shoqi-shoqin) shoqja-shoqen**

These all mean 'each other, one another', e.g.:

**E shikonin njëri-tjetrin.** They looked at each other.

**E ngucnin shoku-shokun.** They teased each other.

**E mësonin shoqja-shoqen.** They (*fem.*) taught each other.

Notice that these all decline according to gender.

(e) *Possessive pronouns:*

**imi, yti, i tiji, i saji, yni, juaji, i tyri etc.**

This group of possessive pronouns corresponds to *mine*, *yours* etc. Remember that these pronouns, which can stand on their own instead of nouns, basically take the same endings as the nouns, depending on the case, gender and number of the noun they substitute for, e.g.:

**shoku im – imi, shoqja ime – imja etc.**

All the forms are listed below.

Mine

CASE	singular		plural	
	masc.	fem.	masc.	fem.
<i>Nom.</i>	imi	imja	të mitë	të miat
<i>Acc.</i>	timin	timen	të mitë	të miat
<i>Gen./Dat./Abl.</i>	timit	simes	të mive	të miave

Yours (sing.)

<i>Nom.</i>	ythi	jotja	të tutë	të tuat
<i>Acc.</i>	tëndin	tënden	të tutë	të tuat
<i>Gen./Dat./Abl.</i>	tëndit	sates	të tuve	të tuave

His

<i>Nom.</i>	i tiji	e tija	të tijtë	të tijat
<i>Acc.</i>	të tijin	të tijën	të tijtë	të tijat
<i>Gen./Dat./Abl.</i>	të tijit	së tijës	të tijve	të tijave

## Hers

<i>Nom.</i>	i saji	e saja	të sajtë	të sajat
<i>Acc.</i>	të sajin	të sajën	të sajtë	të sajat
<i>Gen./Dat./Abl.</i>	të sajit	të sajës	të sajve	të sajave

## Ours

<i>Nom.</i>	yni	jona	tanët	tonat
<i>Acc.</i>	tonin	tonën	tanët	tonat
<i>Gen./Dat./Abl.</i>	tonit	sonës	tanëve	tonave

Yours (*pl.*)

<i>Nom.</i>	juaji	juaja	tuajt	tuajat
<i>Acc.</i>	tuajin	tuajën	tuajt	tuajat
<i>Gen./Dat./Abl.</i>	tuajit	suajës	tuajve	tuajave

## Theirs

<i>Nom.</i>	i tyri	e tyrrja	të tyret	të tyret
<i>Acc.</i>	të tyrin	të tyren	të tyret	të tyret
<i>Gen./Dat./Abl.</i>	të tyrit	së tyres	të tyreve	të tyreve

(f) *The reflexive possessive pronoun:*

This corresponds to the adjective introduced earlier in the unit, and means 'his own' etc. Its forms are as follows.

CASE	singular		plural	
	<i>masc.</i>	<i>fem.</i>	<i>masc.</i>	<i>fem.</i>
<i>Nom.</i>	i veti	e veta	të vetët	të vetat
<i>Acc.</i>	të yetin	të vetën	të vetët	të vetat
<i>Gen./Dat./Abl.</i>	të vetit	së vetës	të vetëve	të vetave

## III/ READING PASSAGE

## DRITA I SHKRUAN BLERTËS

E dashura Blertë,

Ja, po të shkruaj nga Anglia të të tregoj se udhëtuam mirë. Këtë herë nuk pata shumë frikë në aeroplan. Në Hithrou arritëm rreth orës tre pasdite. Prej aty shkuam në banesën e Norës me metro. Është interesant t'i shohësh anglezët në metro. Pothuaj askush nuk bisedon me askë. Dikush lexon gazetën, dikush ndonjë libër, e ndonjë tjeter kotoj në gjumë. Nëse ndodh t'u takohen shikimet dy vetave, njëri bëhet sikur shikon diçka tjeter. Nëse rastësish një grup duke biseduar më me zë, mund ta dish se janë të huaj.

Njerëzit duken të sjellshëm. Nuk krijojnë tollovi. Presin në rend pér çdo gjë dhe gjithçka funksionon si duhet. Zaten, të gjitha këto janë të nevojshme pér një qytet kaq të madh, më se dhjetë milionësh, çfarë është Londra.

Sot vendosém me Norën të mos dalim por të pushojmë. Praktikisht ende nuk kam parë asgjë në Londër por kemi planifikuar që prej nesër t'i fillojmë vizitat. Takova disa shokë e shoqe të Norës. Ata u morën vesh të më shoqërojnë nga një ditë.

Kam një lajm shumë të mirë pér ty. Një shoqe e Norës është e interesuar pér letërsinë dhe folklorin shqiptar. Ajo dëshiron të vijë në Kosovë. Më tha se nëse kam ndonjë shoqe që do ta pranonte pér disa javë, ajo do ta ftonte pér vizitë në Angli. Menjëherë më shkoi mendja te ti. Do të të telefonoj pas një javë dhe do të më tregosh çka mendon pér këtë.

Nuk po të shkruaj më tepër këtë herë, por pasi t'i filloj vizitat

do të të dërgoj nga një kartolinë nga secila vizitë. Shpresoj se vitin e ardhshëm edhe ti do ta vizitosh Anglinë.

Të fala shokëve e shoqeve.

më 28. 9. 1987  
Londër

Përvendetje të përzemërtë,  
Drita

#### Vocabulary

frikë, -a	fear
kam frikë	(am) afraid
metro, -ja	underground
kotem	doze
shikim, -i, -e	glance ( <i>fem. in pl.</i> )
sikur	as if
bëhem sikur	pretend
me zë	loudly
i/e huaj	foreign
tollovi, -a, -	crowd
rend, -i, -e	queue ( <i>fem. in pl.</i> )
funksionoj	function
zaten	as a matter of fact, actually
nevojshëm (i)	necessary
më se	more than
vendos	decide
praktikisht	practically
planifikoj	plan ( <i>v.</i> )
merrem vesh	agree
shoqëroj	accompany
lajm, -i, -e	news ( <i>fem. in pl.</i> )
i/e interesuar	interested
folklor, -i	folklore
pranoj	accept, receive
secili, secila	each
të fala	regards
përvendetje, -a, -	greeting
i/e përzemërt	cordial, heartfelt

#### IV/ EXERCISES

(1) Answer the following questions on the reading passage:

- 1 Kujt i shkruan Drita?
- 2 Ç'i tregon në letër?
- 3 A ka pasur frikë Drita këtë herë në aeroplan?
- 4 Kur kanë arritur në Hithrou?
- 5 Si kanë shkuar në banesën e Norës?
- 6 Çka kanë vendosur të bëjnë sot?
- 7 Kë ka takuar Drita?
- 8 Ç'lajm ka ajo për Blertën?
- 9 Çka i intereson shoqes së re nga Anglia?
- 10 Kur do t'i telefonojë Drita Blertës?

(2) Change the following sentences as in the example:

Example: Ky është libri im.  
Ky libër është imi.

- 1 Kjo është shtëpia ime.
- 2 Këta janë librat e mi.
- 3 Ato janë shoqet e mia.
- 4 Këta janë nxënësit e mi.
- 5 Ky është mësuesi ynë.
- 6 Kjo është mësuesja jonë.
- 7 Këta janë shokët tanë.
- 8 Ato janë shoqet tona.

(3) Do as above:

- 1 Ky është lapsi yt.
- 2 Kjo është fletorja jote.
- 3 Këta janë lapsat e tu.
- 4 Këto janë fletoret e tua.
- 5 Kjo është dhoma juaj.
- 6 Ky është hoteli juaj.
- 7 Ato janë fotografitë tua.
- 8 Këta janë shtretërit tua.

## (4) Do as above:

- 1 Ky është lapsi i saj.
- 2 Kjo është letra e tij.
- 3 Ky është kopshti i tyre.
- 4 Këto janë planet e tij.
- 5 Ato janë shakatë e saj.
- 6 Ato janë lulet e saj.
- 7 Ky është dyqani i tij.
- 8 Këto janë fjalët e saj.

## (5) Complete the following sentences with the appropriate form of the possessive:

*Example:* Unë po shkoj në shtëpinë time, ti shko në  
 .....  
 Unë po shkoj në shtëpinë time, ti shko në tënden.

- 1 Unë do t'i shkruaj shokut tim, ti do t'i shkruash  
 .....  
 2 Unë do t'i telefonoj motrës sime, ti do t'i telefonosh  
 .....  
 3 Unë mora letër prej prindërve të mi, ajo mori prej  
 .....  
 4 Unë e hap dritaren e dhomës sime, ti e hap  
 .....  
 5 Ajo mëson në dhomën e saj, ai në .....  
 6 Unë bisedoj me papagallin tim, ju bisedoni me  
 .....  
 7 Papagalli im flet pesë gjuhë, (*theirs*) ..... vetëm një.  
 8 Qeni im vrapon shpejt, (*hers*) ..... edhe më  
 shpejt.  
 9 Oborri (*yard*) i shtëpisë sime është i madh, (*of yours pl.*)  
 ..... i vogël.  
 10 Librat tuaj janë mbi tavolinë, (*ours*) ..... në  
 raft (*shelf*).  
 11 Shkolla jonë është afër, (*theirs*) ..... është  
 larg.  
 12 Dhomë jote është e bukur, (*mine*) ..... nuk  
 është.

(6) Replace *i/e* *vet* with the appropriate possessive:

*Example:* Ajo e mori librin e vet.  
 Ajo e mori librin e saj.

- 1 Ajo e ka pjekur papagallin e vet.
- 2 Ata shkuan në shtëpinë e vet.
- 3 Ata pushojnë pranë kopshtit të vet.
- 4 Ajo e ka dhomën e vet.
- 5 Ai pushon në shtratin e vet.
- 6 Qeni është ulur në karrigen e vet.
- 7 Macja po e ha ushqimin e vet.
- 8 Ato i lexojnë librat e vet.
- 9 Ata nuk banojnë në shtëpinë e vet.
- 10 Nora lodhet nga punët e veta.

(7) Translate into Albanian using *vetë* or *vetja* as appropriate. The vocabulary needed follows the exercise:

- 1 The bird itself didn't really speak five languages.
- 2 Richard ate five trout by himself.
- 3 I, for myself, never gamble.
- 4 We built the house ourselves.
- 5 There is much beauty in the mountains themselves.
- 6 He had forgotten that he was a boy himself once.
- 7 She loved him, himself, not his money.
- 8 The truth itself is very powerful.
- 9 Why don't you do it yourself? !
- 10 They bought the car for themselves.
- 11 He likes himself, but not others.
- 12 He flies with skis like a bird itself.

trout	troftë, -a, -a
gamble	luaj bixhoz
beauty	bukuri, -a
powerful	i fuqishëm, e fuqishme
ski (n.)	ski, -a, -

# Unit Eighteen

## ■ I/ SITUATIONS

Nuk di a më tha gruaja ta pi një e të kthehem në tetë, apo t'i pi tetë e të kthehem në një.

pazar, -i, -e	market ( <i>fem. in pl.</i> )
artikull, -i,	article
artikuj	
ushqimor-e	food ( <i>adj.</i> )
zemërohem	get angry
mishshitës, -i, -	butcher
viç, -i, -a	calf
mish viçi	veal
kështu që	so, so that
lopë, -a, -	cow
mish lope	beef
bukë, -a	bread
bukëpjekës, -i, -	baker
miell, -i, -ra	flour
gatuaj	make bread/a pie

Luani çdo të martë shkon në pazar. Ai shkoi në pazar të martën e kaluar. Sa herë shkon në pazar, ai zakonisht e pi nga një gotë para se ta bëjë blerjen. Të martën e kaluar piu katër-pesë gata. Pas kafenesë bleu artikujt ushqimorë dhe gjërat e tjera të nevojshme për të cilat e kishte porositur gruaja. Ai zakonisht kthehet në shtëpi më këmbë, por të martën u kthye me taksi. Gruaja e tij u zemërua shumë.

G: Luan, a je ti?

L: Po, e dashur. U ktheva nga pazari.

G: Me taksi u ktheve?

L: Po, e dashur. Shportat ishin shumë të rënda.

G: A bleve krejt çka të thashë?

L: Po, e dashur. I bleva të gjitha . . . Pothuaj të gjitha.

G: Pothuaj të gjitha?!

L: Po, e dashur. Shkova te mishshitësi, por nuk kishte mish viçi.

G: Nuk kishte mish viçi?

L: Jo, e dashur, kështu që bleva mish lope.

G: A shkove te bukëpjekësi?

L: Po, e dashur, por nuk kishte bukë.

G: Nuk kishte bukë?

L: Jo, e dashur, por bleva miell. Buka e shtëpisë është më e mirë.

G: Do të ishte edhe më e mirë po ta gatuaje ti.

L: Po, e dashur, por ti e di që nuk di të gatuaj.

G: Nuk di?!

L: Jo, e dashur.

G: Luan!

L: Urdhëro, e dashur.

G: Mos shkove në kafene?

L: Po, e dashur.

G: Sa gata i çove këtë herë?

L: Vetëm katër ose pesë, e dashur, . . . të vogla.

mbishkrim, -i, -e     inscription (*fem. in pl.*)

varr, -i, -e     grave (*fem. in pl.*)

fjalaman, -i, -ë     chatterbox

hesht     be silent

Mbishkrim varri:

Këtu pushon fjalamani që për herë të parë hesht

(Inscription on a grave: *Here rests the chatterbox who for the first time is silent.*)

## II/ GRAMMATICAL PATTERNS

### More on Pronouns

#### Demonstrative pronouns:

The following pronouns are included in this group:

(a) ai, ajo, ata, ato, ky, kjo, këta, këto

(b) i/e tillë, i/e këtillë, i/e atillë

(c) asi, aso (asisoj, asilloj), kësi, këso, (kësisoj, kësilloj)

Pronouns under (a) correspond to the English demonstratives *that*,

*those, this, these.* Notice that these have different forms in Albanian for gender, number and case. They can be used with nouns, or on their own without any change.

Pronouns under (b) correspond to English demonstratives *such, like this, like that*. When they are used with nouns, they behave like adjectives; when they are used on their own, they take endings and decline like nouns.

Pronouns under (c) are basically Ablatives of *ai, ajo, ky, kjo*. The noun they refer to is in the Ablative case. Their meaning in English can be paraphrased as *of that kind, of this kind*. They are often interchangeable with the pronouns in (b). Here are some examples:

Mua më pëlqen një fustan i këtillë./Mua më pëlqen një kësi fustani. I like a dress like this one/such a dress.

Një ditë e këtillë është e paharrueshme. Such a day/a day like this is unforgettable.

Mos paç punë me njeri të tillë. May you never have anything to do with such a man.

Të atillë janë shokët e mirë. Good friends are like that.

Pak kemi ditë të këtilla në Angli. Days like this are few in England.

I tilli të lë në rrugë. The one like that will let you down.

Mos u shoqëro me asi djemsh. Don't socialize with such boys.

Herën tjetër do të blej këso lulesh. Next time I'll buy flowers like this.

The table of the declension of demonstratives in (a) is given in Unit Six. Here is the table of the declension of one of the demonstratives in (b). (The declension of other demonstratives of this group is easy to form by way of analogy.)

CASE	singular		plural	
	masc.	fem.	masc.	fem.
Nom.	i tilli	e tilli	të tillët	të tillat
Acc.	të tillin	të tillën	të tillët	të tillat
Gen./Dat./Abl.	të tillit	të tillës	të tillëve	të tillave

(Notice that the Genitive article has been omitted.)

### Interrogative pronouns:

Another group, most of which you have already met, is of interrogative pronouns. They will be briefly recapitulated here.

Kush (*who*) is used for nouns denoting human beings (see its case forms in Unit Four)

Cili (*masc.*), cila (*fem.*) (*which, who*) are used with nouns of any kind. The first declines like a masculine noun, the second like a feminine noun. Cilët is the plural form for masculine, cilat for feminine.

Ç', çka, çfarë (*what*) are all indeclinable. Çka is more colloquial.

Se (*what*) is another interrogative which cannot be used on its own. It is always preceded by a preposition:

me se	with what
pe'r se	what for
prej se	what of/from
mbi se	on what

Sa (*how many, how much*) has been used from the very beginning. Here are some more examples:

Sa veta janë aty? How many persons are there?

Sa nxënës jeni në klasë? How many pupils are you in your class?

Sa kushtojnë vezët e thyera? How much are the broken eggs?

Save u the të vijnë? How many did you tell to come? (lit. To how many. . . . ?)

Sa is the Nominative and Accusative form, whereas save is the Dative and Ablative form. Notice also the following forms:

i sati (*masc. sing.*) – which one (*in numerical order*)

e sata (*fem. sing.*)

të satët (*masc. pl.*)

të satat (*fem. pl.*)

Here are some examples using these forms:

I sati doli Marku në vrapi? Where did Mark come in the race?

Për të satën herë je këtu? Which visit (*number*) is this for you here?

The masculine forms decline like masculine nouns, the feminine like feminine noun.

#### *Relative pronouns:*

The following are relative pronouns: **i cili/të cilët** (*which, who*) (*masc.*), **e cila/të cilat** (*which, who*) (*fem.*), **që** (*that*). The first two decline as nouns. **Që** does not decline. Here are a couple of examples:

**Nora, e cila gjithnjë eshtë e lodhur, sot qenka plot energji.** Nora, who is always tired, today is full of energy!

**Londra është një qytet që nuk fle kurrë.** London is a town that never sleeps.

**Kush, ç', çka, and sa** can also be used as relatives. See this in the following examples:

**Le të vijë kush të dojë.** Let him/her-come, whoever wants.

**Shko me kë të duash.** Go with whomsoever you want.

**C'ishin vajza, nuk pinë fare.** Those that were girls, did not drink at all.

**Na dha krejt çka kishte.** He/she gave us all he/she had.

**Sa lindin, aq do të vdesin.** As many as were born, that many will die.

#### *Pronouns expressing amount:*

Some pronouns express the total number or amount of something. Such are: **mbarë, gjithë, tërë, e.g.:**

**Mbarë klasa shkoi në kinema.** The whole class went to the cinema.

**Shiu nuk pushoi gjithë natën.** The rain did not stop all night.

(*i/e*) **gjithë, (i/e) tërë** can be used on their own as **i gjithi, e gjitha, i téri, e téra.** The last two forms decline as nouns do.

The following pronouns express distribution:

<b>çdo</b>	every
<b>çdonjëri</b>	everyone
<b>secili</b>	each
<b>seçila</b>	each
<b>cilido</b>	whoever, whichever ( <i>masc.</i> )
<b>cilado</b>	whoever, whichever ( <i>fem.</i> )
<b>kushdo</b>	whoever; whichever
<b>gjithkush</b>	everybody

They are all used like their counterparts in English. All except **çdo** decline.

#### *Indefinite pronouns:*

Here is a list of indefinite pronouns:

<b>kush</b>	somebody/anybody
<b>dikush</b>	somebody/anybody
<b>ndokush</b>	somebody/anybody
<b>njeri</b>	somebody/anybody
<b>shumëkush</b>	many (a person)
<b>shumëcka</b>	many things
<b>një</b>	one
<b>njëri</b>	one
<b>ndonjë</b>	some
<b>ndonjëri</b>	some
<b>diçka</b>	something
<b>gjësend</b>	something
<b>gjëkafshë</b>	something
<b>Mos ju pa kush?</b>	Did anybody see you?
<b>Le të shkojë dikush.</b>	Let somebody go.
<b>A pe njëri?</b>	Did you see anybody?

From the list above, those that have **kush** as a constituent part are declinable, and also **njëri** and **ndonjëri**.

#### *Alternative pronouns:*

**Tjetër (other, else)** and **tjetërkush (somebody else)** are called alternative pronouns. The latter is declinable, e.g.:

**Kështu mund ta mashtrosh tjetërkë.** You may cheat someone else like this (not me).

Notice that **dikush** can also mean 'some people' as in the expression:

**Dikush e do, dikush jo.** Some people like it, some don't.

#### *Pronouns of quality and quantity:*

Some pronouns express quality. Such are:

<b>njëfarë</b>	some
<b>çfarëdo</b>	of whatever kind
<b>çolloj</b>	of any kind
<b>gjithfarë</b>	of all kinds
<b>lloj-lloj</b>	of different kinds

The following pronouns express quantity:

disa	some
ca	some
pak	a few, few
shumë	much, many
mjaft	enough
plot	a lot, full
aq/kaq	that/this much

Only disa is declinable.

#### Negative pronouns:

Here is one final list of pronouns, so-called negative pronouns which you may find interesting in terms of their formation. Their constituent parts should be known to you by now:

**askush, kurkush, askurkush, asnjeri, etc. (nobody)**  
**asgjë, kurrgjë, askurrgjë, hiçasgjë, hiçgjëfare, asgjëkafshë,**  
**asgjësend etc. (nothing)**  
**asnje, asndonjë (none, no-one)**  
**asnjeri (masc.), asnjerë (fem.) (nobody)**  
**kurrfarë, asnjetfarë (+ noun in the Ablative) (nothing (of any kind))**

### III/ READING PASSAGE

#### SHËTITJA E PARË E DRITËS NËPËR LONDËR

Dje Liza ishte e lirë, nuk kishte ligjérata, prandaj kishte vendosur ta shoqëronte Dritën. Sipas planit që kishin bërë bashkë me Norën, Drita duhej të bënte një shëtitje nëpër Londër. Në mëngjes, Drita shkoi me Norën te shkolla e saj ku u takua me Lizën. Meqë ishte ende herët, ato së pari pinë nga një kafe e pastaj ecën deri në Trafalgar Skuer.

Shëtitën pak nëpër shesh dhe e shkuan përmendoren e Admira-lit Nelson. Drita bleu ca ushqim për zogj dhe derisa ajo ushqente pëllumbat që ishin mësuar me vizitorë dhe ishin krejt të butë, Liza e fotografoi disa herë. Drita ndjente kënaqësi të veçantë duke ushqyer pëllumbat të cilët i rrinin në duar, në supe e madje edhe në kokë.

Pas pak ia bëhu autobusi i veçantë për turne të organizuara nëpër Londër. Autobusi ishte dy-katesh dhe kati i epërm ishte i hapur. Fatmirësish tita ishte e bukur dhe ato u ngjitën në katin

e sipërm dhe zunë dy vende të mira. Në autobus kishte edhe turistë të tjerë. Turneja do të zgjaste tërë ditën.

Autobusi u nis. Kaluan pranë Galerisë Kombëtare dhe vazhduan për te Pallati i Bakingëmit ku është rezidencia e Mbretëreshës. Pastaj i vizituan Shtëpitë e Parlamentit, sahatkullën me famë botërore, Big Ben, dhe manastirin Uestminster Ebi që gjendet aty afër. Prej aty vazhduan nëpër Uajt-holl dhe shkuan në Daunting Stritë. Aty e shkuan ceremoninalin e këmbimit të rojeve.

Pasdreke ishte paraparë një vizitë e shkurtër në Muzeun Britanik. Drita e Liza nuk hynë në muze sepse kishin planifikuar që aty të kalonin më shumë kohë një ditë tjetër. Derisa të tjerët e vizituan Muzeun, Drita e Liza pushuan në Rasel Skuer.

Pas tre çerek ore u kthyen te Muzeu dhe bashkë me të tjerët u nisën për te Katedrala e Shën Palit. Kaluan nëpër Flitë Stritë, dikur qendër e shtypit britanik. Prej Katedralës së Shën Palit shkuan në qendër të qytetit ku bëhet veprimtaria kryesore ekonomike e Londrës. Aty është edhe Banka e Anglisë. Në fund vizituan Kullën e Londrës dhe urën përbri.

Kudo që shkuan, Drita bëri shumë fotografji, bleu ndonjë kartolinë për t'u dërguar shokëve a shoqeve, apo ndonjë suvenir për ta ruajtur si kujtim nga vizita.

#### Vocabulary

ligjératë, -a, -a	lecture
shoqëroj	accompany
sipas	according to
shesh, -i, -e	square
përmendore, -ja, -	monument
zogj	(pl. of zog) birds
pëllumb, -i, -a	pigeon, dove
i/e butë	tame, mild
i/e veçantë	special
sup, -i, -e	shoulder (fem. in pl.)
madje	even
turne, -ja, -	tour
i/e organizuar	organized
dy-katesh	double-decker, two-storied
i epërm, e epërme	upper
ngjitem	climb (non-act.)
i sipërm, e sipërme	upper

zgjat	last
rezidencë, -a, -a	residence
mbretëreshë, -a, -a	queen
sahatkullë, -a, -a	clock tower
me famë botërore	world famous
ceremonial, -i, -e	ceremony ( <i>fem. in pl.</i> )
këmbim, -i, -e	change ( <i>fem. in pl.</i> )
roje, -a, -	guard
pasdreke, -a, -a	afternoon
parashoh	plan, anticipate, foresee
shkurtër	short
qendër	centre
shtyp, -i	press, newspapers
britanik, -u, -ë	Briton
katedralë, -a, -a	cathedral
veprimtari, -a, -	activity
ekonomik-e	economic
kullë, -a, -a	tower
urë, -a, -a	bridge
a	or
suvenir, -i, -e	souvenir ( <i>fem. in pl.</i> )
ruaj	keep, retain

#### IV/ EXERCISES

(1) Answer the following questions on the reading passage:

- 1 Çka bëri Drita dje?
- 2 A kishte Liza ligjérata apo ishte e lirë?
- 3 Çka kishte vendosur të bënte ajo meqë ishte e lirë?
- 4 Ku u takuan Liza e Drita?
- 5 Çka bënë ato së pari?
- 6 Ku shkuan pastaj?
- 7 Si shkuan deri në Trafalgar Skuer?
- 8 Çka bënë atje?
- 9 Çka bënte Drita derisa e fotografonte Liza?
- 10 Si e vazhduan shëtitjen nëpër Londër pastaj?

- 11 Çfarë ishte autobusi?
- 12 Çka vizituan?
- 13 Pse nuk hynë Drita e Liza në Muzeun Britanik?
- 14 Çka bëri Drita kudo që shkuan?
- 15 Ç'bleu ajo?

(2) Give short answers to the following questions as in the example. Use **ky/kjo** and then **ai/ajo** in the appropriate case.  
*Example:* Cila është shoqja jote?

Kjo.                    Ajo.

- 1 Cilën shoqe e takove?
- 2 Cilës ia dhe librin?
- 3 Me cilin shkove në kinema?
- 4 I cilit është kjo fotoaparat?
- 5 E cilës është kjo fotografi?
- 6 Cilat i ftovë?
- 7 Cilët i takove në stacion?
- 8 Prej cilës e more këtë laps?
- 9 Cilëve u dhe libra?
- 10 Cilave u dërgove lule?

(3) Use **asi, aso, kësi, këso** instead of **i/e tillë/atillë/këtillë** in the following sentences:

*Example:* Edhe unë kam një fotoaparat **të tillë**.  
                           Edhe unë kam një **asi** fotoaparati.

- 1 Ai bleu ca mollë **të këtilla**.
- 2 Do ta blija një radioaparat **të tillë**.
- 3 Do **të dëshiroja** të kem një shok **të tillë**.
- 4 Ai gjithnjë **është** marrë me punë **të këtilla**.
- 5 Kurrë s'kisha parë një shpellë **të tillë**.
- 6 Nuk kemi shumë ditë **të këtilla** të bukura në Angli.
- 7 Edhe **ai** ka pasur momente **të tilla** të vështira.
- 8 Kurrë më parë s'kam qenë në një qytet **të këtillë** kaq **të madh**.
- 9 Nuk dëshiroj **të dëgjoj** këngë **të atilla**.

- (4) Translate the following sentences using i cili, e cila in the appropriate case:

- 1 I read the book which you gave me last week.
- 2 The film you told me about (*transl.* 'for which') was very good.
- 3 My old teacher, from whom I learnt so much, died last week.
- 4 They say that teachers who are good get old but never die.
- 5 The writer (*fem.*) whose book I read is very good.
- 6 The tale which Merita's grandfather told us was very good.
- 7 The (female) friends whom I told to come aren't here.
- 8 The girl whose mother went to Spain didn't have time to come.
- 9 The photos which we took (*made*) in Deçan were very good.
- 10 Those (*fem.*) to whom I am writing this letter are in England.

- (5) Translate the following sentences into English:

- 1 Ai na tregoi gjithfarë ngjarjesh.
- 2 Shkuam atje, por s'kishte njeri.
- 3 Paske qenë me tjetërkë në këtë restorant.
- 4 U zemërua për asgjësend.
- 5 Kushdo që vjen këtu kalon mirë.
- 6 Në cilindo vend që shkova bëra shumë shokë.
- 7 Të arriturat duhet t'i shërbejnë (*serve*) gjithë njerëzimit (*humanity*).
- 8 Në dyqan kishte lloj-lloj artikuujsh ushqimore.
- 9 Njerëzit e mbarë botës duhet ta duan njëri-tjetrin.
- 10 Çdo gjë që shkëlqen (*shinje*) nuk është ar.
- 11 Çdo shok i mirë njihet në ditë të vështirë.
- 12 Mos më trego kush je, por me kë shoqërohesh!
- 13 Dy herë mendo, një herë fol.
- 14 Të gjitha shtazët (*animals*) janë të barabarta (*equal*).

## Unit Nineteen

### ■ I/ SITUATIONS

numër, -i, -a	number
elefant, -i, -ë	elephant
jugor-e	southern
mijë, -a, -ra	thousands
sish	of them
zvogëloj	decrease
për shkak të	because of
gjuetar, -i, -ë	hunter
prishje, -a, -	spoiling
balancë, -a	balance
aktivitet, -i, -e	activity
i/e pamenduar	thoughtless
shpresë, -a, -a	hope
Azi, -a	Asia
zbatoj	implement
program, -i, -e	programme
trevjeçar,	three-year
trivjeçare	
fond, -i, -e	fund
botëror	world(-wide)
mbrojtje, -a, -	defence
shtazë, -a, -	animal
rrezik, -u, rreziqe	danger
ekzistencë	existence
mashkull, -i,	male
meshkuj	
regjistrim, -i, -e	registration
tufë, -a, -a	herd
mënyrë, -a, -a	way, manner

**jetesë, -a** living  
**pengoj** prevent

Numri i elefantëve në Indinë Jugore, ku tash jetojnë treth katër mijë sish, po zvogëlohet shpejt për shkak të gjuetarëve dhe pri shjes së balancës natyrore me aktivitetin e pamenduar të njeriut. Një shpresë për këtë grup më të madh elefantësh në Azi është zbatimi i suksesshëm i programit trevjeçar nën kujdesin e Fondit Botëror për Mbrojtjen e Shtazëve. Rreziku më i madh për ekzistencën e elefantëve janë gjuetarët të cilët çdo vit vrasin prej njëqind deri në njëqind e pesëdhjetë elefantë të rindj meshkuj. Programi i mbrojtjes parasqeh regjistrimin e tufave të elefantëve, studimin e mënyrës së tyre të jetesës dhe pengimin e aktivitetit të gjuetarëve.

**pëshpërit** whisper  
**ndihmës, -i, -** assistant, helper (*masc.*)  
**ndihmëse, -ja, -** assistant (*fem.*)  
**bibliotekë, -a, -a** library  
**plaçkitës, -i, -** robber

'Profesor,' pëshpëriti ndihmësja e shtëpisë, 'në bibliotekë ka hyrë një plaçkitës.'

'Ashtu? E çka po lexon?'

## II/ GRAMMATICAL PATTERNS

### Prepositions

The main thing to remember about prepositions in Albanian is the case they select for the noun following them, which can be Nominative, Accusative or Ablative. The easiest way to do this is to learn first the prepositions that select their nouns in the Nominative and Accusative because these are fewer in number. Only two prepositions select the Nominative, fifteen the Accusative, and all the rest, over ninety of them, select the Ablative. The meaning of prepositions is best learnt in the context of their usage. The most characteristic meanings are given in the list below. You may find the list rather long, but it will be useful for reference purposes.

### Prepositions which take nominative nouns:

**nga** – from  
 Sapo erdha nga shkolla. I just came from school.

– towards  
 Ata u nisën nga lumi. They set out towards the river.

(The meaning 'from' or 'towards' of **nga** is revealed by the context.)

**te(k)** – at  
 Dje gjithë ditën ndenja te shtëpia. All day yesterday I stayed at home.

– to  
 Ai shkoi tek i ati. He went to his father's.

**Nga njëri te tjetri.** From one to the other.

(Notice that when the following noun begins with a vowel **tek** is used.)

### Prepositions which take accusative nouns:

**deri, gjer** – till, until  
 Rri deri nesër. Stay until tomorrow.  
 Nuk erdhi në shtëpi deri vonë. He/she didn't come home till late.

**mbi** – up to  
 Eja deri këtu. Come up to here.  
 E la librin mbi tryezë. He left the book on the table.

– on  
 Fluturoi mbi det. He/she flew over the sea.

**me** – with  
 Ai kërcceu dy metra mbi tokë. He jumped two metres above the ground.  
 Çdo mbrëmje dal me shokë. Every evening I go out with friends.

– by  
 E hapi derën me çelës. He/she opened the door with the key.

**më** – on  
 Rrafshi është i rrëthuar me male të larta. The plain is surrounded by high mountains.

**ndaj** – near  
 Më 10 tetor Marku shkon në Prishtinë. On the 10th of October Mark goes to Prishtina.

**Ndaj të gdhirë.** Near the dawn (towards dawn).

në	- in - on  - to	Ai jeton në fshat. He lives in a village. I dëgjova lajmet në radio. I listened to the news on the radio. E nxori në dritë. He/she brought it/him/her to light.
nën	- under	Macja është nën tryezë. The cat is under the table.
nëpër	- through	Ata shëtitën nëpër pyll. They walked through the forest.
pa	- without	Mbeta pa gjumë gjithë natën. I remained without sleep all night.
për	- for  - about	Kjo dhuratë është për ty. This present is for you. Ato biseduan për pushimet. They talked about the holidays.
përmbi	- above, on	Zogu më fluturoi përmbi kokë. The bird flew above my head. E la lapsin përmbi libër. She left the pencil on the book.
që, qysh	- since	Nuk kam ngrënë që dje. I haven't eaten since yesterday.

(Notice that after the prepositions **në**, **mbi**, **me**, **përmbi**, the noun, although formally indefinite, in terms of meaning is definite. The definite form of the noun is used when it is qualified in some way, e.g. **në shtëpi** but **në shtëpinë** time, **mbi tryezë**, but **mbi tryezën e madhe etc.**)

#### Prepositions which take ablative nouns:

afér (near)	midis (between)
anekënd (all through, anywhere)	ndaj (towards)
anembanë (everywhere)	ndërmjet (among)
anës (along)	nëpërmes (through, by)
ballë (facing, opposite)	para (in front of)
brenda (inside)	për (by)
bri (beside)	përpjetë (upwards)
buzë (by, close to)	pos/veç (except)
drejt (towards, straight to)	poshtë (down)
gjatë (during)	pranë (by)
jashtë (out of)	prapa (behind)
	prej (from)

krahas (alongside with)
kundër (against)
larg (far from, away from)
lart (up)
matanë (across, on the other side)
mbas/pas (after, behind)
menjamë (aside)
mes (between, among)

përballë (opposite)
përbri (beside)
përfund (underneath)
përgatë (along)
përkrah (alongside with)
përkundër (besides)
përmbas (behind)

rreth/qark (round)
rrëzë (at the foot of)
sipas (according to)
sipër (above)
tatëpjetë (downwards)
tej (away, further)
tëposhtë (downwards)
tutje (further)

përmes/mjet (by means of)
përpara (before, in front of)
përpos/përveç (except)
përqark (around)
përreth (around)
përsipër (over, above, on)
përetej (over)

#### Phrasal prepositions:

In addition to the prepositions listed above, there are also so-called complex or phrasal prepositions. They mainly select the Accusative, Genitive or Ablative. Here are some of the more usual ones:

me anë + gen./abl.:	by means of friends
me anë të shokëve	by means of courses
me anë kursesh	
me anën + gen.:	
me anën e një shoku	by means of a friend
në bashkëpunim me + acc.	in cooperation with
në krahasim me + acc.	in comparison with
në të mirë + gen.	in favour of
në lidhje me + acc.	in connection with
për hir + gen.	for the sake of
për pasojë + gen.	as a consequence of
për shkak + gen.	because of
për në + acc.:	
për në Londër	to London
për nga + nom.:	
për nga madhësia	as far as the size is concerned

## III/ READING PASSAGE

**PËR ÇUDI EDHE SOT MOTI ËSHTË I BUKUR**

Drita është adhuruese e madhe e fotografisë. Ngado që shkon ajo e merr fotoaparatin me vete dhe bën fotografë. Daja i saj është fotograf. Ai ka dyqan të vetin. Drita i bën fotografitë te daja i vet. Ajo vetë i zhvillon filmat. Shpesh u bën fotografi edhe shoqeve e shokëve të saj.

Pos fotografisë, Drita ka edhe një dashuri tjeter të madhe. Ajo i do shumë shtazët. Ditën e sotme e priti me padurim sepse kishin planifikuar që me Norën dhe me disa shokë e shoqe të tjera ta viziton kopshtin zoologjik në Rixhents Park.

Të gjithë kaluan mirë. Për çudi, edhe sot moti ishte i bukur. Drita madje i pyeti disa se pse i kishin thënë se moti në Angli asnjëherë nuk është i mirë. I thanë se kjo ishte verë indiane. Moti i mirë e bëri edhe më të përshtatshëm fotografimin. Drita fotografoi shumë shtazë, duke filluar nga majmunët, arinjtë kontinentale dhe polarë, gjirafat, fokat, zebrat, drerët e sorkadhet, luanët e tigrat, dhelprat e ujqit, e deri te zogjtë me pupla të bukura.

Pasi që e vizituan kopshtin zoologjik, të gjithë bashkë shkuan në teatrin e hapur që gjendet aty pranë dhe që shfaq pjesë teatrale vetëm nga Shekspiri. Sot shfaqej drama e Shekspirit »Mbreti Lir«. Drita, edhe pse nuk e njeh anglishten mirë, nuk pati shumë vështirësi ta përcillte shfaqjen sepse ajo e kishte lexuar këtë dramë para disa vjetësh. Shumica e dramave të Shekspirit, si edhe në shumë gjuhë të tjera, janë të përkthyera edhe në shqip. Ato i përktheu një intelektual i shquar shqiptar i quajtur Fan Noli. Mendohet se përkthimet e tij janë të një niveli shumë të lartë.

As studentët anglezë nuk e përcollën shfaqjen më me lehtësi sepse gjuha e Shekspirit ndryshon bukur shumë nga gjuha e sotme angleze.

Pasi që e shikuani pjesën teatrale ata dolën përsëri në park ku u ulën dhe i hengrën senduiçat që kishin marrë me vete. Rreth orës katër u nisën për të banesë. Nora dëshiron te pushonte pak sepse në orën gjashtë ishin marrë vesh të takoheshin me Markun në një pub. Marku sot nuk mundi ta shoqëronte Dritën sepse iu desh të siguronte biletë aeroplani për Prishtinë.

*Vocabulary*

çudi, -a, -ra	astonishment, wonder
për çudi	strangely
fotoaparat, -i, -e	camera
dajë, -a, -	uncle ( <i>on the mother's side</i> )
fotograf, -i, -ë	photographer
zhvilloj	develop
film, -i, -a	film
kopsht zoologjik	zoo
fotografim, -i	taking photos
majmun, -i, -ë	monkey
ari, -u, -nj	bear
kontinental-e	continental
polar-e	polar
gjirafë, -a, -a	giraffe
fokë, -a, -a	seal
zebër, -a, -a	zebra
dre, -ri, -rë	stag
sorkadhe, -ja, -	doe
tigër, -i, -a	tiger
dhelpër, -a, -a	fox
pupiël, -a, -a	feather
shfaq	perform
pjesë teatrale	play
dramë, -a, -a	drama
vështirësi, -a, -	difficulty
shfaqje, -a, -	performance
i/e përkthyer	translated
përkthej	translate
intelektual, -i, -ë	intellectual
i/e shquar	distinguished
nivel, -i, -e	level ( <i>fem. in pl.</i> )
lehtësi, -a	ease
me lehtësi	easily
ndryshoj	differ
senduiç, -i, -a	sandwich
pub, -i, -e	pub ( <i>fem. in pl.</i> )
siguroj	secure, get
biletë aeroplani	air ticket

**IV/ EXERCISES**

(1) Answer the following questions on the reading passage:

- 1 Çka merr Drita me vete ngado që shkon?
- 2 Ku i bën Drita fotografitë?
- 3 Kujt i bën Drita fotografi ndonjëherë?
- 4 Ç'dashuri tjetër të madhe ka Drita?
- 5 Pse e ka pritur Drita ditën e sotme me padurim?
- 6 Pse çuditet (*is astonished*) Drita me motin e mirë?
- 7 Çka fotografoi Drita sot?
- 8 Ku shkuan pasi që e vizituan kopshtin zoologjik?
- 9 Ç'pjesë teatrale shikuani?
- 10 Ç'bënë ata pas pjesës teatrale?
- 11 Kur u nisën për në banesë?
- 12 Pse shkuan në banesë?
- 13 Më kë dhe ku ishin marrë vesh të takoheshin në orën gjashtë?
- 14 Pse Marku nuk mundi ta shoqëronte Dritën sot?

(2) Put the nouns in brackets into the correct case:

- 1 Drita e Nora shkuan në ..... (Muzeu).
- 2 Drita e Nora shkuan në ..... (Muzeu Britanik).
- 3 Afér ..... (banesa e Norës) është një restorant i mirë.
- 4 Pushimi buzë ..... (lumi) është i këndshëm.
- 5 Sot Nora fluturon nga ..... (gëzimi joy).
- 6 Fshati i Meritës gjendet rrëzë ..... (bjeshkët).
- 7 Prishtina sot luan kundër ..... (Partizani).
- 8 Petriti e Agroni jetojnë larg ..... (ne).
- 9 Rri pranë ..... (unë)!
- 10 Shko në kinema me ..... (Marku)!
- 11 Matanë ..... (rruga) gjendet një dyqan pemësh e perimesh.
- 12 Beti, krahas ..... (studimet *studies*), punon në ..... (një bibliotekë).
- 13 Do të të pres para ..... (ndërtesa).

- 14 Midis ..... (ju), gjendet një këngëtar (*singer*) i mirë.
- 15 Prej ..... (shtëpia ime) e deri në ..... (shkolla) shkoj për dhjetë minuta me ..... (autobusi).

(3) Do the same as above:

- 1 Në krasim me ..... (viti i kaluar) këtë vit moti është më i mirë.
- 2 Për shkak ..... (tollovia e madhe) nuk munda të hipi në autobus.
- 3 Për pasojë ..... (kjo) arrita vonë në punë.
- 4 Rezultati i ndeshjes ishte 3: 1 në të mirë ..... (Prishtina).
- 5 Për hir ..... (shoqja) nuk shkoi as ajo në kinema.

(4) Translate the following into English. The vocabulary needed follows the exercise:

Në këtë vjeshtë futbollistët e Prishtinës po luajnë hove-hove. Pas barazimit me Hajdukun, në fillim, patën tri humbje radhazi, pastaj me fitoren kundër Sutjeskës (3: 0) luajtën mirë dhe realizuan katër fitore me radhë. Fitoret u ndërpitën me barazimin kundër Partizanit (0: 0).

U erdhi radha tri humbjeve në kampionat, tri humbjeve nëpër Çekoslovaki dhe një humbjeje në Zemun (para një javë). Dje mundën Buduçnostin e Titogradit (4: 0) dhe duket se paralajmëruan fitore të reja të cilat nuk mund të realizohen lehtë, nga se tash Prishtina, deri në fund të vjeshtës, vetëm një herë luan në fushën e vet, kurse ka tri udhëtime për pikë e një për kupë. Sidoqoftë, fitorja e djeshme jep shpresë.

futbollist, -i, -ë  
hove-hove  
barazim, -i, -e  
në fillim  
humbje, -a, -  
fitore, -ja, -

footballer  
inconsistently  
equalization; draw  
at the beginning  
defeat  
victory

me radhë	in a row
ndërpritem	(am) interrupted
kampionat, -i, -e	championship
mund	beat
paralajmëroj	forewarn
udhëtim, -i, -e	journey
kupë, -a, -a	cup
sidoqoftë	however
djeshme	of yesterday

- (5) Translate the following into Albanian. The vocabulary is given below:

Sport has always been a good thing for people, especially now when many people work inside in offices. Unfortunately, not everybody can swim in the sea or walk in the mountains, but there is a sports centre near everyone's home, or a park where they can walk or run. Unfortunately, sport has now become connected with big money, and problems always come together with money. Sport should bring health and friendship, not fighting and damage to people and society. It is time that the values of sport should again be the main characteristics of different games. People should go to matches for the pleasure of watching good games, and people should take up sport for the sake of sport, not just for winning and money.

connected with	lidhur me
problems	problemet
health	shëndet, -i
friendship	miqësi, -a
fighting	përleshje, -a, -
damage	dëm, -i, -e
society	shoqëri, -a, -
value	vlerë, -a, -a
characteristics	karakteristikë, -a, -a
winning	fitore, -ja, -

## Unit Twenty

### I/ SITUATIONS

helmues-e	poisonous
shkaktoj	cause
panik, -u	panic
kompani ajrore	airline company
shteg, -u, shtigje	path
udhëtar, -i, -ë	passenger
paraqitje, -a, -	appearance
pilot, -i, -ë	pilot
zgjat	last
kontrollim, -i, -e	check
zbulim, -i, -e	discovery
futem	get inside
stjuardesë, -a, -a	air hostess
paraqitem	appear
padëshiruar	unwelcome
kabinë, -a, -a	cabin

Një gjarpër helmues shkaktoi panik në aeroplanin e një kompanie ajrore të Indonezisë kur doli në shtegun midis karrigeve dhe u kaloi udhëtarëve nën këmbë. Menjëherë pas paraqitjes së gjarprit piloti e ktheu aeroplanin në aeroportin më të afërm. Që të pesëdhjetë udhëtarët u larguan nga aeroplani derisa zgjati kontrollimi për zbulimin e këtij gjarpri helmues të gjatë gjysmë metri. Mendohet se gjarprin në aeroplan e futi stjuardesa me një tufë lulesh. Kjo nuk ishte hera e parë të paraqitej në këtë aeroplan një udhëtar i këtillë i padëshiruar. Në muajin nëntor të vitit të kaluar piloti kishte gjetur në kabinën e pilotëve një gjarpër helmues të gjatë një metër e gjysmë.

dhëmb, -i, -ë	tooth
artificial-e	artificial
natyral-e	natural

ashtu është	that's right
dhembje, -a, -	pain
ankohem	complain

A: Kur m'i vutë dhëmbët artificialë më thatë se do të më jenë si dhëmbë natyralë.

B: Ashtu është.

A: Por dhëmbët tuaj artificialë po më shkaktojnë dhembje shumë.

B: Pse po ankoheni atëherë? A s'ju thashë se do t'i keni si dhëmbë natyralë?

## II/ GRAMMATICAL PATTERNS

### Conjunctions

You already know by now some of the basic conjunctions which have been used in the previous units. Here a list of conjunctions will be given without any classification or further explanation. You may notice that some of them have already been mentioned in the list of pronouns and in the list of adverbs. Their translation (which sometimes is rather literal in order to help you understand them), as well as the examples given for the ones that have not already been used, may be helpful.

#### apo (or)

Do të vijsh me ne, apo do të shkosh me Markun e Petritin? Will you come with us, or will you go with Mark and Petrit?

#### andaj, ndaj, prandaj (therefore)

Dëgjova se ka ardhur Drita, ndaj (or andaj) erdha ta takoj. I heard that Drita had come, therefore I went to meet her.

#### (as) . . . as (neither . . . nor)

Nora dje ishte e sëmurë, as drekë nuk hëngri. Nora was ill yesterday, nor did she (or and did not) eat supper.  
Një agim të këtillë as e pikturn, as e përshkruan njeri. A dawn such as this, one can neither paint nor describe.

	that's right
	pain
	complain

#### çfarë ((such) that/as)

Në galeri shikoi pikturna çfarë s'kishte parë kurrë më parë. In the gallery she saw pictures such as she had never seen before.

#### daç . . . (daç), ose . . . ose, o . . . o (either . . . or)

Daç eja me ne në peshkim, daç shko me Merin në fshat. Either come fishing with us or go with Mary to the village.

Ose bëje punën si duhet, ose mos e nis fare. Either do the job as you should, or don't start it at all.

O merre për vete, o po e marr unë. (Either) take it for yourself, or (or otherwise) I will take it.

#### derisa, gjersa (while)

Derisa (or gjersa) unë lexoja, Nora e bëri një sy gjumë. While I was reading, Nora took forty winks.

Ata e ndiqnin me sy, derisa aeroplani zhdukej në kaltërsinë e qiellit. They followed it with their eyes, while the aeroplane disappeared into the blue of the sky.

#### duke qenë se (being that; since)

Duke qenë se ndihej i padëshiruar, shkoi më herët në shtëpi. Since he felt unwanted, he went home earlier.

#### dhe, edhe, e (and)

Zana i mori librat dhe u nis për shkollë. Zana took her books and left for school.

Ditët shkojnë e vijnë, ejeta i afrohet fundit. Days come and go, and life approaches its end.

#### edhe . . . edhe, hem . . . hem (both . . . and)

Edhe na ftoi në gasti, edhe nuk na pëershëndeti. He both invited us to the party and did not greet us.

Hem ka dëshirë të shpenzojë, hem të ketë shumë para. He both likes to spend, and to have a lot of money.

#### edhe në, edhe në qoftë se, edhe sikur (even if)

'Edhe në fjetsha, zemrën s'ma vë dot njeri në gjumë.' Even if I sleep, no-one will put my heart to sleep.

**Edhe në qoftë se vonohem pak, më prit se do të vij.** Even if I'm a little late, wait for me as I will come.

**Edhe sikur të isha i lirë, nuk do të shkoja me ta.** Even if I were free, I wouldn't go with them.

**edhe pse, megjithëqë, megjithëse, ndonëse, sado që (although)**

**Edhe pse i thashë të ma sillte librin, ai kishte harruar.** Although I told him to bring me the book, he had forgotten.

**Megjithëse ishte i zënë, i la punët e erdhi me ne.** Although he was busy, he left his work and came with us.

**Ndonëse i vetmuar, dashurinë tënde s'e harroj kurrë.** Although lonely, I will never forget your love.

**Sado që ia shpjegova disa herë, ai nuk e kuptoi mësimin.** Although I explained to him several times, he didn't understand the lesson.

**gjithsaherë, kurdoherë që, sa herë që (whenever)**

**Gjithsaherë kam shkuar tek ai, e kam gjetur të mërzitur.** Whenever I went to his place, I found him bored.

**Kurdoherë që kisha kohë, i vizitoja gjyshin e gjyshen.** Whenever I had time, I visited my grandparents.

**Eja tek unë kurdoherë që të ndihesh i vetmuar.** Come to me whenever you feel lonely.

**Sa herë që shpreson shumë, fiton më pak.** Whenever you hope a lot, you gain little.

**jo që . . . por (not that . . . but)**

**Jo që nuk pata dëshirë të shkoja, por qeshë i zënë.** Not that I did not want to go, but I was busy.

**jo vetëm që or le që . . . por (edhe/as) (not only . . . but (also/neither))**

**Jo vetëm që ma mori librin pa më pyetur, por edhe nuk ma ktheu kurrë.** Not only did she take my book without asking me, but also she never returned it to me.

**Le që s'erdi vëtë, por as të vëllanë s'e la të vinte.** Not only did he not come himself, neither did he (or he also did not) let his brother come.

**kështu që (so (that))**

**Më në fund erdhi edhe Marku, kështu që të gjithë ishin të lumtur.** In the end Mark came too, so everyone was happy.

**ku (where)**

**Ku ka tym, ka dhe zjarrë.** Where there's smoke, there's fire.

**kurse, ndërsa (whereas)**

**Unë i thosha, 'Ja ku është malfi', kurse ai më thoshte, 'Ja ku është lisi'.** He couldn't see the wood for the trees.

**kushedi (who knows)**

**I kam treguar kushedi sa herë si të punojë me fotoaparat, por ai ka harruar përsëri.** I have told him who knows how many times how to use the camera, but he has forgotten again.

**mbasi (që), pasi (që), meqenëqë, meqenëse, meqë (since)**

**Mbasi (që) s'pata kohë ta vizitoja në spital, i dërgova një tufë lulesh.** Since I didn't have time to visit him in hospital, I sent him a bunch of flowers.

**me kusht që (with or on the condition that)**

**Ia mora librin shokut, me kusht që t'ia kthej pas dy ditësh.** I took the book from my friend, on the condition that I returned it to him after two days.

**me qëllim që (in order to)**

**Sot u nis për në punë më herët me qëllim që të mos vonohet prapë.** Today I left for work earlier in order not to be late again.

**mirëpo (but, however)**

**I thashë të mos vepronte ashtu, mirëpo ai nuk më dëgjoi.** I told him not to act so, but he didn't listen to me.

**në, nëse, në qoftë se, në rast se, po qe se (if)**

**Në doni të jeni shokë të mirë, ndihmojeni njëri-tjetrin.** If you want to be good friends, help each other.

**Do të vij me ty nëse më premton se nuk do të pish shumë.** I will

come with you if you promise that you won't drink a lot.  
**Në qoftë se nuk më gjen në shtëpi, do të jem te Petriti.** If you don't find me at home, I will be at Petrit's.  
**Në rast se më duhesh, do të të thërras.** If I need you, I will call you.  
**Po qe se të duket më mirë atje, shko me ata.** If it seems better to you there, go with them.  
**Po qe se vjen ti, vij edhe unë.** If you come, I will go too.

**ngase, nga shkaku se, pér shkak se, sepse, pér arsyse (because)**  
**Ishë lodhur shumë ngase kishte punuar gjithë ditën.** He was very tired because he had worked all day.  
**Ai nuk shkoi në pushim pér shkak se nuk kishte para.** He didn't go on holiday because he didn't have the money.  
**Ajo shkoi në shkollë më këmbë sepse ia kishte dhënë bijikletën shoqes.** She went to school on foot because she had given her bicycle to her friend.  
**Doli të shëtiste pak, pér arsyse se ishte mërzitur në shtëpi.** She went out to walk a little because she was bored at home.

**para se (before)**

**Para se të nisej pér Prishtinë, Nora i vizitoi prindërit.** Before she left for Prishtina, Nora visited her parents.

**përderisa (as long as)**

**Përderisa të jetë moti kështu me shi, nuk do të nisem pér pushim.** As long as the weather is rainy like this, I won't set off on holiday.

**përndryshe (otherwise)**

**Dëgjo me kujdes, pérndryshe s'do të dish çka të bësh.** Listen carefully, otherwise you won't know what to do.

**posa, sapo (as soon as)**

**Posa (or sapo) cingëroi telefoni, e dita se je ti.** As soon as the phone rang, I knew it was you.

**prapëserapë (still)**

**Edhe pse ky fustan po më pëlqen shumë, prapëserapë ai tjeri më duket më i mirë.** Even though I like this dress, the other one still looks better to me.

**që, se (that)**  
**Ai është një shok që kurrë s'të lë në rrugë.** He is the sort of friend who wouldn't let you down.  
**Sa herë që vij te ti, ndihem mirë.** Whenever I come to you, I feel good.  
**Ajo më tha se do të vinte në orën tetë.** She told me that she would come at eight o'clock.

**qoftë . . . qoftë (be it . . . or, either or whether . . . or)**  
**Ajo e kaloi verën qoftë duke punuar në kopsht, qoftë duke lexuar ndonjë libër.** She spent the summer either working in the garden or reading a book.

**Ai vjen me ty kurdo që ta thërrasësh, qoftë ditën, qoftë natën.** He comes with you whenever you call him, be it by day or by night.

**sesa, se (than)**

**Më mirë të vdesësh një ditë sesa (se) përditë.** Better to die one day than every day.

**Dhëlpra, kur iu dogj bishti, mendoi se gjithë bota kishte marrë zjarrë.** The fox, when his tail burnt, thought that the whole world had caught fire.

**sic (as)**

**Sic po e shihni, gjuha shqipe nuk është aq e vështirë.** As you see, the Albanian language isn't that difficult.

**veç, veçse, vetëm se (only)**

**S'dinte çka të bënte, veçse sillej poshtë e lart.** He didn't know what to do, only wandered up and down.

**■ III/ READING PASSAGE****NJË MBRËMJE E KËNDSHME**

Pasi u kthyen nga parku, Nora u shtri të pushonte pak, kurse Drita filloj të shkruante ca kartolina. Nuk kaluan pesë minuta dhe Norën e zuri gjumi. Në orën pesë e gjysmë Drita e zgjoi Norën sepse duhej të bëheshin gati e të dilnin. Pubi ku duhej të takoheshin me Markun ishte bukur larg prandaj duhej të shkonin me autobus.

Kur arritën në pub, aty e gjetën Markun me dy shokë. Pas dy. tre minutash erdhi edhe Liza. Marku i pyeti ç'do të pinin dhe që të tria morën lëng portokalli. Marku me qëllim nuk i njohu vajzat me shokët që kishte sjellë me vete. U bë gjoja se harroi.

*Marku:* Si e kaluat ditën sot, Dritë?

*Drita:* Shumë mirë. Po ti, Mark, a e bleve biletën?

*Marku:* E rezervova një biletë pér datën dhjetë.

*Drita:* Ç'ditë është më datën dhjetë?

*Marku:* E mërkurë.

*Drita:* Shumë mirë, sepse të mërkurave në mbrëmje ka aeroplan pér Prishtinë nga Beograd. Nuk ke nevojë të presësh shumë, nja tre çerek ore ndoshta. Ashtu është. Pata fat. Në të vërtetë edhe unë sot pata një ditë interesante.

*Nora:* Ditë interesante duke kërkuar biletë? ! Mos u tall me ne.

*Marku:* Nuk po tallem. Pata një ditë që ma përkujtoi Kosovën. Piva kafe turke, disa gota alkohol nga Kosova.

*Nora:* Ndoshta këto i ke marrë me vete nga Kosova.

*Marku:* Jo, jo, nuk i kam marrë me vete, por më janë ofruar në shenjë mikpritjeje.

*Nora:* Mikpritje shqiptare në Londër? !

*Marku:* Madje në qendër të Londrës.

*Nora:* E pabesueshme.

*Drita:* Na trego si ndodhi kjo. Mjaft na mbajte pezull.

*Nora:* Vërtet na i zgjate veshët, Mark.

*Marku:* Ja, po ju tregoj. Në mëngjes, duke kërkuar në gazetë ndonjë agjenci që shet bileta pér Jugosllavi, rastësisht e pashë një emër që m'u duk se ishte shqiptar. Shkruante H. Gashi. M'u kujtua se mbiemri i një shoku të Petritit ishte Gashi. E shënova adresën dhe u nisa menjëherë pér në Rixhent Stritë. Arrita atje, trokita në derë dhe hyra brenda. Një burrë rrëth të pesëdhjetave ulur pranë një tryeze më ofroi një karrige dhe më pyeti ç'dëshiroja. Edhe nga pamja m'u duk se ishte shqiptar. Thashë më vete, 'Do ta përshëndes në shqip, e nëse nuk më përgjigjet ia kthej në anglisht. I thashë, 'Mirëdita'. Për një çast ai mbeti i hutuar.

*Liza:*

*Marku:*

Kjo i erdhi si e papritur. Pastaj m'u përgjigj me 'Mirëdita, urdhëroni'. I tregova se çka dëshiroja. I tregova se apo isha kthyer nga Kosova dhe se dëshiroja të shkoja atje përsëri që ta studioj gjuhën shqipe. Më siguroi biletë me çmim mjaft të lirë. Vërtet paske pasur një ditë interesante. A ma jep edhe mua adresën. Ndoshta edhe unë e blej biletën tek ai.

Sigurisht, por prit se paskam harruar krejt t'ju njoh me shokët. Ky është Roberti, një shok i shkollës, kurse ky është Adili, student i gjuhës angleze nga Prishtina. Adili më gjeti duke pirë kafe te Zotëri Gashi.

Ora është gati dymbëdhjetë në mbrëmje. Nora është përsëri në gjumë, kurse Drita apo e përfundoi ditarin pér ditën e sotme me fjalinë, 'Ishte kjo një mbrëmje e këndshme'.

#### Vocabulary

shtrihem	lie down
më zë gjumi	fall asleep
zgjoj	wake ( <i>somebody</i> ) up
me qëllim	on purpose
gjoja	as if
datë, -a, -a	date
tallem	joke ( <i>non-act.</i> )
përkujtoj	remind
kafe turke	Turkish coffee
shenjë, -a, -a	sign
në shenjë mikpritjeje	as a sign of hospitality
e pabesueshme	unbelievable
pezull	pending; afloat; suspended
na i zgjate veshët	you kept us waiting long ( <i>lit.</i> you lengthened our ears)
agjenci, -a, -	agency
emër, -i, -a	name
mbiemër, -i, -a	surname
trokas	knock
rreth të pesëdhjetave	around the fifties

pamje, -a, -	appearance
i/e hutuar	confused
i/e papritur	unexpected (adj.)
siguroj	secure
ditar, -i, -ë	diary
fjali, -a, -	sentence

**IV/ EXERCISES**

(1) Answer the following questions on the reading passage:

- 1 Çka bëri Nora pasi u kthyen nga parku?
- 2 Po Drita?
- 3 Në orën sa e zgjoi Drita Norën?
- 4 Pse e zgjoi?
- 5 Me kë e gjetën Markun kur arritën në pub?
- 6 Për datën sa e kishte rezervuar Marku biletën?
- 7 Te kush e kishte rezervuar biletën ai?
- 8 Si e kishte gjetur atë?
- 9 Çka i kishte ofruar ai Markut?
- 10 Kë e kishte takuar Marku në zyrën e tij?

(2) The following statements are taken from the first situation. Mark them with T if they are true, or with F if not:

- 1 Gjarpri që u paraqit herën e parë në aeroplan ishte dy metra e gjysmë i gjatë.
- 2 Gjarpri që u paraqit këtë herë ishte një metër e gjysmë i gjatë.
- 3 Gjarpri i parë nuk ishte helmues, kurse i dyti ishte helmues.
- 4 Kur i treguan pilotit për gjarprin ai e ktheu aeroplanin në aeroportin prej ku ishin nisur.
- 5 Disa mendojnë se stjuardesa e ka futur gjarprin në aeroplan me një tufë lulesh.
- 6 Të gjithë udhëtarët e vazhduan udhëtimin me një aeroplan tjeter.
- 7 Gjarpri i parë doli në kabinën e pilotëve në nëntor të këtij viti.

(3) Complete the following sentences with a conjunction that will fit the context:

- 1 Nuk na ftoi në gosti ..... mua .....
- 2 Qeni im ..... është i shpejtë .....
- 3 ..... vij në Angli, do të të vizitoj.
- 4 ..... pata shumë kohë, i bëra një vizitë të shkurtër.
- 5 ..... s'më ke dëgjuar mua, të ka dalë keq.
- 6 ..... unë shkruaja letra, Nora flinte.
- 7 Qeni yt qenka i mençur, ..... imi është edhe më i mençur.
- 8 ..... vonohem pak, më prit se do të vij gjithsesi.
- 9 ..... shkofsha atje, nuk do ta vizitoj.
- 10 ..... i thashë të ma sillte librin, ai përsëri kishte harruar.
- 11 ..... arrita në punë, m'u kujtua se e kisha lënë ujin duke rrjedhur (*flowing*).
- 12 ..... kemi mysafirë nga Anglia, shkojmë në Shpellën e Gadimës.

(4) Reading comprehension

Fëmijët janë si bletët, e kanë vështirë të qëndrojnë në një vend. Bota, që është një fushë e madhe lodrash, i rrëmbej shpejt, u merr mendtë dhe i largon nga trishtimi dhe gëzimi i çastit. Edhe lodra më e mahnitshme, si për bletën lulja me nektar, nuk i mban për një kohë të gjatë e në një vend duart e tyre, këmbët e tyre, sytë e tyre të gjallë. Shpejt do të mërziten, do ta lënë e do të hidhen gjetiu, ashtu si e lë bleta punëtore lulen dhe fluturon nëpër petalet e tjera të panjohura. E kështu, me bredhjet e fluturimet e tyre, si ai burimi, që duke ecur kullohet, ata shkundin pluhurin me të cilin koha mbulon gjérat dhe qëndrojnë gjithmonë të çelët e të lirë.

Kështu ngjau edhe me Kilin. Në fillim e kërkonte nënën kudo, po shpejt u mësua me këtë mungesë e me sjelljen e të

mëdhenjve që mundoheshin t'ia fshihnin atë mungesë dhe kështu, pak nga pak, rrathi i botës së tij e mënjanoi fare boshtin e vjetër, rreth të cilat i vogli ishte mësuar të lodronte, të qante, të qeshte, dhe ai zuri të vërtitej tanë sa më larg e më larg qendrës. Lahuri i zi që i kishte mbetur përparrë syve që atë ditë kur ia hodhën në fytyrë nënës së tij, sikur po e humbte ngjyrën, dhe ajo njollë e zezë, që i bënte hije burimit të jetës dhe vreroste sytë e të voglit, pak nga pak po fshihej e zbërdhulej.

Dielli që u jep drithë e ngjyrë sendeve, ai edhe ua heq!

Adaptuar sipas J. Xoxës  
»Lumi i vdekur«

### Vocabulary

bletë, -a, -	bee
lodër, -a, -a	toy
rrëmbej	grab
trishtrim, -i, -e	sadness, sorrow
gëzim, -i, -e	joy, happiness
çast, -i, -e	moment
e mahnitshme	astonishing
nektar, -i	nectar
i gjallë	living, lively
hedh	throw
gjetiu	elsewhere
petale, -ja, -	petal
bredhje, -a, -	wandering
fluturim, -i, -e	flying
burim, -i, -e	spring
kullohem	become clean; be filtered
shkund	shake off
pluhur, -i	dust
i/e çelët	open
ngjaj	happen; resemble
mësohem me	get used to
mungesë, -a, -a	absence
të mëdhenj	grown-ups
mundohem	try
fsheh	hide

mënjanoj	put aside
bosht, -i, -e	axis
lodroj	run around
qaj	cry, weep
vërtitem	move around, revolve
tani	now
lahur, -i	fine cloth
njollë, -a, -a	spot, stain
vreros	embitter
zbërdhulet	it fades
send, -i, -e	thing ( <i>fem. in pl.</i> )
heq	take off
adaptuar	adapted
vdekur	dead

## Unit Twenty-One

### ■ IV SITUATIONS

**blija** buy her/him  
*A:* Beti e ka ditëlindjen. Nuk di ç'dhuratë t'i blej.  
*B:* Blija një libër.

**lajmëronani** let us know  
*A:* Ndoshita vijmë vitin e ardhshëm në Angli.  
*B:* Shumë mirë. Lajmëronani para se të niseni.

**hapja** open it for her/him  
**jepma** give me  
*A:* Nora më telefonoi para pesë minutash. Ka mbetur e mbyllur në dhomë. Nuk po e gjen çelësin.  
*B:* A ke çelës ti?

A: Po, kam.

B: Atëherë shko e hapja derën.

A: Por kam shumë punë. A je e zënë me punë ti?

B: Jo, sot nuk kam shumë punë.

A: Shko, të lutem, e hapja derën Norës.

B: Jepma çelësin se po nisem menjëherë.

<b>ruhu</b>	take care
<b>mos u brengos</b>	don't worry
<b>më shkruaj</b>	write to me
<b>dërgoma</b>	send me

A: Ditën e mirë, nënë.

B: Ditën e mirë, bija ime. Ruhu.

A: Po, nënë, do të ruhem. Mos u brengos fare. Do të të shkruaj një letër sapo të arrij.

B: Jo, mos më shkruaj letër, por dërgoma një kartolinë me ndonjë pamje të bukur.

A: Ani, nënë.

<b>tregomë</b>	tell me
<b>mbushe</b>	fill it
<b>xhevze, -ja, -</b>	small coffee pot
<b>qes</b>	put
<b>qiti</b>	put (to) it
<b>lugë, -a, -</b>	spoon
<b>varësisht</b>	depending
<b>vloj</b>	boil
<b>vloje</b>	boil it
<b>qitja</b>	put it (to it)
<b>përzjeje</b>	stir it
<b>bëma</b>	make me
<b>shikomë</b>	look at me

A: Tregomë, të lutem, si të bëj kafe turke.

B: Është shumë lehtë. Së pari mbushe xhevzen me ujë. Pastaj qiti sheqer, gjysmë luge, një lugë, dy lugë, varësisht si e pi kafenë. Pastaj vloje ujin, por mos e lë të vlojë shumë. Në fund qitja një lugë kafe dhe përzjeje duke e mbajtur mbi zjarr. Kur fillon të vlojë, kafeja është gati.

A: Do të provoj ta bëj një menjëherë. Ta bëj edhe ty një?

B: Ani, bëma edhe mua një.

A: Por ti rri këtu e shikomë mos po gaboj.

### III GRAMMATICAL PATTERNS

#### *The Imperative*

The Imperative has only one person, that is, second person, singular and plural. The second person plural is easy to remember because almost all the verbs have the same form as for the Present Indicative, e.g. **ju pononi** – **pononi!**, **ju shkoni** – **shkoni**.

As far as the second person singular is concerned, only a small number of verbs have the same form as for the Present Indicative. Such are:

<b>hap</b>	(open)	<b>ti hap – hap!</b>
<b>kap</b>	(catch, grab)	<b>ti kap – kap!</b>
<b>di</b>	(know)	<b>ti di – di!</b>
<b>pi</b>	(drink)	<b>ti pi – pi!</b>
<b>ha</b>	(eat)	<b>ti ha – ha!</b>
<b>rri</b>	(stay)	<b>ti rri – rri!</b>
<b>jap</b>	(give)	<b>ti jep – jep!</b>

Other verbs can be divided into different groups in terms of the formation of the second person singular of the Imperative. Verbs of the types **punoj**, **rrëfej** (*tell*) and **fshij** (*sweep*) do not take any ending, e.g.:

**punoj** – **puno**      **rrëfej** – **rrëfe**      **fshij** – **fshi**  
Exceptions are **gjej** – **gjej!**, **blej** – **blej!** and **brej** (*gnaw*) – **brej!**

Verbs like **laj**, **shkruaj**, **përzjej** (*mix*), **bëj**, **thyej** (*break*) and **fryj** (*blow*) take the ending **-j**, and thus are identical with the first person of the Present Indicative. Here are some examples:

<b>mbaj</b>	(hold)	<b>mbaj!</b>
<b>luaj</b>	(play)	<b>luaj!</b>
<b>lyej</b>	(paint)	<b>lyej!</b>
<b>përzjej</b>	(mix)	<b>përzjej!</b>
<b>bëj</b>	(do, make)	<b>bëj!</b>

Note, however, **hyj** – **hyr!**

In a similar way **them** and **dua** form the imperative:  
**them** – **thuaj!**      **dua** – **duaj!**

Another group consists of verbs such as **dal** (*go out*), **ndjek** (*chase, follow*), **djeg** (*burn*). These change **-a** or **-je-** into **-i-**, and those ending in **-k** and **-g** change these into **-q** or **-gj** as they do in the second person plural of the Present Indicative, e.g.:

<b>ndjek</b>		<b>ndiq!</b>	
<b>dal</b>		<b>dil!</b>	
<b>vjel</b>	( <i>pick (fruit)</i> )	<b>vil!</b>	
<b>mbjell</b>	( <i>plant</i> )	<b>mbill!</b>	
<b>nxjerr</b>	( <i>take out</i> )	<b>nxirr!</b>	
<b>djeg</b>		<b>digj!</b>	
<b>therras</b>	( <i>call</i> )	<b>therrit! (also thirr!)</b>	

Some verbs of the same type as the last two, such as **vras** (*shoot*), **ngas** (*run*) and **pres** (*cut*) have two forms:

**vras** – **vra!/vrit!**      **pres** – **pre!/prit!**

The Imperative of the verb **marr** (*take*) is **merr!**

The last group consists of those verbs that take the ending **-r** for the second person singular. Such are:

<b>vē</b>	( <i>put</i> )	<b>vēr!</b>	
<b>zē</b>	( <i>catch</i> )	<b>zēr!</b>	
<b>lē</b>	( <i>leave</i> )	<b>lēr!</b>	
<b>shpie</b>	( <i>take to</i> )	<b>shpjēr!</b>	
<b>bie</b>	( <i>fall; bring; lie down</i> )	<b>bjer!</b>	

(Notice that the last two also change **-i-** into **-j-**.)

The Imperative of **flas** is **fol** for the singular, and **flitni** for the plural; similarly **jam** has **ji!** and **jini!**, and **kam** has **ki!** and **kini!**

The verb **vij** has the forms **eja!** (*sing.*), **ejani!** (*pl.*) for the Imperative.

The verb **vete** (*go*) has no Imperative forms, but the Subjunctive forms **tē vesh** (*sing.*), **tē veni** (*pl.*) can be used.

The negative form of the Imperative is formed by putting **mos**

(*don't*) in front of the verb, e.g. **mos puno**, **mos mēso**, **mos luaj etc.**

The Imperative of verbs which are non-active in form is arrived at by adding the ending **-u** to the stem and, for those verbs that end in a vowel, inserting **-h-** before the **-u** for ease of pronunciation. In the second person plural, the ending **-ni** is added after the **-u**. Here are some examples:

<b>hapu</b>	<b>hapuni</b>	<b>mēsohu</b>	<b>mēsohuni</b>
<b>kapu</b>	<b>kapuni</b>	<b>bēhu</b>	<b>bēhuni</b>
<b>jepu</b>	<b>jepuni</b>		

Notice some other changes in the following verbs:

<b>ruaj</b>	<b>ruhu</b>	<b>ruhuni</b>	<i>(keep, retain)</i>
<b>zē</b>	<b>zihu</b>	<b>zihuni</b>	
<b>vē</b>	<b>vihu</b>	<b>vihuni</b>	

In the negative Imperative of non-active verbs, the ending **-u** becomes a separate element between the negative particle **mos** and the verb, and is written as follows:

<b>mos u lodh</b>	<i>(don't get tired)</i>
<b>mos u nis</b>	<i>(don't set out)</i>
<b>mos u mēso</b>	<i>(don't get used to)</i>
<b>mos u trego</b>	<i>(don't show yourself)</i>

You can see that some of the verbs change their meaning when they are non-active. Such are the last three given above. The negative forms of the last three verbs are also ambiguous because the non-active particle **u** coincides with the dative plural clitic **u** and can therefore mean 'don't teach (to) them', 'don't narrate (to) them', 'don't tell (to) them'. The intended meaning is usually revealed by the context.

The clitics, or the short forms relating to the first and third person singular and plural can be used with Imperatives. They can precede the verb in the Imperative (in the negative this is obligatory) in which case they are written separately, or they can follow the Imperative form and then are written together as one unit with the verb.

See first some of these clitics used with the negative form of the verb përmend (*mention*):

<b>mos më përmend</b>	Don't mention me/to me
„ ma „	it to me
„ m'i „	them to me
„ e „	it
„ i „	them/it to him
„ ia „	it to him/her
„ na „	us
„ na e „	it to us
„ na i „	them to us
„ u „	to them
„ ua „	it/them to them

Here is an example of a verb in the Imperative followed by clitics:

<b>merrmë-ni</b>	take me / for/to me
<b>merrma-ni</b>	take it for me / to me
<b>merrmi-ni</b>	take them for me / to me
<b>merre-ni</b>	take it
<b>merri-ni</b>	take them
<b>merrja-ni</b>	take it from him/her ( <i>notice ia = ja</i> )
<b>merrna-ni</b>	take us / it/them for us
<b>merru-ni</b>	take from/for them
<b>merrua-ni</b>	take it from/for them
<b>merrmia-ni</b>	take it from/for my . . . ( <i>sing.</i> )
<b>merrmua-ni</b>	take it from/for my . . . ( <i>pl.</i> )

(Notice that the form **merru-ni** is ambiguous and may be confused with the non-active.)

Verbs ending in a vowel in the Imperative add **-j-** before taking one of the above clitics beginning with a vowel, e.g.:

<b>puno</b>	<b>punoje</b>	<b>punogeni</b>	<b>punojini etc.</b>
<b>mëso</b>	<b>mësoje</b>	<b>mësojeni</b>	<b>mësojini etc.</b>

Also, some of the verbs that end with **-j** in the Imperative like **mbaj**, **laj** etc., lose this **-j** before taking one of the above clitics beginning with a consonant, e.g.:

<b>mbaj</b>	<b>mbamë</b>	<b>mbana</b>	<b>etc.</b>
<b>laj</b>	<b>lamë</b>	<b>lana</b>	<b>etc.</b>

### III/ READING PASSAGE

#### NË MUZEUN BRITANIK

Moti është tipik anglez, i vranët e me riga shiu të kohëpas-kohshme. Por kjo sot nuk është me rëndësi sepse Drita e Nora do ta kalojnë ditën duke vizituar disa muze, në radhë të parë Muzeun Britanik, për të cilin Drita kishte dëgjuar aq shumë.

Për çudi, Nora sot u çua e para dhe e bëri mëngjesin gati. Në orën nëntë dolën nga banesa dhe u nisën për në muze. Kur arritën para ndërtësës së muzeut, Drita tha se ndërtësa i dukej e vogël në krahasim me sa kishte dëgjuar për këtë muze. Nora nuk tha asgjë.

Hynë brenda, morën disa katalogë dhe pasi që i shikuan, vendosën t'ia fillonin nga qytetërimet e vjetra egiptiane, greke e romake. Duke shikuar objektet e eksposuara dhe duke kaluar nga një korridor në tjetrin, Drita filloi ta ndërrojë mendimin lidhur me madhësinë e ndërtësës. Tani, nga brenda, ajo i dukej e pafund ashtu si mjeshtria e imaginata e atyre që kishin gdhendur objektet e eksposuara. Secili objekt të mahniste me diçka.

Korridoret ishin plot me njerëz. Disa vinin në grupe e me ciceronë që jepnin shpjegime plotësuese shumë interesante. Koha kalonte pahetueshëm. Kur Drita e shkoi orën dhe pa se kishte kaluar mesdita, nuk u besoi syve. Mendoi se e kishte orën keq, por jo, ora e tregonte kohën e saktë.

Para se ta vizitonin ekspositen e veçantë të muzeut me krijime prej qelqi të periudhës romake, ato vendosën të pinin nga një kafe. Pasi që e shikuan ekspositen, ku panë një zhvillim interesant e shkallë-shkallë të objekteve prej qelqi, ato vizituan seksionin e orëve. Aty panë disa nga orët më të vjetra e më primitive e deri te orët pak a shumë moderne dhe shumë të bukura. Kryesisht ishin orë muri.

Ora po bëhej katër pasdreke. Drita në fund bleu disa suvenire e kartolina dhe që të dyja dolën nga muzeu. Ato kishin planifikuar t'i shikonin edhe figurat prej dylli në Madam Tusodë, por vendosën që këtë ta bënin një ditë tjeter. Nora, natyrisht, tha se më mirë ishte të shkonin e të pushonin pak sepse në mbrëmje ishin të ftuara në festimin e ditëlindjes së Betit.

Para se tē kthehesin nē banesë, ato shkuan e i blenë Betit nga një dhuratë.

*Vocabulary*

tipik-e	typical
rigë, -a, -a	drizzle
i kohëpaskohshëm	from time to time ( <i>adj.</i> )
radhë	order, line, row
në radhë tē parë	in the first place
çohem	get up
mëngjes, -i, -e	breakfast
katalog, -u, -ë	catalogue
qytetërim, -i, -e	civilization
egiptian-e	Egyptian
romak-e	Roman
objekt, -i, -e	object
i/e ekspozuar	exhibited
korridor, -i, -e	corridor, hall
ndërroj	change
lidhur me	in connection with
madhësi, -a, -	size
i/e pafund	endless
mjeshtri, -a, -	mastery, skill
imagjinatë, -a	imagination
ghhend	carve
mahnis	amaze
ciceron, -i, -ë	guide
shpjegim, -i, -e	explanation
plotësues-e	supplementary
pahetueshëm	unnoticed ( <i>adv.</i> )
mesditë, -a	midday
i/e saktë	right, exact
ekspozitë, -a, -a	exhibition
krijim, -i, -e	creation
qelq, -i	glass
periudhë, -a, -a	period
shkallë-shkallë	gradually, step by step
seksion, -i, -e	section
primitiv-e	primitive

kryesisht	mainly
(që) te dyja	both
dyll, -i	wax
i/e ftuar	invited
festim, -i, -e	celebration

**IV/ EXERCISES**

(1) Answer the following questions on the reading passage:

- 1 Si është moti sot?
- 2 Cila u çua e para sot, Drita apo Nora?
- 3 Në orën sa dolën Drita e Nora nga banesa?
- 4 Kush u jepte shpjegime plotësuese njerëzve që vinin në grupe?
- 5 Çka shkuan Drita e Nora së pari?
- 6 Çka shkuan ato pasi që pinë nga një kafe?
- 7 Çka vizituan në fund?
- 8 Ç'bëri Drita para se tē dilnin?
- 9 A shkuan t'i shikonin figurat prej dylli?
- 10 Ç'bënë ato para se tē kthehesin nē banesë?
- 11 Ku ishin ftuar tē shkonin nē mbrëmje?

(2) Change the following sentences as in the example:

*Example:* Më shkruaj më shpesh.

Shkruamë më shpesh.

- 1 U thuaj tē vijnë.
- 2 Ma blij librin që tē thashë.
- 3 M'i matni (*measure, weigh*) dy kilogramë rrush, ju lutem.
- 4 Ia dërgo një ftesë (*invitation*) Norës.
- 5 Na sillni nga një kafe, ju lutem.
- 6 Më merrni edhe mua.
- 7 Ia trego fotografitë Petritit.
- 8 M'i pëershëndet shokët.
- 9 Ma zër një vend pranë teje, tē lutem.
- 10 U bëj nga një kafe, tē lutem.
- 11 Ua lexo një tregim (*story*) interesant.
- 12 U fol për muzetë.

- 13 Ia uro ditëlindjen Betit.  
 14 Na e shpjego filmin shkurtimisht.  
 15 M'i vizito prindërit.

(3) Make the following sentences negative:

- 1 Merre ombrellën me vete.
- 2 Blijë Betit dhuratën.
- 3 Folu për të kaluarën (*past*).
- 4 Mbyllja derën me çelës.
- 5 Pritnani në stacion.
- 6 Ftojini edhe ata në darkë.
- 7 Puno shumë.
- 8 Merrja majmunit bananen.
- 9 Mbill lule në kopsht.
- 10 Ujiti (*water*) lulet çdo ditë.
- 11 Përgjigjmu në pyetje.
- 12 Fotografoje kopshtin e Betit.

(4) Change the following sentences using the non-active Imperative:

*Example:* Ruaje veten.

Ruhu.

- 1 Mbaje veten se do të bëhet mirë.
- 2 Kurrë mos e brengos veten për gjëra të parëndësishme (*unimportant*).
- 3 Mos e tregoni veten para gjithkujt.
- 4 Gjithmonë largoje veten nga rrreziku.
- 5 Mos e mashtro veten me gjëra që nuk vlejnë.
- 6 Mbuloje veten mirë që të mos ftoshesh.
- 7 Mos bëj shoqëri me shokë të këqij.
- 8 Mos e krahasoni (*compare*) veten me ata.
- 9 Mos e lodhni veten pa nevojë.
- 10 Mos e përlyeni veten në baltë.

## Unit Twenty-Two

### ■ I SITUATIONS

më erdhi mirë  
u bëfsh

I was glad  
may you (sing.) become

A: Para një ore bisedova me Teutën e Petritin.

B: Vërtet?

A: Më thirrën me telefon për të ma uruar ditëlindjen! Më erdhë shumë mirë. Më thanë, ‘Urime për ditëlindjen! U bëfsh njëqind vjeç!’

B: Mirë që qenkan kujtar të të telefonojnë për ditëlindje.

shitore, -ja, -  
shtëpi mallrash  
send, -i, -e  
provoj  
shitës, -i, -  
durim, -i  
zhvesh  
çlodhem

shop  
department store  
thing (fem. in pl.)  
try  
salesman  
patience  
take off  
rest (*non-act.*)

A: Ç'bëtë dje, Dritë?

B: Dje tërë ditën e kaluam nëpër shitore e shtëpi mallrash.

A: A bletë ndonjë send?

B: Më shumë provuam se ç'blemë. Për fat shitësit patën durim derisa unë vishja e zhvishja fustana të ndryshëm.

A: A u lodh Nora?

B: U lodhëm që të dyja, por nga ora një pasdreke u ulëm në një restorant, hëngrrëm drekë, pimë kafë dhe u çlodhëm mirë.

më pihet  
më flihet

I feel like drinking  
I feel like sleeping

A: Të të bëj një kafe?

B: Jo, nuk po më pihet.

A: Mua po më pihet një kafe.

B: Atëherë bëje një për vete. Mua po më flihet. Sapo të përfun dojë ky film do të shkoj në shrat.

A: Të hahet diçka nga pemët ndoshta?

B: Po, do ta haja një mollë.

**lodhem së foluri** I get tired of speaking

A: Njëri nga shokët e Markut ishte fjalamani madhi. Si nuk u lodh së foluri gjatë gjithë mbrëmjes.

B: Ashtu është. Unë u lodha së dëgjuari. Dikur fillova të mos ia vija veshin.

A: Disave u dukeshin fjalët e tij interesante. Kurrë s'pushuan së qeshuri.

B: Mendoj se ishin pak të dehur.

## II/ GRAMMATICAL PATTERNS

### Some Patterns in the Derivation of Verbs

Verbs can be simple like **luaj**, **blej**, **shkoj**, etc., or derived. The derived ones are formed in different ways. This can be seen from the list below:

dëm	dëmtoj	damage <i>n.</i>	- damage <i>v.</i>
dorë	dorëzoj	hand	- hand in
	përdor		use
	shpërdor		abuse, misuse
	keqpërdor		misuse
	përdoroj		use, make use of, handle
			abuse, misuse
nder	shpërdoroj		
	nderoj	honour	- respect, honour
	çnderoj		dishonour, disgrace
faj	fajësoj	blame <i>n.</i>	- blame <i>v.</i>
	shfajësoj		clear, exonerate
rregull	rregulloj	rule	- put in order, arrange
	çrregulloj		disorder, scatter

punë	punoj	work <i>n.</i>	- work <i>v.</i>
	përpunoj		refine
	punësoj		employ
	çpunësoj		dismiss, put out of work
shëndet	përshtëndet	health	- greet
vlerë	vlerësoj	value <i>n.</i>	- value <i>v.</i> , appraise
	zhylerësoj		devalue, degrade, depreciate
vend	vendos	place <i>n.</i>	- place <i>v.</i> ; decide
	zhvendos		displace; annul a decision

There are other types of verb formation such as **jetoj + bashkë** = **bashkëjetoj** (*coexist*), **trokas + duar** = **duartrokas** (*clap*) etc. However, you should pay special attention to three of the prefixes used above, which, when added to the verb usually give it the opposite meaning. These are **ç-**, **sh-** and **zh-**. **Ç-** is prefixed to verbs beginning with **m**, **n**, **nj**, **j**, **l**, **r** or **rr** as well as to verbs beginning with a vowel, e.g.:

mbështjell	çmbështjell	wrap – unwrap
mbledh	çmbledh	collect – disperse
mbush	çmbush	fill – empty
mërzis	çmërzis	bore – relieve boredom
ngatërroj	çngatërroj	entangle – disentangle
organizoj	çorganizoj	organize – disorganize
(përmallohem	çmallem	long for – relieve nostalgia
lodh	çlodh	tire – rest
registroj	çregistroj	register – cross out
rregulloj	çrregulloj	arrange – disarrange
end	çend	weave – unpick
ënjt	çenjt	swell – subside

Note one exception – **liroj** and **çliroj** both mean 'free, liberate'.

Zh- is prefixed to verbs beginning with a voiced consonant, such as **b**, **d**, **g**, **gj** or **v**, e.g.:

bëj	zhbëj	do – undo
brengos	zhbrengos	worry – soothe

dredh	zhredh	twist – untwist
vesh	zhvesh	put on – take off
varros	zhvarros	bury – exhume

Sh- is prefixed to verbs beginning with a voiceless consonant such as p, t, k, f or th, e.g.:

paloj	shpaloj	pile, pack – unpack
kurdis	shkurdis	wind – unwind
frenoj	shfrenoj	brake – release brakes
thur	sthur	knit – undo knitting

s- and z- are two variants of another prefix which gives to the verbs with which it is used an intensive meaning. S- is used before voiceless consonants, z- before voiced consonants, e.g.:

skuq	redden
zbukuroj	beautify, decorate
zgjeroj	widen
zgjas	lengthen
zvogëloj	diminish, reduce
zmadhoj	enlarge
zverdh	make yellow

Notice the relationship between the following pairs of verbs:

mbath	put on ( <i>shoes</i> )	zbath	take off ( <i>shoes</i> )
ngul	stick in	shkul	take out, pull out
ngrij	freeze	shkrij	defrost
mbuloj	cover	zbuloj	uncover, discover
ngatërroj	entangle	shkatërroj	disentangle, destroy

#### Use of the Non-Active

In the third situation at the beginning of the unit you can see a particular use of the non-active to express the equivalent of English *I (don't) feel like . . .* These constructions in Albanian are

preceded by a dative pronominal clitic, e.g.:

Nuk më shkohet në kinema. I don't feel like going to the cinema.

„ të	„
„ i	„
„ na	„
„ ju	„
„ u	„

You (sing.) „

He/she „

We „

You (pl.) „

They „

#### Ablative of Neuter Nouns

In the last situation at the beginning of the unit a special use of the ablative of some neuter nouns deriving from participles can be seen. For example:

të folur (*talking*)

U lodha së foluri. I got tired of talking.

të pritur (*waiting*)

U mërzita së prituri. I got bored of waiting.

të qarë (*weeping*)

S'pushoi së qari. He/she never stopped crying.

#### III/ READING PASSAGE

##### DITËLINDJA E BETIT

Në shtëpinë e Betit zilja e derës cingëronte orë e çast. Shokët e shoqet e Betit që ishin ftuar për ditëlindjen e saj, vinin palë-palë. Të gjithë i kishin blerë nga një dhuratë; kush ndonjë libër, kush ndonjë disk gramafoni a ndonjë shirit magnetofoni. Shokët e shoqet e saj ia dinë shijen Betit.

U mbledhën më se gjysma e të ftuarve, a Beti ende nuk ishte midis tyre. Kur e pyeti Marku të ëmën e saj se ku ishte Beti, ajo i tha se ende po bëhej gati. Nuk kaluan disa minuta dhe Beti u duk në krye të shkallëve. Kishte veshur një fustan solemn shumë të bukur, kishte rregulluar flokët, ishte bërë të mos e njohësh.

Të gjithë ia uruan ditëlindjen me këngën e zakonshme dhe

ngritën dolli për shëndetin e saj. Drita e Adili ia uruan ditelindjen në shqip sepse e dinin se ajo fliste nga pak shqip. I dëshiruan jetë të gjatë e të lumtur dhe shëndet të mirë.

Mbrëmja pastaj vazhdoi deri në orët e vona me biseda, me shaka të ndryshme, me muzikë e vallëzim dhe me pije. Fatkeqësishët disa e tepruan pak me pije, por jo dhe aq sa ta prishnin atmosferën e gëzuar. Të gjithë ndiheshin të lumtur dhe të gjithë kaluan mirë. Beti ishte e buzëqeshur dhe e hareshme tërë kohën. Disa e ngucnin duke e pyetur nëse kishin filluar ta brengosnin vitet, por ajo e dinte se shokët po talleshin, sepse sapo i kishte mbushur të nëntëmbëdhjetat dhe e kishte jetën përrpara.

Beti veçanërisht u kujdes që Drita e Adili të ndiheshin sa më mirë në gostinë e saj, në mesin e shokëve dhe të shoqeve të saj.

#### Vocabulary

disk, -u, disqe	record
gramafon, -i, -a	record player
shirit, -i, -a	cassette, tape
magnetofon, -i, -a	tape recorder
shije, -a, -	taste
të emën	her mother
në krye të shkallëve	on the top of the stairs
solemn-e	solemn
rregulloj	arrange
dolli, -a, -	toast
orë të vona	late hours
bisedë, -a, -a	conversation
vallëzim, -i, -e	dancing
teproj	exaggerate
atmosferë, -a	atmosphere
i/e lumtur	happy
i/e buzëqeshur	smiling ( <i>adj.</i> )
brengos	worry
mbush	complete
të nëntëmbëdhjetat	lit. the nineteens
kujdesem	take care
në mesin	among

#### IV/ EXERCISES

(1) Answer the following questions on the reading passage:

- 1 Ditetlindja e kujt ishte sot?
- 2 Si vinin të ftuarit?
- 3 Çka i kishin blerë ata Betit?
- 4 A ia dinin ata shijen Betit?
- 5 Pse nuk ishte Beti ende midis tyre?
- 6 Si dukej ajo kur u paraqit në krye të shkallëve?
- 7 Si ia uruan ditelindjen Drita e Adili?
- 8 Ç'bënë gjatë mbrëmjes?
- 9 A ishte Beti e gëzuar?
- 10 Për çka u kujdes ajo veçanërisht?

(2) Complete the following sentences as in the example:

Example: Unë e mbështjell librin, kurse ai .....  
Unë e mbështjell librin, kurse ai e çmbështjell.

- 1 Ajo i radhit (*put in order*) librat, kurse unë i .....
- 2 Ju e rregulloni dhomën, kurse ata e .....
- 3 Ne e organizojmë gostinë, kurse ai e .....
- 4 Unë mbathem, kurse ajo .....
- 5 Unë vishem, kurse ajo .....
- 6 Ajo i palon rrabot (*clothes*), kurse unë i .....
- 7 Unë e kyç (*switch on*) hekurin (*iron*), kurse ajo e .....
- 8 Ata më fajësojnë, kurse ky më .....
- 9 Unë e thur shportën, kurse ai e .....
- 10 Unë ia mbuloj të këqiat, kurse ai ia .....

(3) Use verbs in the following sentences instead of adjectives as in the example:

Example: Ai e ka bërë murin të bardhë.  
Ai e ka zbardhur murin.

- 1 Ai është bërë i verdhë.
- 2 Ai e ka bërë problemin të vogël.

- 3 Ai e ka bërë dhomën të bukur.
- 4 Ai u bë i kuq në fytërë.
- 5 Ai e bëri mbledhjen (*meeting*) të gjatë.
- 6 Ata e bënë rrugën të gjerë.

(4) Change the following sentences into the non-active:

*Example:* Do ta haja një mollë.

Më hahet një mollë.

- 1 Do të lexoja, por s'kam kohë.
- 2 Do ta pijà një gotë lëng.
- 3 Do të shkonte në kinema, por s'ka kohë.
- 4 Do të punonim por jemi përtacë.
- 5 Dëshiroj të fle, por duhet t'i shkruaj detyrat.
- 6 Ata dëshirojnë të vijnë, por janë të zënë.
- 7 Ti dëshiron të hash darkë, por mua më duket herët.
- 8 Ti dëshiron të rrish, unë deshiroj të punoj.
- 9 Drita dëshiron të pijë një kafe, Nora dëshiron të hajë një mollë.
- 10 Nuk dëshirojmë të rrimë këtu, por s'kemi ku të shkojmë.
- 11 Nuk dëshiroj të luaj futboll, por do të vij t'ju shikoj.
- 12 Sot nuk dëshirojmë të notojmë sepse jemi të lodhur.

## Unit Twenty-Three

### ■ I SITUATIONS

për pak	for a while, for a little
duke mos e ditur	not knowing
dasmë, -a, -a	wedding
martohem	get married
krushk, -u, krushq	wedding guest ( <i>masc.</i> )
krushkë, -a, -a	wedding guest ( <i>fem.</i> )
dhëndër, -i, dhëndurë	bridegroom

A: A shkuat te Liza sot?

B: Po, shkuam për pak paradreke. Kur arritëm, Liza kishte qenë duke e pastruar macen.

A: Liza e do shumë macen e vet.

B: Duke mos e ditur se do të kthehem pasnesër, ajo më ftoi në dasmën e të vëllait.

A: Iu martuaka vëllai?

B: Po, javën e ardhshme. Kisha dashur ta shoh një dasmë angleze, por më duhet të udhëtoj gjithsesi.

A: Si u thonë në shqip të ftuarve në dasmë?

B: Në shqip u thonë krushq burrave dhe krushka grave. Ajo që martohet është nusja, kurse ai që martohet është dhëndëri.

A: Falemnderit. E kam ditur vetëm fjalën nuse, por jo të tjerat.

pa u takuar	without meeting ( <i>non-act.</i> )
me të arritur	on arrival

A: Në orën sa ke aeroplan pasnesër?

B: Në orën një e gjysmë pasdreke.

A: Mos shko pa u takuar me mua. Kam të të jap diçka për Ylberin.

B: Jo, jo, nuk do të shkoj pa u përshtendetur me ty. Më thuaj, kur duhet të nisem për të arritur në aeroport me kohë?

A: Në aeroport duhet të jesh së paku gjysmë ore para se të fluturojë aeroplani. Për të arritur me kohë është mirë të nisesh në orën njëmbëdhjetë e gjysmë. Na shkruaj pasi të arrish.

B: Do t'ju shkruaj, po si jo. Me të arritur në shtëpi, do ta thërras Norën me telefon.

## II/ GRAMMATICAL PATTERNS

### Non-finite Forms of Verbs

These forms are usually divided into two groups. The first group consists of the Participle and the forms derived from it, e.g. larë 'washed', duke larë 'while washing' (Gerundive), pa larë 'without washing' (Negative Participle). Sometimes you may come across a Past Gerundive of the form duke pasë + Participle. The second group consists of forms of the type pér të larë 'to wash, lit. for washing' and me të larë 'having washed', lit. 'with washing'. Notice that të larë is a nominalized participle preceded by the prepositions pér, to form the infinitive, or me, to express an action that has just finished.

The Participle is not a new form for you. A list of some verbs has been given in Unit Seven.

Participles are formed in several ways. The forms given in the middle column below (which are either the first person singular or plural of the Simple Past) may help you identify the base to which one of the possible endings is added:

(a)	-rë/r		
	vras (kill)	vramë	vrarë
	laj (wash)	lamë	larë
	shoh (see)	pamë	parë
	bëj (do)	bëmë	bërë
	shkoj (go)	shkuam	shkuar
	punoj (work)	punuam	punuar
	kthej (return)	kthyem	kthyer

(b)	-ur		
	gjej (find)	gjeta	gjetur
	fle (sleep)	fjeta	fjetur
	mbaj (hold)	mbajta	mbajtur
	hap (open)	hapa	hapur
	fal (give away)	fala	falur

(c)	njoh (know)	njoha	njohur
	rri (stay)	ndenja	ndenjur
	-në		
	vë (put)		vënë
	zë (catch)		zënë
	lë (leave)		lënë

(d) Verbs ending in l, ll, r or rr which also change the stem vowel when forming the Simple Past of the Indicative, take the ending -ë.

dal (go out)	dola	dalë
sjell (bring)	solla	sjellië
nxjerr (take out)	nxora	nxjerrë
marr (take)	mora	marrë

For some verbs, although one of the above endings can be identified, there is an irregularity in the formation of the Participle base. Here are a few of them:

kam (have)	pata	pasur
dua (want)	deshä	dashur
vdes (die)	vdiqa	vdekur
vij (come)	erdha	ardhur
bie <sup>1</sup> (fall; hit)	rashë	rënë
bie <sup>2</sup> (bring)	prura	prurë
shpie (take to)	shpura	shpënë/shpurë
shtie (inject)	shitura	shtënë
jam (be)	qeshë	qenë
ha (eat)	hëngra	ngrënë
jap (give)	dhashë	dhënë
them (say)	thashë	thënë

The formation of the other non-finite forms mentioned above is easy once you know the Participle of the verb being used. Below examples of their use are given without further explanation, as the translations are explanatory.

Remember that two forms in Albanian correspond to the infinitive in English, the Subjunctive and pér të + Participle. They are often synonymous.

Ata dolën pér të shëtitur pak. They went out to walk a little.  
Pér të mos u vonuar përsëri, ajo u nis më herët. Not to be late again, she left earlier.

**Ato shkuan pér t'u larë në lumë.** They went to bathe in the river.  
**Nuk ka asgjë pér tē qeshur.** There's nothing to laugh about.  
**Pér tē marrë, marrin nga ne; pér tē dhënë, s'japin.** If it's to take, they take from us; if to give, they don't give.  
**'Nata ra, jo pér tē qetësuar trupin nga lodhja, por pér tē shqetësuar zemrat.'** Night fell, not to calm the tired body, but to disquieten hearts.

**Me tē arritur nē shtëpi, u ul pranë televizorit.** Having just arrived home, he sat in front of the television.

**Me t'u kthyer nga shkolla, ai filloi t'i kryejë detyrat.** Having just returned from school, he started his homework.

**Duke shëtitur nē park, e takova një shok tē vjetër.** Walking in the park, I met an old friend.

**Duke mos ditur ç'të bënte, u shtri nē shtrat dhe e zuri gjumi.** Not knowing what to do, he lay in bed and fell asleep.

**Duke u kthyer nga qyteti, i piu ca gota nē një kafene.** While returning from town, he drank a few glasses in a cafe.

**Ai iku pa na thënë lamtumirë.** He went without saying goodbye to us.

**Pa ngrënë hudhër, s'të vjen era.** Without eating garlic, you don't smell of it.

(N.B. *Pa + Participle* is often synonymous with *duke mos + Participle*.)

### III/ READING PASSAGE

#### JETËSHKRIMI I NJË NËNE

Nëna pér tē cilën e kemi fjalën quhej Gonxhe Bojaxhiu. Gonxha rrjedh nga një familje shqiptare që merrej me tregti, e cila, duke shitur mallra nëpër vende tē ndryshme, është shpërndarë edhe vetë. Ajo u lind në Shkup më 27 gusht tē vitit 1910. Babai i Gonxhes quhej Kolë, nëna e saj Drane, motra e saj e madhe Age, kurse vëllai i saj i madh Lazër.

Vetëm katër vitet e para tē shkollës fillore Gonxha i kreu në gjuhën amtare. Sa ishte e vogël ajo ëndërronte tē bëhej mësuesë, tē shkruante vjersha, tē kompononte e tē luante muzikë. Por, më vonë, zgjodhi një rrugë tjetër, rrugën e humanizmit.

Në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare u largua nga gjiri familjar. Mori një rrugë tē gjatë e tē largët pér tē krijuar një familje çfarë

s'e kishte krijuar njeri nē botë. Ja ç'thotë ajo nē një letër pas një udhëtimi tē këtillë tē gjatë:

'Rrugë e largët. . . Natyra këtu është e bukur. Tërë qyteti duket si një kopsht i madh. Palmat e larta ngrinen me krenari nga qielli. Pothuaj çdo shtëpi ka gjelbërim. . . . Por, me habi shikuam rrugët e qytetit. Kudo mjerim. Të binte nē sy se tē pasurit ishin evropianë. Më së tepërmë ndjenim dhembje pér ata njerëz që tèrhiqnin qerre si tē ishin kuaj. Vendosém tē mos voziteshim ashtu. Por çka ngjau? Pikërisht atëherë, mikpritësi ynë vendosi tē na përcillte pér nē shtëpi nē një karrocë tē tillë. Ai ishte mësuar me skena tē tilla. Mbetëm tē shtanguara. S'kishim si tē kundërshtonim. S'na mbeti asgjë tjetër pos tē luteshim që pesha jonë tē ishte sa më e lehtë. Sa tē lumtura qemë kur arritëm te shtëpia e tij.'

Ajo zgjodhi tē bëhej nënë e varfanjakëve, e tē lënëve pas dore, nënë e tē sëmurëve, e pleqve tē flakur e tē braktisur dhe e fëmijëve ilegjitimë, nënë e tē vëtmuarve dhe e fatkëqijve. Të këtillë mblodhi me mijëra nē shumë vende tē rruzullit tokësor. Të gjithë këta, dhe jo vetëm këta, e quajnë nënë.

Kjo është Nënë Tereza, e cila e shkru gjithë jetën duke u ndihmuar nevojtarëve, e cila pér punën e saj humanitare u nderua me çmimin Nobel më 1979, e cila ende, edhe pse e shtyrë nē moshë, gjen forcë t'u ndihmojë atyre që fati ua ka kthyer shpinë. Natyrisht, në këtë punë, ajo nuk është vetëm. Ka ndihmë e përkrahje tē gjerë.

#### Vocabulary

jetëshkrim, -i, -e	biography
tregti, -a	trade
shpërndaj	spread
kryej	finish
gjuhë amtare	mother tongue
ëndërroj	dream
vjershë, -a, -a	poem
komponoj	compose
humanizëm, -i	humanity; humanism
moshë, -a	age
vjeçar-e	of age
gji, -ri, -nj	bosom

i/e largët	remote
palmë, -a, -a	palm tree
gjelbërim, -i, -e	greenery
mjerim, -i, -e	misery
bie në sy	catch one's eye
i/e pasur	rich
evropian-e	European
ndiej, ndjeva	feel
tërheq	pull
qerre, -ja, -	cart
vozitem	ride ( <i>non-act.</i> )
ngaj	happen
karrocë, -a, -a	carriage, cart
skenë, -a, -a	scene
i/e shtanguar	stunned
kundërshtoj	refuse; contradict; oppose
peshë, -a, -a	weight
i/e lehtë	light
varfanjak, -u, -ë	poor, needy
i/e lënë	left
pas dore	neglected
(i/e) sëmurë	ill
i/e flakur	thrown out
i/e braktisur	abandoned
ilegjitim-e	illegitimate
i/e vettuar	lonely
mijëra	thousands
rruzull, -i, -j	globe, earth
tokësor	of earth; terrestrial
nevojtar-e	needy
humanitar-e	humanitarian
çmim, -i, -e	prize
i/e shtyrë në moshë	old aged
shtyj	push
forcë, -a, -a	force
kthej shpinën	turn one's back
ndihmë	help
pérkrahje, -a, -	support
i/e gjerë	wide

## IV/ EXERCISES

(1) Answer the following questions on the reading passage:

- 1 Si quhej Nënë Tereza?
- 2 Nga ç'familje rrjedh ajo?
- 3 Me çka merrej familja e saj?
- 4 Sa vite të shkollës fillore i kreu në gjuhën amtare?
- 5 Çëndërronte të bëhej kur ishte e vogël?
- 6 Ç'rrugë zgjodhi ajo më vonë?
- 7 Sa vjeçë ishte kur u largua nga gjiri familjar?
- 8 Çka mendoni, cilin qytet e përshkruan ajo në letrën e saj?
- 9 Ç'pa në rrugët e qytetit?
- 10 Ç'i binte në sy?
- 11 Për kë ndjeu dhembje më së tepërm?
- 12 A pati dëshirë të vozitej me karrocë?
- 13 Si u ndie kur arriti te shtëpia e mikpritësit?
- 14 Nënë e kujt zgjodhi të bëhej?
- 15 A mblohdhi shumë të tillë?
- 16 Me çka u nderua për punën e saj humanitare?
- 17 Kur e mori këtë çmim?
- 18 A është ajo vetëm në këtë punë?

(2) Use the Infinitive instead of (që) të + Participle:

Example: Që të zësh peshq, duhet të kesh durim.  
 Për të zënë peshq, duhet të kesh durim.

- 1 Që të punosh më shumë, duhet të flesh më pak.
- 2 Që të jesh i pasur, dikush duhet të jetë i varfër.
- 3 Që të mos vonohesh, më mirë nisu me kohë.
- 4 Që të mos na digjte dielli, u ulëm nën hije.
- 5 Ata shkuan të mos kthehen më kurrë.
- 6 Që të mos them se është keq, po të them se nuk është mirë.
- 7 Që të kthehej në shtëpi sa më parë, ajo e kreu punën më shpejt.
- 8 Ai kishte shkuar të takohej me prindërit.
- 9 Ato shkuan në qytet që t'i blejnë biletat për teatër.
- 10 Fëmijët dërgohen në shkollë që të edukohen (*be educated*).

- (3) Use the construction **me tē + Participle** instead of **sapo + Verb**:

*Example:* Sapo arriti, i thirri prindërit me telefon.  
Me tē arritur, i thirri prindërit me telefon.

- 1 Sapo u kthye nga puna, hëngri drekë dhe filloi ta lexonte gazetën.
- 2 Sapo doli nga shtëpia, iu kujtua se e kishte harruar ombrellën.
- 3 Sapo hynë në shtëpi, e panë se e kishin harruar ujin duke rrjedhur.
- 4 Sapo e mori letrën e saj, u ul t'ia kthente përgjigjen.
- 5 Sapo përfundoi filmi, e nisën një diskutim të gjatë rreth tij.
- 6 Sapo hëngrën mëngjes, u nisën për në Shpellën e Gadimës.
- 7 Sapo i hapi derën, e vërejtti se Marku nuk ndihej mirë.
- 8 Sapo e kryejnë një punë, e nisin tjetrën.
- 9 Sapo ra muzgu, u mblohdhën të gjithë para hotelit.

- (4) Translate the following sentences into Albanian:

- 1 Without looking carefully on both sides, he crossed the road.
- 2 Without finishing one job, Nora starts another.
- 3 Without waiting for his friends, Richard started eating.
- 4 Without thinking about the consequences, man is destroying nature for money.
- 5 Not being rich, one doesn't have to worry about money.
- 6 Without visiting the gallery, Nora and Drita returned home.
- 7 Without jumping into water, one never learns to swim!

## Unit Twenty-Four

### ■ *I SITUATIONS*

- |  |                  |
|--|------------------|
| ngutem   | hurry            |
| aeroplani më ikën  | I miss the plane |
| më shkon kot   | is useless to me |
| A: Duhet tē ngutemi. Nëse vonohemi edhe pak, kur tē arrijmë në aeroport, aeroplani do tē ketë fluturuar. |                  |
| B: E di, por po e pres motrën tē ma sjellë biletën. Nuk di pse u vonua. Do t'i ketë ndodhur diçka.       |                  |
| A: Mund tē tē pres vetëm edhe pesë minuta, përndryshe aeroplani më ikën dhe më shkon bileta kot.         |                  |
| B: Prit një çast sepse dikush është në derë. Sigurisht do tē jetë motra.                                 |                  |
| A: Mirë, nëse është ajo, më trego. Do tē vij te ti me taksi dhe do tē shkojmë bashkë në aeroport.        |                  |

shkollë e mesme	secondary school
kushtoj kujdes	pay attention
gjuhë letrare	standard language
e dhëne, të dhëna	data
për qind	per cent
vazhdimesht	continuously
variant, -i, -e	variety
rreth, -i, -e	surroundings
situatë, -a, -a	situation
përafersisht	approximately
e ngjashme, i ngjashëm	similar
diakon, -i, -e	dialect
veri, -u	north
jug, -u	south
nëndialektor-e	subdialectal

A: Sa vjet ke mësuar anglisht, Dritë?

B: Kam mësuar katër vjet në shkollën fillore dhe katër vjet në shkollën e mesme, por vetëm në kohën e fundit i kam kushtuar pak më tepër kujdes.

A: Ti flet mjaft mirë anglisht.

B: Tash jam duke e studiuar gjuhën dhe letërsinë angleze. Shpresoj ta mësoj edhe më mirë. Kam nga pak vështirësi t'i kuptoj disa njerëz.

A: Unë vetë, edhe pse jam anglez, ndonjëherë kam vështirësi t'i kuptoj disa njerëz. Arsyja është se jo të gjithë e flasin gjuhën letrare. Në të vërtetë, sipas disa të dhënavë statistikore vetëm tre për qind të njerëzve në Angli e flasin vazhdimisht gjuhën letrare, rrëth pesëmbëdhjetë për qind mund ta përdorin kur e do nevoja, kurse të tjerët kryesish e flasin variantin e rrëthit të tyre. Prandaj edhe ke vështirësi t'i kuptosh disa. Si është situata me shqipen?

B: Edhe me shqipen situata është përafërsisht e ngjashme. Sigurisht e di se shqipja ka dy dialekta kryesore, gegërishten, që flitet në Kosovë dhe në veri të Shqipërisë, dhe toskërishten, që flitet në jug të Shqipërisë. Por ka edhe variante të tjera nëndialektore.

A: Kur isha në Kosovë kisha vështirësi t'i kuptoja shokët e mi shqiptarë kur flisnin midis tyre, por më lehtë i kuptoja kur më flisnin mua.

B: Ata, sigurisht, midis tyre kanë folur në dialektin gegë.

## II/ GRAMMATICAL PATTERNS

### *The Future Perfect*

This tense is formed by using the future of **kam** for active verbs or **jam** for the non-active verbs plus the participle of the main verb, e.g.:

do të kem punuar  
do të jem mërzitur

I will have worked  
I will have been bored

This tense is sometimes used to express an action taking place in the future before another action is finished.

Aj do të pendohet, por atëherë do të jetë vonë. Ajo do të ketë shkuar në një botë tjeter, larg, shumë larg nga ai. He will regret (it), but then it will be late. She will have gone to another world, far, far away from him.

### *Conditional Clauses*

The Future Perfect is more usually used to express probability in Albanian, and it is then translated as 'may have'. Notice this use in the following examples:

Ndarja nga Drita do ta ketë dëshpëruar Norën. The parting from Drita may have (or will have) upset Nora.

I telefonova Markut. S'u përgjigji askush. 'Do të ketë shkuar në kinema,' thashë më vete. I telephoned Mark. Nobody answered. 'He must/may have (or will have) gone to the cinema,' I said to myself.

A tense which has the same forms as the Present Conditional and which is termed the Future Imperfect in Albanian, may be translated as a future conditional in English:

Të nesërmën do të punonin në kopsht, prandaj ranë në gjumë herët. The next day they would work in the garden, therefore they went to sleep early.

This tense is usually used in reported speech:

Më tha se do të shkonim në teatër në mbrëmje. He said to me that we would go to the theatre in the evening.

### *The Main Dialects of Albanian*

There are two main dialects in Albanian – Gheg, spoken in northern Albania and Kosovo, and Tosk, spoken in southern Albania. The standard variety, or the literary language as it is called by the Albanians, was established only after World War II and is based on both dialects. Before that, each dialect had its own

standard variety. Some of the main differences between the two dialects are briefly shown in the table below.  
(~) = nasal sound

<i>Standard (Literary) form</i>	<i>Tosk form</i>	<i>Gheg form</i>
është	është	âsht
bëj	bëj	bâj
hënë	hënë	hâñë
lë/lëñë	lë/lëñë	lâ/lâñë
zemër	zëmér	zémér
emër	emér	êmén
gjendje ( <i>state, situation</i> )	gjëndje	gjêndje
femër ( <i>female</i> )	femér	fêmén
vaj ( <i>oil</i> )	vaj	voj
vatër ( <i>home</i> )	vatër	votër
varr	varr	vorr
i/e varfër	i/e varfër	i/e vorfën
zë, zëri	zë, zëri	zâ, zâni
rërë ( <i>sand</i> )	rërë	râñë
pjekuri ( <i>maturity</i> )	pjekuri	pjekuni
zog	zok	zog
gju	gju	gjû; gû
mbret	mbret	mret
për të punuar ( <i>to work</i> )	për të punuar	me punue
kam punuar	kam punuar	kam punue

### III/ READING PASSAGE

#### MARKU KTHEHET NË PRISHTINË

Marku e Liza udhëtuan bashkë për Prishtinë. Meqë Liza nuk e kishte marrë biletën me kohë, ata u nisën bukur vonë për në

aeroport. Arritën vetëm dhjetë minuta para se të fluturonte aeroplani. I dorëzuan valixhet, i kryen formalitetet e tjera shpejt e shpejt dhe vrapiuan korridorit të gjatë që çonte drejt aeroplanit të tyre. Ishin udhëtarët e fundit që hipën në aeroplan. Edhe pse të lodhur e të djersitur, qenë shumë të luntur që e zunë aeroplanin.

Pas gjashtë orësh, Marku e Liza arritën në Prishtinë. Petriti e Blerta kishin dalë t'i takonin në aeroport. Blerta e Liza e kishin pritur me padurim takimin e tyre të parë. Që të dyja qenë shumë të gëzuara dhe u ndien sikur të kishin qenë shoqe me vite. Liza shkoi te Blerta. Me të do të qëndronte dy javë.

Marku shkoi me Petritin në shtëpinë e studentëve ku i ishte ndarë një dhomë për këtë vit shkollor. Ai në fillim të shtatorit ishte regjistruar dhe njëherit kishte bërë kërkesë të pranohej në shtëpinë e studentëve. Pasi që u vendos Marku në dhomë, Petriti shkoi në shtëpi. U morën vesh që të nesërmen të takoheshin para Fakultetit Filozofik. Petriti do ta çonte në Degë dhe do ta njihte me ndonjë shok të grupit. Marku duhet ta marrë orarin dhe të fillojë t'i ndjekë mësimet. Marku është i vetëdishëm se në fillim do të ketë pak vështirësi për mosnjohjen sa duhet të gjuhës por është i sigurt se këtë fazë do ta kalojë shpejt.

#### Vocabulary

formalitet, -i, -e	formality
që çonte	which led
udhëtar, -i, -ë	passenger
hip	get on, mount
lë djersitur	sweaty
me vite	for years
shtëpi studentësh	students' hostel
ndaj	set aside (lit. separate)
vit shkollor	school year
regjistrohem	enrol (non-act.)
kërkesë, -a, -ë	application; requirement
pranohem	am accepted
vendosem	settle
Degë, -a	Department
orar, -i, -e	timetable
ndjek	attend, follow (lit. chase)
mësim, -i, -e	lesson

<b>i vetëdishëm</b>	aware
<b>mosnjohje, -a, -</b>	lack of knowledge, ignorance
<b>sa duhet</b>	as much as he should
<b>fazë, -a, -a</b>	period, phase

**IV/ EXERCISES**

(1) Answer the following questions on the reading passage:

- 1 Pse kthehet Marku në Prishtinë?
- 2 Pse u nisën vonë për në aeroport?
- 3 Kur arritën atje?
- 4 Pas sa orësh arritën në Prishtinë?
- 5 Kush kishte dalë t'i takonte?
- 6 Si u ndien Blerta e Liza?
- 7 Ku shkuan Marku e Petriti?
- 8 Ku u morën vesh të takoheshin të nesërmen?
- 9 Për çka është Marku i vetëdishëm?
- 10 A shpreson ta kalojë këtë fazë shpejt?

(2) Put the verbs in brackets in the Future Perfect:

*Example:* Kur të arrijmë në shtëpi, nëna (bëj) drekën gati.  
 Kur të arrijmë në shtëpi, nëna do ta ketë bërë  
 drekën gati.

- 1 Kur të arrijmë në shtëpi, filmi (perfundoj).
- 2 Kur të kthehet Marku nga Kosova, (mësoj) shqipen mirë.
- 3 Shumë gjëra (ndodh) para se të arrinte atje.
- 4 Ajo, gjithnjë, para se të bjerë në gjumë, (lexoj) ndonjë libër.
- 5 Lajmi për fatkeqësinë, e shokut (dëshpëroj).
- 6 Nora e Drita nuk shkuan në restorant. Nora (jam) e lodhur.
- 7 Riçardi do të vinte, por sigurisht (harroj).
- 8 Teuta nuk po e gjen librin; (jap) shoqes.
- 9 Nora e Drita (vij), por pasi që nuk na kanë gjetur këtu, (kthehem) në banesë.
- 10 Nuk di a do ta gjejmë Petritin atje. Shpresoj se nëna e tij (tregoj) se do ta vizitojmë.

- 11 Meri nuk po ndihet mirë, (ftohem) në bjeshkë.
- 12 Nora nuk po e gjen biletën. (Lë) në hotel.
- 13 Biçikleta nuk qenka këtu. (Marr) Petriti.
- 14 Tash mund të shkojmë te Nora e Drita sepse sigurisht (çlodhem).
- 15 Nesër kthehet Drita nga Anglia. Sigurisht (kaloj) mirë.

(3) Put the following sentences into reported speech:

*Example:* Do të rri në shtëpi.  
 Tha se do të rrinte në shtëpi.

- 1 Do të blej një veturë të re.
- 2 Do të fle nja dy orë pasdreke.
- 3 Nesër do ta vizitojmë Shpellën e Gadimes.
- 4 Do të të shkruaj gjithsesi, por jo për motin.
- 5 Do të të lë një porosi (*message*) në hotel.
- 6 Pas dy javësh do të shkoj në pushim në bregdet (*seaside*).
- 7 Do ta pastroj kuzhinën para se të kthehesh ti.
- 8 Nesër do të peshkojmë, kurse pasnesër do të shkojmë në Deçan.
- 9 Shpresoj se do ta zëmë aeroplanin.
- 10 Do të lahem i lumë.
- 11 Jam e bindur se do të kënaqesh në Angli.
- 12 Petriti do të gëzohet kur të na shohë.
- 13 Kam vendosur të merrem me sport.
- 14 Do ta sjell librin javën e ardhshme.
- 15 Pas disa ditësh do ta festoj ditëlindjen.

**■ V/ A POEM****SONTE ZEMRA IME FESTON**

Ikni,  
 sonte zemra ime feston . . .  
 Zhdukuni nga oda ime  
 se sonte shpirti do të më dehë arsyen,  
 sonte,  
 dua të zhvishem,  
 dua të më lajë muzgu  
 në lakuriqësinë time,

dua tē jem e pastēr  
e dēlirē si natyra,  
dua tē jem vetē natyrē.

Ma hiqni këtë rrith nga qafa,  
prekja juaj më nguros . . .  
Zhvishmani dhe lëkurën,  
dua tē jem e lirē . . .  
e dēlirē . . .

Ikni, ikni,  
dhe derën pas jush mbylleni,  
e dini?

Dua tē jem lakuriqe,  
e pavesur me shikimin tuaj.  
Dua tē loz,  
e lirē,  
e dēlirē,  
tē loz nē afshin e zemrēs . . .

Ju fal qaforen e dhuruar nga ju,  
merreni dhe vallen e rrejshme  
dhe ikni, ikni  
se sonte kam festë.

I D, ja ku jam,  
ma jep dorën  
Eja, eja tē vallëzojmë  
me muzikën memece tē ëndrrave  
unë jam, EGO-ja  
eja!  
Sonte dua tē festoj.

E. Shukriu

*Vocabulary*

<b>festoj</b>	celebrate
<b>odë, -a, -a</b>	room
<b>deh</b>	intoxicate
<b>lakuriqësi, -a</b>	nakedness

e dēlirē	clean
prekje, -a, -	touch
nguros	petrify
lëkurë, -a, -	skin
pavesur (i/e)	not clothed/dressed
loz	play
afsh, -i, -e	passion
qafore, -ja, -	necklace
i/e dhuruar	awarded
vallen, -ja, -	dance
e rrejshme	false, fake
I D = i dashur	my love
memec-e	mute
ëndërr, -a, -a	dream

# Supplementary Reading

## PËRSHKRIM FSHATI

Fundi i tē pesë kodrave lëshohej pjerrtas dhe humbte nē fushën e vogël me formë trekëndëshi, e cila tērë verën e ruante blerimin, edhe atëherë kur dielli piqte gjithçka. Pesë përrenjtë që i ndanin ato kodra tē vjetra, tē cilat kushedi sa lisa kishin rritur dhe ushqyer, dhe, më nē fund, i kishin kalbur e tretur, sajonin një lumë tē vogël, i cili ia shtonte bukurinë edhe më tepër asaj lugine që dukej si një qilim i madh. Lumi dredharak e përshkonte nëpër qendër, e ndante fshatin nē dy pjesë dhe gjatë tērë verës rridhte, ashtu i qetë, me ata pak ujë tē kthjellët e tē vakët. Vetëm nē vjeshtë e herë-herë nē dimër e pranverë, uji si i tērbuar, i kalonte buzët e gërryera tē shtratit tē vet, mbyste ara e livadhe dhe linte pas vetëm lym. Njerëzit me fuqinë e krahut tē tyre e bartnin këtë lym dhe përsëri e hidhnin nē lumë, thuajse ashtu vepronin përinat tē fuqisë së tij që për atë vit ua kishte shkatërruar frytet e punës së tyre. Por nē verë uji ishte më i çmueshëm se çdo gjë që kishte fshati dhe banorët e tij. Ai ua mbante kopshtet, arat dhe kafshët. U ndihmonte fshatarëve sa herë që qillit nuk i vinte keq përtërë atë nxehësi që derdhte mbi ta. Ishte ushqim i çmueshëm përtokën e tyre, përtrembëdhjetë familjet e atij fshati tē vogël malor.

Dita nē atë fshat malor ishte shumë e qetë. Njerëzit shpërndaheshin nē punë së bashku me agimin e çdo dite.

Kur dielli depërtonte me rrezet e veta nëpër kurorat e mëdha tē lisave përballë fshatit, ndonjë udhëtar i rastit mund ta vërente fshatin me tē gjitha karakteristikat e tij; aty këtu ndonjë fëmijë tē vogël që lozta nē oborr apo nē rrugë, përrenjtë e vegjël tē ujit, që hynin e dilnin nga oborri nē oborr dhe më nē fund drejtoheshin si gjarpërinj dredha-dredha e tē gjatë nga arat e gjelberuara. Ditëve tē verës mund tē dëgjohej prej së largu, vetëm herë pas here, ndonjë zile kafshe ose blegërima e ndonjë deleje tē ndarë nga tufa, e që herë-herë përzuhej me zërin e barinjve, me jehonat

që kumbonin thekshëm përrua pas pérroi, duke e përcjellë zërin derisa humbte nē largësi.

Nga mesdita fshati bëhej edhe më i qetë. I ngjante një vendi tē shkretë, pa kund njeri tē gjallë nē tē. Edha nga pamja e jashtme ai nuk jepte shumë shenja gjallërie. Por, kur dielli lëshohej nga kodrat e perëndimit që ishin vetëm pak më tē ulta se ato tē lindjes dhe qilli dukej më i gjerë, e hijet e shtëpive e mbulonin një pjesë tē oborreve, fshati ngjalje përsëri. Njerëzit kthehen në puna në mbrëmje, ndaleshin midis fshatit dhe bisedonin deri vonë.

Adaptuar nga 'Malësoria'  
e N. Rrahmanit

## PËRSHËNDETJET

I futi gishtërinjtë nē gotën e madhe dhe nxori protezën. E lau me brushë e, pastaj, përsëri e vuri nē qelqin përballë pasqyrës. Uli kokën dhe e futi gojën nën krua, e mbushi me ujë. Sërisht e ngriti kokën dhe bëri gargara, që ta lante fytin. Pas kësaj e vuri protezën nē gojë. U shikua nē pasqyrë. E vuri buzën nē gaz. E preku me gishtërinj lëkurën e posarruar. I shpaloi buzët, kurse nē pasqyrë u dukën dhëmbët. Me dorën e majtë e menjanoi një tufë flokësh dhe iu qas krejtësisht pasqyrës: po i shikonte bebëzat e syve. Një copë herë ndenji ashtu, i palëvizshëm, si shtatore.

Më nē fund foli. U dëgjuat zëri i tij:

'Mirëdita!'

E përshëndeti vvetveten.

U vesh e u mbath. I shikoi mirë e mirë rrrobat që tē dilte i ndërruar me shije, ose tē mos i ikte pa e vënë re ndonjë njollë. E donte pastërtinë dhe rregullin, kurse fqinjët e njihnin si banorin më pedant tē hyrjes. Më nē fund, meqë çdo gjë ishte nē rregull, doli. Duke mbyllur derën, shkallëve po ngjitej një grua e moshuar, që mbante nē dorë një strajcë.

'Mirëdita!', i tha ky.

Ajo priti tē pushonte një çikëz, pasi që ishte mbushur frysë, e lodhur nga shkallët, dhe ia ktheu, pastaj, përshëndetjen, pa e shikuar fare:

'Mirëdita!'

Duke zbritur shkallëve iu dha rasti t'i përshëndeste edhe një tre banorë tē hyrjes së tij:

'Mirëdita, mirëdita!'

Në rrugë, atë ditë, nuk takoi asnje njeri që e njihet, për çudi. Nuk përshëndeti askë. Nuk i erdhë mirë. Mirëpo rrugën atë ditë e kishte të shkurtër, prandaj u ngushëllua. Vazhdoi të ecet. Nja njëqind metra më larg ishte qoshku në të cilin i blinte cigaret dhe gazetën gjithmonë, thuaja në orën e caktuar.

'Mirëdita!', i tha shitësit, kurse ai pa ia kthyer përshëndetjen ia nxori nga dritarja e vogël e qoshkut »Rilindjen« dhe pakon e cigareve. Ai i mori, e paloi gazetën, e futi në xhepin e setrës dhe u nis dalngadalë. Pas pesë a gjashtë minutash, përsëri u gjend para hyrjes së ndërtesës, ku ishte banesa e tij. Shkallëve, njerëzit po ecnin pas punëve të tyre. Derisa arriti te dera, pati rastin t'i përshëndeste nja pesë a gjashtë banorë:

'Mirëdita, mirëdita!'

E mylli derën e banesës pas vetes. Mengadalë e hoqi setrën e trashë e të zezë. Dukej se kishte dhembje eshtrash, prandaj i imponohej kjo ngadalësi. Pasi, më në fund, e hoqi dhe e vari setrën në korridor, u ul e i zbathi këpucët. Pastaj u kthyte dhe e nxori gazetën prej xhepi. I mori edhe cigaret. Shkoi në kuzhinë dhe i hodhi këto në një kolltuk të vjetër, por të pastër. Mori xhezven dhe vuri një kafe. Rinte në këmbë para shporetit dhe e priste kafenë. Kur kafja vloi, e ktheu në një filxhan të vogël me do lule të imëta dhe e la para vetes në tavolinë. I piu dy hurpe, pastaj u ngrit dhe e mori gazetën e pakon me cigare. U ul ku ishte më parë. E ndezi cigaren. Pastaj e mori filxhanin dhe piu edhe një hurpë, duke e hapur gazetën. E hapi faqen e parafundit dhe zuri t'i lexonte 'In memoriamet'. Gjatë kohë qëndroi mbi këtë faqe. Kur i lexoi të gjitha, mylli gazetën, dhe, duke e kthyer edhe gëllënken e fundit të kafesë dhe duke e fikur duqin e cigares, u ngrit dhe doli në korridor. E veshi sërisht setrën, mengadalë. Doli. Duke myllur derën, shikoi prapa, mirëpo shkallëve nuk vinte askush. Asnjë njeri. Shkallët ishin të zbrazëta. Ai u nis shkallëve të poshtë, i shoqëruar me rrudhat që dalin nga dhembjet. Me siguri do të ketë pasur dhembje eshtrash, pasi që hapat i ndërronte me vështirësi e me kujdes, thuajse po ecet nëpër vezë. Kur doli në rrugë e pa një të njojur, nga ana e kundërt, që po ngutej në punë të vet, me një çantë të madhe në dorë. E përshënd-

eti me kokë, meqë nga ana tjetër e rrugës i përshëndeturi s'do të kishte mundur ta dëgjonte. Ky, sa për vete, nuk e la pa i lëvizur buzët - 'mirëdita'. Nuk mund ta tund kokën pa e thënë edhe fjalën. Tjetri, matanë rrugës, nuk e vuri re fare. Kur e pa se i përshëndeturi nuk do ta vërente, e ngriti jakën e setrës dhe u nis drejt cakut të tij të përditshëm, në kafenenë e vogël me tri tryesa, që gjendej në qendër të qytetit.

Përshëndetja e pakthyer nuk e linte indiferent dhe në kësot situatash dhembjet e eshtrave fill i aktivizoheshin. Kafeneja nuk ishte aq afër, kështu që me këtë barrë nuk do ta kishte lehtë. Por deshi fati, në rrugë u takua me shumë qytetarë. Të gjithë e përshëndetën dhe i përshëndet.

'Mirëdita, mirëdita!'

U fut në kafene.

'Mirëdita, mirëdita!'

Të tri tavolinat e kafenesë ishin të zëna. Kafeneja përplot me mysafirë. Doli. I ra qendrës kryq e tërthor. Dhe, shpesh kthehet e kalonte nga dritaret e mëdha të kafenesë së vogël. Kur e pa se njëra tavolinë ishte liruar, hyri brenda.

'Mirëdita!'

Kamarieri e vuri re kur u ul. Iu afrua, e përshëndeti me 'mirëdita' dhe pa thënë fjalë tjetër ia la një gotë konjak mbi tavolinë. Konjak me akull. Ai, kamarieri, e dinte pijen e preferuar të tij, prandaj edhe ia solli pa pritur që ky të porosiste. Ky s'e vuri re as pijen as kamarerin. Kamarieri, kur e pa se njeriu nuk e kishte vënë re, ia afroi pijen mu te duart dhe e përsëriti 'mirëditën'. Ky ia ktheu përshëndetjen qetas dhe e mori konjakun. Nja një orë të mirë bëri teraqillëk duke e pirë atë gotë të vogël konjaku. Ndërkohë në kafene hynin e dilnin njerëzit. Thuaja të gjithë e njihnin pasi që ky çdo ditë e në të njëjtën kohë, në të njëjtën kafene e pinte të njëjtën pije. Që të gjithë e përshëndetnin:

'Mirëdita!'

'Mirëdita!', ua kthente ky.

Sipas tregimit me titull 'Përshëndetjet e mbrëmjes' nga Xh. Ahmeti

## VITA E ADILI

... Ajo ishte puthja e parë ... E  
puthjen e pare i riu as di ta japë,  
as di ta marrë, as di ta fshehë.

Kur Vita arriti te bërrylaku, pa menjëherë një qeleshe të bardhë të lëvizte nëpër errësirë.

– Adil, ti qenke? – pyeti vajza me ankth, me duart në kraharor, duke u përpjekur të mbante hovet e zemrës, që i luftonte pa pushim.

– Unë jam ...

– Ç'pate që brite ashtu? – tha vajza dhe eci drejt tij me hap të druajtur.

– Një gjarpër nën gurë më kafshoi këtu, – iu përgjigji djaloshi duke zgjatur krahun e djathtë, të shtrënguar si në darë, me dorën tjetër, me qëllim që helmi të mos merrte përpjetë.

Vita vrapi drejt tij.

– Ja, këtu ...

Ajo i rrëmbeu krahun. Djaloshi deshi ta largonte mënjanë, por Vita ia kishte zënë me të dyja duart. Me njérën e kishte kapur te qafa e dorës, pakëz më sipër vendit të kafshuar, kurse me tjetër i mbante pëllëmbën. Dy të rinjtë ndien në duart e tyre, që po shtrëngoheshin për herë të parë, avujt e ngrrohtë që zbrisnin bashkë me gjakun te vendi i takimit, ardhur nga zemrat e ngrohura prej të njëjtit diell.

Larg, prapa krahëve të Vitës, u dëgjuan hapat e një njeriu. Djaloshi u përpoq të hiqte krahun, por atëherë, rreth e qark vendit të kafshuar, ai ndjeu një unazë të nxehët, që po ia përvlonte plagën, duke u shtrënguar gjithnjë e më shumë. Vita, me buzet e mbërthyera si shushunjë mbi vendin e helmatisur, po i thëthinte gjakun e lig. Në atë veprim që i jepte pulsit të djaloshit goditje më të fortë, asaj i dukej sikur i kishte mbështetur kokën mbi kraharor dhe po e puthte mu në zemër.

Sa herë Vita ngrinte kokën për të pështyrë vrerin e nepërkës, Adilit i vinte në hundë një aromë e lehtë, si era e sanës në netët e vjeshtës. Flokët e vajzës, shpërndarë nga të bredhurit, njomur nga djersa, po avullonin afshin e tyre të veçantë, ashtu si avull e kundërmon sana e thatë, sa herë sfurku e merr nga fusha dhe

e vërvit mbi qerre. Një hop dhe leshrat e vajzës, në vrullin e tyre të hedhjes pas, e trazuan kosovarin në gushë, në mjekër e në pushin e hollë të faqeve. Adili uli kokën dhe e mbështeti, me një ndjenjë të trazuar sulmi dhe përmbytjeje, mbi kurorën e artë të flokëve të saj.

– Ah, gjarpërushe, kafshon më fort se gjarpëri! – fërshëlleu me një gjysmë zëri, se gjysmën tjetër ia kishte marrë zemra që po i buçiste me vrull.

Çupa ngriti kokën dhe e pa në sy, me një palë sy të pulitur. S'ka lule që të mbijë, të lulëzojë e të shpalosë kaq shpejt sa dashuria kur gjen klimën e vet ...

Hëna, një hënë e re pesëmbëdhjetëshe, e plotë dhe e verdhë si një bukëz dylli, nxori kokën nga gjiri i fletëve të gjelbëra të ullinjve, si për të parë çka po ndodhët në dritën e saj. Fusha mori një dukje tjetër.

Vita rrëmbeu në duar kindat e fustanit, i cili u ngrit përpjetë. Një vetull e bardhë zbardhëlleu në kufijtë e fustanit të zi. Adili ktheu kokën mënjanë dhe kafshoi buzën sikur t'i dhembte gjëkafshë. Po fustani ra përsëri në vend. Hëna u fsheh prapë në ullinjtë, sikur ta kishte zënë turpi dhe sërisht vendi e ftyra e djaloshit ranë në errësirë ... Atëherë, për çudi, pakëz më vonë nga ç'ngjau në të vërtetë, Adili dëgjoi grisjen e fustanit, ndjeu lidhjen e krahut dhe lëndimin e plagës.

Oh! – rënkoj, me një ‘oh’ që më tepër se dhembje trupore shprehte një lëndim tjetër.

– Adil, po si do të ngasësh kuajt, tash?

– Për atë s'po çaj kokën, po ty si të falënderoj?

– Falënderimin mund ta lësh kur të shërohesh, po qerren si do ta çosh në shtëpi? – qeshi vajza duke bërë një hap e duke u kthyer mbi belin e saj të hollë, si për të parë ç'do të ngjiste më tej.

Adili, sikur me këtë deshi t'i tregonte vajzës sa i zoti ishte të falënderonte dhe të bënte punë edhe me dorën e kafshuar, i shkoi krahun kular, si gjarpër, rreth belit dhe e shtrëngoi pas vetes. Te gusha, poshtë rrëzës së veshit, atje ku cikte vëthi i gjatë, i dha një të puthur vetëtimthi. Pastaj, duke harruar plagën dhe vajzën që mbeti në vend e topitur, kërceu mbi qerre, rrëmbeu kamxhikun dhe u foli kuajve.

– Oho, ju shitoftë rrufeja!

Vajza hoqi duart nga sytë dhe pa qerren tē çante pērpara. Mori frysme thellé dhe sytë i shndriten nga gëzimi.

- I marri! - bëlbëzoi me vete gjithë gaz e qejf, pa pyetur se farën e marrosjes ia pati shtenë ajo.

Atëherë Vitës iu kujtua e puthura e papritur e djaloshit dhe vendi i ngrohtë që i la aty, nën gushë. Vuri dorën si pér tē prekur puthjen e tij. Pak nga pak, kjo pullë e nxehtë iu kthye në një pare tē ftohtë, thuajse në atë vend t'i kishte vënë dikush rrethin e një unaze floriri. Por në zemër kujtimi i atyre dy buzëve sa vinte e ngrohej.

Atë kohë, në ndijimet që i kishin marrë mend, zemër e sy, ajo dëgjoi, prapa krahëve, një tē kollitur burri. Ktheu kokën menjëherë, e trembur. Pati harruar fare se kishte ardhur aty me të vëllanë. Fshiu me vrapti vendin nën gushë, që tē mos e pikaste i vëllai, sikur e puthura tē qe ndonjë lulkuq që, tek hedh farën, lidh petalet zjarr.

Po kishte tē drejtë vajza . . . Ajo ishte e puthura e parë . . . E puthjen e parë i riu as di ta japë, as di ta marrë, as di ta fshehë . . .

Adaptuar nga 'Lumi i vdekur' i  
J. Xoxës

## Appendix

**laj** (wash)

	<i>Indicative</i>	<i>Subjunctive</i>	<i>Conditional</i>	<i>Optative</i>	<i>Admirative</i>	<i>Imperative</i>
<i>Present</i>	laj lan lan lajmë lani lajnë	tē laj " lash " laje " lajmë " lani " lajnë	do tē laja " laje " lante " lanim " lanit " lanin	lafsha lafsh laftë lafshim lafshit lafshin	lakam lake laka lakemi lakeni lakan	laj (sing.) lani (pl.)
<i>Perfect</i>	kam larë ke " " ka " kemi " keni " kanë "	tē kem larë " kesh " " ketë " " kemi " " keni " " kenë "	do tē kisha larë " kiske " " kishte " " kishim " " kishit " " kishin "	pacă larë paş " pastë " pacim " pacit " pacin "	paskam larë paske " paska " pastemi " paskeni " paskan "	
<i>Imperfect</i>	laja laje lante lamim lanit lanin	tē laja " laje " lante " lanim " lanit " lanin			lakësha lakëshe [lakësh/lake] lakëshim lakëshit lakëshin	
<i>Plus-perfect</i>	kisha larë kiske " kishte "	tē kisha larë " kiske " " kishte "			paskësha larë paskëne " paskësh "	

(cont.)	kishim larë kishit " kishin "	tē kishim larë " kishit " " kishin "			paskëshim larë paskëshit " paskëshin "
<i>Simple Past</i>	lava lave lau lame latë lanë				
<i>Future</i>	do tē laj " lash " laje " lajmë " lani " lajnë				
<i>Future Perfect</i>	do tē kem larë " kesh " " ketë " " kemi " " keni " " kenë "				

<i>Participle - larë</i>	<i>Infinitive - pér tē larë</i>	<i>Gerundive (present) - duke larë</i>	<i>Gerundive (past) - duke pásé larë</i>
--------------------------	---------------------------------	--	--

lahem (*am/get washed*)

	<i>Indicative</i>	<i>Subjunctive</i>	<i>Conditional</i>	<i>Optative</i>	<i>Admirative</i>	<i>Imperative</i>
<i>Present</i>	lahem	té lahém	do té lahesha	u lafsha	u lakam	lahu ( <i>sing.</i> )
	lahesh	" lahesh	" laheshe	" lafsh	" lake	lahuni ( <i>pl.</i> )
	lahet	" lahet	" lahej	" lafté	" laka	
	lahemi	" lahemí	" lahemí	" lafshím	" lakemi	
	laheni	" laneni	" laheshtí	" lafshít	" lakeni	
	lahen	" lahen	" laheshtí	" lafshít	" lakan	
<i>Perfect</i>	jam laré	té jem laré	do té isha laré	qofsha laré	qenkat laré	
	je "	" jesh "	" ishe "	qofsh "	qenkc "	
	eshité "	" jeté "	" ishte "	qofte "	qenka "	
	jemi "	" jemi "	" ishim "	qofshim "	qenkemi "	
	jeni "	" jeni "	" ishit "	qofshit "	qenkeni "	
	jané "	" jané "	" ishin "	qofshin "	qenkan "	
<i>Imperfect</i>	lahesha	té lahesha			u lakésha	
	laheshe	" laheshe			" lakéshe	
	lahej	" lahej			" lakésh/lakej	
	laheshim	" laheshtí			" lakéshim	
	laheshi	" laheshtí			" lakéshit	
	laheshin	" laheshtí			" lakéshin	
<i>Plus-perfect</i>	isha laré	té isha laré			qenkésha laré	
	ishe "	" ishe "			qenkéshe "	
<i>Plus-perfect</i>	ishte "	" ishte "			qenkésh "	

(cont.)	ishim laré ishin "	té ishim laré ishin "			genkéshim laré qenkéshit "	
<i>Simple Past</i>	u lava				qenkéshim "	
	" lava					
	" la					
	" lamé					
<i>Future</i>	do té lahém					
	" lahesha					
	" lahet					
	" lahemí					
	" lahení					
	" lahen					
<i>Future Perfect</i>	do té jem laré					
	" jesh "					
	" jeté "					
	" jemi "					
	" jeni "					
	" jané "					

<i>Participle</i> -	<i>Infinitive</i> - pér t'u laré	<i>Gerundive (present)</i> - duke u laré	<i>Gerundive (past)</i> - duke u pasé laré
---------------------	----------------------------------	---	---

## kam (have)

	<i>Indicative</i>	<i>Subjunctive</i>	<i>Conditional</i>	<i>Opatitive</i>	<i>Admirative</i>	<i>Imperative</i>
<i>Present</i>	kam ke ka kemi keni kanē	tē kem ,, kesh ,, ketē ,, kemi ,, keni ,, kenē	do tē kisha ,, kishe ,, kishite ,, kishim ,, kishit ,, kishin	paca paç pastē pacim pacit pacin	paskam Paske Paska Paskemi Paskeni Paskan	ki (sing.) kini (pl.)
<i>Perfect</i>	kam pasur ke ka kemi keni kanē	tē kem pasur ,, kesh ,, ketē ,, kemi ,, keni ,, kenē	do tē kisha pasur ,, kishe ,, kishite ,, kishim ,, kishit ,, kishin	paca pasur paç pastē pacim pacit pacin	paskam pasur Paske Paska Paskemi Paskeni Paskan	" " " " "
<i>Imperfect</i>	kisha kishe kishte kishim kishit kishin	tē kisha ,, kishe ,, kishite ,, kishim ,, kishit ,, kishin			paskesha Paskeshe Paskesh/paskej Paskeshim Paskeshit Paskeshin	
<i>Pluperfect</i>	kisha pasur kishe kishte	tē kisha pasur ,, kishe ,, kishte			paskesha pasur Paskeshe Paskesh	" " "

(cont.)	kishim pasur kishit kishin	tē kishim pasur ,, kishit ,, kishin			paskeshim pasur paskeshit paskeshin	" " "
<i>Simple Past</i>	pata pate pati patən patən					
<i>Future</i>	do tē kem ,, kesh ,, ketē ,, kemi ,, keni ,, kenē					
<i>Future Perfect</i>	do tē kempasur ,, kesh ,, ketē ,, kemi ,, keni ,, kenē					

<i>Participle – pasur</i>	<i>Infinitive – pēr tē pasur</i>	<i>Gerundive (present)</i> – duke pasur	<i>Gerundive (past)</i> – duke past pasur
---------------------------	----------------------------------	--	--

**jam (be)**

	<i>Indicative</i>	<i>Subjunctive</i>	<i>Conditional</i>	<i>Optative</i>	<i>Admirative</i>	<i>Imperative</i>
<i>Present</i>	jam je ésh्ते jemi jeni jané	të jem " jesh " jetë " jemi " jeni " janë	do të isha " ishe " ishte " ishim " ishit " ishin	qofsha qofsh qofte qofshim qofshit qofshin	qen kam qen ke qen ka qen kemi qen ken qen kan	ji (sing.) jini (pl.)
<i>Perfect</i>	kam qenë ke ka kemi keni kanë	të kem qenë " kesh " ketë " kemi " keni " kenë	do të kisha qenë " kiske " kishite " kishim " kishit " kishin	paça qenë paç paşte paçim paçit paçın	paskam qenë pask paska paskemi paskeni paskan	
<i>Imperfect</i>	isha ishe ishte ishim ishit ishin	të isha " ishe " ishte " ishim " ishit " ishin			qenkësha qenkëshe qenkësh/qenkej qenkëshim qenkëshit qenkëshin	
<i>Pluperfect</i>	kisha qenë kishë kishët	të kisha qenë " kiske " kishite			paskësha qenë paskëshe paskësh	

(cont.)	kishim qenë kishit kishin	të kishim qenë " kishit " kishin			paskëshim qenë paskëshit paskëshin	
<i>Simple Past</i>	qeshë qe qmë qetë qenë					
<i>Future</i>	do të jem " jesh " jetë " jemi " jeni " janë					
<i>Future Perfect</i>	do të kem qenë " kesh " ketë " kemi " keni " kenë					

<i>Participle - qenë</i>	<i>Infinitive - përtë qenë</i>	<i>Gerundive (present) - duke qenë</i>	<i>Gerundive (past) - duke pash qenë</i>
--------------------------	--------------------------------	--	--

## punoj (work)

	<i>Indicative</i>	<i>Subjunctive</i>	<i>Conditional</i>	<i>Optative</i>	<i>Admirative</i>	<i>Imperative</i>
<i>Present</i>	punoj punon punon punojmē punoni punojnē	tē punoj " punosh " punoje " punojmē " punoni " punojnē	do tē punoja " punoje " punonte " punonim " punonit " punonin	punoftsha punoftsh punoftit punoftshim punoftshit punoftshin	punuakam punuake punuaka punuakemi punuakeni punuakan	puno ( <i>sing.</i> ) puno ( <i>pl.</i> )
<i>Perfect</i>	kam punuar ke " ka " kemi " keni " kanē "	tē kem punuar " kesh " " ketē " " kemi " " keni " " kenē "	do tē kisha punuar " kisha " " kishte " " kishim " " kishit " " kishin "	pača punuar pač " pastē " pacim " pačit " pačin "	paskam punuar paske " Paska " Paskemi " paskeni " paskan "	
<i>Imperfect</i>	punoja punoje punate punonim punonit punonin	tē punoja " punoje " punonte " punonim " punonit " punonin			Punuakēsha Punuakēshe punuakēsh Punuakēshim Punuakēshit Punuakēshin	
<i>Pluperfect</i>	kisha punuar kisha " kishte "	tē kisha punuar " kisha " " kishte "			paskēsha punuar paskēshe " paskēšin "	

(cont.)	kishim punuar kishit " kishin "	tē kishim punuar " kishit " " kishin "			Paskēshim punuar paskēshit paskēshin "	
<i>Simple Past</i>	punova punoje punoit punuam punuat punuau					
<i>Future</i>	do tē punoj " punosh " punoje " punojmē " punoni " punojnē					
<i>Future Perfect</i>	do tē kem punuar " kesh " " ketē " " kemi " " keni " " kenē "					

<i>Participle</i> – punuar	<i>Infinitive</i> – pēr tē punuar	<i>Gerundive (present)</i> – duke punuar	<i>Gerundive (past)</i> – duke pasē punuar
----------------------------	-----------------------------------	---	---

## SECOND CONJUGATION

*vendos (decide; place)*

		Subjunctive				Conditional		Optative		Admirative		Imperative	
	Indicative	té vendos	" vendosésh	" vendosé	" vendosim	" vendosni	" vendosin	" vendosin	" vendosin	" vendosin	" vendosin	" vendosin	" vendosin
Present	vendos							do té vendosja	vendossha	vendoskam	vendos (sing.)		
	vendos							" vendosje	vendossh	vendoska	vendos (sing.)		
	vendos							" vendoste	vendosste	vendoskemi	vendoskeni		
	vendosim							" vendosim	vendosshim	vendosshit	vendoskeni		
	vendosni							" vendosnit	vendosshin	vendosshin	vendoskan		
	vendosin							" vendosin	vendosshin	vendosshin	vendoskan		
Perfect	kam vendosur	té kém vendosur						do té kisha vendosur	paşa vendosur	paskam vendosur	paskam vendosur		
	ke	" kesh	" kesh	" keté	" kemi	" keni	" kané	" kishite	" kishite	" paskam	" paskam	" paskam	" paskam
	ka	" kash	" kash	" keté	" kemi	" keni	" kané	" kishite	" kishite	" paskam	" paskam	" paskam	" paskam
	kemi	" kash	" kash	" keté	" kemi	" keni	" kané	" kishite	" kishite	" paskam	" paskam	" paskam	" paskam
	keni	" kash	" kash	" keté	" kemi	" keni	" kané	" kishite	" kishite	" paskam	" paskam	" paskam	" paskam
	kané	" kash	" kash	" keté	" kemi	" keni	" kané	" kishite	" kishite	" paskam	" paskam	" paskam	" paskam
Imperfect	vendosja	té vendosja											
	vendosje	" vendosje	" vendosje	" vendosim	" vendosni	" vendosnit	" vendosin						
	vendoste	" vendoste	" vendoste	" vendosim	" vendosni	" vendosnit	" vendosin						
	vendosim	" vendosim	" vendosim	" vendosni	" vendosni	" vendosnit	" vendosin						
	vendosni	" vendosni	" vendosni	" vendosni	" vendosni	" vendosnit	" vendosin						
	vendosin	" vendosin	" vendosin	" vendosni	" vendosni	" vendosnit	" vendosin						
Pluperfect	kisha vendosur	té kisha vendosur						" kisha	" kisha	" paskesha	" paskesha	" paskesha	" paskesha
	kishe	" kisha	" kisha	" kishite	" kishite	" kishite	" kishite	" kisha	" kisha	" paskesha	" paskesha	" paskesha	" paskesha
	kishe	" kisha	" kisha	" kishite	" kishite	" kishite	" kishite	" kisha	" kisha	" paskesha	" paskesha	" paskesha	" paskesha

(cont.)	kishim vendosur	té kishim vendosur											
	kishin	" kishin	" kishin	" kishin	" kishin	" kishin	" kishin	" kishit	" kishite	" paskeshit	" paskeshit	" paskeshit	" paskeshit
Simple Past	vendosa												
	vendose												
	vendosi												
	vendosém												
	vendosét												
	vendosén												
Future	do té vendos												
	vendosésh												
	" vendosé												
	" vendosim												
	" vendosni												
